

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**Aspekti juridik dhe praktik i procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë
dhe në të drejtën komparative**

KANDIDATI:

FERDA EJUPI

MENTOR:

Prof. dr. EMINE ZENDELI

Tetovë, 2020

Falënderim

Puna ime hulumtuese dhe përfundimi i këtij punimi të magjistraturës pa dyshim nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e Zotit dhe shumë njerëzve rreth meje të cilët më përkrahën, më ndihmuan dhe më inkurajuan vazhdimisht andaj gjej edhe rastin për t'i falënderuar.

Shpreh mirënjohje të veçantë dhe falënderoj mentoren time Prof. Dr. Emine Zendeli për përkrahjen pakursyer, ndihmën, këshillat e vlefshme dhe mbështetjen e saj të vazhdueshme . Për bashkëpunimin konstruktiv dhe sugjerimet e vlefshme falënderoj edhe anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të magjistraturës Prof. Dr. Bekim Nuhija dhe Doc. Dr. Arta Selmani Bakiu.

Për ndihmën, motivimin, sugjerimet e vlefshme dhe përkrahjen e vazhdueshme gjatë viteve studimore dhe gjatë punimit të magjistraturës falënderoj stafin e Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore.

Mirënjohje të përhershme për rrugëtimin tim jetësor, për përkrahjen e pakursyer , ndihmën e jashtëzakonshme dhe mbi të gjitha për besimin që kanë treguar ndaj meje shpreh për familjen time, ku përzemërsisht falënderoj për gjithçka prindërit , nënën Zehra dhe babain Samirin të cilëve edhe u kushtohet ky punim.

Tetovë, Qershor, 2020

ABSTRAKT,

E drejta e pronësisë është e drejtë themelore e çdo individi, e drejtë subjective, absolute, e barabartë dhe e pacënueshme për të gjithë qytetarët. E drejta e pronësisë paraqitet si një ndër institutet më të rëndësishme të drejtës civile në veçanti të drejtës sendore e cila gëzon mbrojtje juridike si në rrafshin nacional poashtu edhe në rrafshin ndërkombëtarë.

Nëpërmjet këtij punimi do të tentohet që të jepet një pasqyrë reale mbi atë se si procesi i privatizimit është i rregulluar në Republikën e Maqedonisë, konflikti i normativit dhe praktikës gjatë zhvillimit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë, ndikimet dhe pasojat e saja në ekonominë e vendit dhe të arriturat e Republikës së Maqedonisë prej procesit të privatizimit.

Gjatë hulumtimit poashtu do të analizohen rrethanat, kushtet dhe metodat me të cilat është zhvilluar procesi i privatizimit, fazat nëpër të cilat ka kaluar ajo si dhe roli dhe rëndësia e organit kompetent për udhëheqjen e procesit të privatizimit respektivisht Agjencisë për Privatizim të Republikës së Maqedonisë.

Poashtu, një theks të veçantë do t'i vihet krahasimit mes synimeve dhe qëllimeve të ligjit të privatizimit dhe rezultateve të arritura në praktikë, poashtu do të jepen shembuj nga zhvillimi i procesit të privatizimit në shtetet fqinje.

Fjalët kyçe: *privatizim, transformim, pronë shoqërore, kapital shoqëror, ndërmarrje shoqërore*

АБСТРАКТ,

Правото на сопственост е основно право на секој индивид, субјективно, апсолутно, еднакво и неприкосновено право на сите граѓани. Правото на сопственост се претставува како битен институт на граѓанското право, посебно на стварно право која ги ужива ците правни заштити како во национален така и на меѓународен план.

Овој труд претендира да даде што пореална слика на приватизација како е регулиран процесот на приватизација во Република Македонија, нормативните и практичните конфликти при развојот на приватизација во Република Македонија, влијанијата и реперкуците во економијата на замјата и достигнувањата на Република Македонија во процесот на приватизацијата.

Во истражувањето ќе се анализираат околностите, условите и методите со кои се развива процесот на приватизација, фазите кои ги поминала таа, како и улогата на одговорниот орган за раководење на процесот на приватизација односно Агенцијата за приватизација на Република Македонија.

Исто така ќе се става посебен акцент на целта на законот за приватизација со постигнатите резултати во практика, исто така ќе се разгледуваат неколку примери од соседните земји.

Клучни зборови: *приватизација, трансформирање, општествено сопственост, општествено капитал, општествено претпријатије.*

Përmbajtje

Kapitulli i parë – I.....	4
1.E drejta e pronësisë.....	4
1.1 <i>E drejta e pronësisë në të drejtën romake</i>	4
1.2 E drejta pronësore në periudhën e feudalizmit	6
1.3 E drejta pronësore në shoqërinë borgjeze	6
1.4 E drejta pronësore gjatë periudhës së socializmit	8
1.5 Rregjimi juridik i së drejtës pronësore në Republikën e Maqedonisë.....	9
1.5.1. E drejta pronësore në Jugosllavinë socialiste	9
1.5.2 E drejta e pronësisë sipas Ligjit për pronësi dhe të drejtat sendore	11
Kapitulli i dytë – II.....	14
2. Nocioni i privatizimit	14
2.1 Arsytet se pse shtetet shkojnë në privatizim.....	17
2.2 Historiku i institucionit të privatizimit	18
2.3 Historiku i procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë	19
2.4 Korniza institucionale për zbatimin e privatizimit.....	23
Kapitulli i tretë - III	24
3.Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror	24
3.1 Objekti i procesit të privatizimit	26
3.2 Subjektët me drejtë pjesëmarrjeje në procesin e privatizimit.....	27
3.3 Dokumentet e nevojshme në procesin e privatizimit	30
3.4 Efektet e pritura nga procesi i privatizimit	31
3.5 Agjencioni për privatizim – Institucion kryesor	32
3.5.1 Detyrimet e Agjencisë për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror	34
3.6 Ndarja e ndërmarrjeve me kapital shoqëror.....	36
3.7 Fazat e procesit të privatizimit	38
3.8 Procesi i transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror	40

3.9 Metodat dhe teknikat në procedurën e transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë	42
3.9.1 Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla	44
3.9.1.1. Blerja e ndërmarrjes nga ana e punëtorëve	45
3.9.1.2 Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjen	46
3.9.2 Transformimi i ndërmarrjeve të mesme	47
3.9.2.1 Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes	48
3.9.2.2 Blerja e ndërmarrjes	48
3.9.2.3 Shitja e ndërmarrjes tek personat që marrin përsipër administrimin e saj.....	49
3.9.2.4 Emetimi i aksioneve për investime shtesë.....	51
3.9.2.5 Shëndërrimi i kërkesës së kreditorit në investim të përhershëm.....	53
3.9.3 Transformimi i ndërmarrjeve të mëdha.....	53
3.9.3.1 Shitja e pjesës ideale	55
3.9.3.2 Blerja e ndërmarrjes.....	55
3.9.3.3 Shitja e ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes	56
3.9.3.4 Emetimi i aksioneve për investime shtesë.....	57
3.9.3.5 Shëndërrimi i kërkesës së debitorit në depozitë të përhershme	58
3.9.4 Teknika speciale për privatizimin e kapitalt shoqëror	59
3.9.4.1 Dhënia e ndërmarrjes me qera	59
3.9.4.2 Transformimi me anë të shitjes së pasurive të ndërmarrjes	61
3.9.4.3. Transformimi i ndërmarrjeve në falimentim	62
3.9.4.4 Mbrojtja e të drejtave të ish-pronarëve dhe pasardhësve ligjor	63
3.10 Procesi i privatizimit në praktikë	64
Kapitulli i katërt – IV	73
4. Instituti i privatizimit në të drejtën komparative	73
4.1 E drejta e privatizimit në Shqipëri.....	73
4.2 Procesi i privatizimit në Kroaci.....	74
4.3 Procesi i privatizimit në Mal të Zi.....	75
4.4 Procesi i privatizimit në Slloveni	76

Kapitulli i pestë– V	77
5.Rezultatet nga procesi i privatizimit.....	77
5.1 Dobësitë e procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë	83
5.2 Pasqyra e objektivave të pritura nga procesi i privatizimit	85
5.2.1 Arritja e efikasitetit ekonomik.....	86
5.2.2.Efektet financiare	88
5.2.3 Tërheqja e investorëve të huaj.....	89
5.2.4 Efektet sociale nga procesi i privatizimit	90
Përfundim.....	93
Rekomandime	97
Literatura e shfrytëzuar.....	99

Hyrje

Nocioni pronësi paraqet një koncept të gjërë, me rëndësi të madhe ekonomike, juridike, filozofike dhe shoqërore. Institut i lashtë juridik i cili ka lindur me vet lindjen e së drejtës si dhe një ndër institutet më të rëndësishme të drejtës civile në përgjithësi, e në veçanti të drejtës sendore. Rëndësia e institutit të pronësisë shprehet me faktin se ajo paraqitet si objekt rregullimi si në aspektin ligjor ashtu edhe në aspektin kushtetues dhe ndërkombëtar. E drejta e pronësisë është drejtë themelore e çdo individ, e drejtë subjektive, absolute dhe ligjore me veprim erga omnes.

E drejta e pronësisë është e drejtë subjektive që titullarit i jep autorizim më të plotë për pushtet juridiko privat, ashtu që i jep të drejtë ta përdorë sendin, ta shfrytëzoj atë dhe të disponoj me të. Ligji për pronësi dhe drejta tjera sendore i Republikës së Maqedonisë si subjekt i drejtës së pronësisë njeh të gjithë personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj duke përfshirë këtu edhe shtetin dhe njësit e vetadministrimit lokal. Sikurse subjektët tjerë të drejtës pronësore ashtu edhe shteti ka të drejtë që me veprimet e veta juridike ta pëcaktoj fatin juridik të sendit, si psh. ta dhuroj, ta shkëmbej por edhe ta shet sendin.

Intenca e këtij punimi është të shqyrtoj mënyrën e disponimit të shtetit me pronën publike respektivisht institutin e privatizimit në Republikën e Maqedonisë, më konkretisht transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqërorë. Me institutin e privatizimit nënkuptohet proces i transformimit të pronës shoqërore (shtetërore) në pronë private, pra kalimi nga një rregjim të caktuar socio-ekonomik në një rregjim tjetër.

Në periudhën kohore pas Luftës së Dytë Botërore me paraqitjen e krizës ekonomike në masë të madhe është forcuar roli i pronësisë shoqërore në sferën ekonomike dhe gjatë asaj periudhe kohore mund të thuhet se ka pasur një lulëzim të dukshëm. Por në fund të viteve të 70-ta të shekullit XX rrjedha e ngjarjeve ka ndryshuar tërësisht, ndërmarrjet shoqërore në masë të madhe e kanë humbur rëndësinë e tyre për shkak të joefikasitetit dhe mospërbushjes së pritshmërive. Si rezultat i kësaj gjatë periudhës së tranzicionit proceset e privatizimit arrijnë

kulminacionin e tyre.¹ E gjithë këto ndryshime socio-ekonomike kanë ndikuar që shtetet të humbin rolin dhe fuqinë e tyre si titullar i të drejtave pronësore, fatin e njëjtë e ka ndjekur edhe Republika e Maqedonisë. Fundi i viteve të 70-ta dhe fillimi i viteve 80-ta të shekullit XX ka paraqitur periudhën kohore ku në nivel global instituti i privatizimit ka arritur majet e saja, në masë të madhe është realizuar transformimi i pronësisë shoqërore në atë private. Procesi i privatizimit është realizuar kryesisht me anë të tre modeleve edhe atë:

1. Me anë të shitjes e cila paraqitet si model më tradicional dhe më i njohur i privatizimit me anë të cilës realizohet shitja e ndërmarrjes shoqërore tek personat privat, edhe atë përmes shitjes së aksioneve të ndërmarrjes në bursë dhe me shitjen e ndërmarrjes në tërësi (apo të një pjese të saj) tek investitorët strategjik përmes ankandit publik. Nga vendet në tranzicion privatizimi me anë të shitjes ka gjetur zbatim në Gjermaninë Lindore, Estoni dhe Hungari.
2. Privatizimi me anë të kuponave nënkupton shpërndarjen falas të parave të specializuar të privatizimit (kuponave) me anë të cilëve qytetarët do të blejnë aksione në ndërmarrjet shoqërore. Ky lloj i privatizimit ka gjetur zbatim në Çeki, Sllovaki dhe Rusi kurse një zbatim të pjesërishtë në Poloni, Lituani, Letoni, Slloveni, Armeni, Kazakistan dhe Kirgistan.
3. Privatizimi me anë të aksioneve nga ana e punëtorëve nënkupton privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore nga vet punëtorët apo menaxherët e ndërmarrjeve me anë të një zbritjeje të konsiderueshme në çmimin e aksioneve të ndërmarrjeve. Ky model ka gjetur zbatim kryesisht në zonën e ish-Jugosllavisë edhe atë: Slloveni, Kroaci, Sërbi dhe Maqedoni.²

Fillet e institutit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë datojnë që nga viti 1989 atëherë kur ajo ishte akoma republikë në federatën e atëhershme Jugosllave me sjelljen e Ligjit për të Ardhura Personale dhe Ligjin për Kapital Shoqërorë ndryshe të njohura si ligjet e Ante Markoviqit sipas emrit të kryeministrit të federates së atëhershme Jugosllave. Por procesi i

¹ Për më shumë shih në: Boris Crnković, Željko Požega, Jelena Briševac, Privatizacija, državno vlasništvo i poslovni rezultat poduzeća.

²<https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9F%D1%80%D0%B8%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0>. (02.03.2020).

shëndërrimit të pronave shoqërore në pronë private fillon pas shpërbërjes së Republikës së Maqedonisë nga Jugosllavia përmes privatizimit, denacionalizimit dhe restitucionit.³ Procesi i privatizimit në Republikën e Maqedonisë është kryer në katër fusha edhe atë: privatizimi i bankave, privatizimi i apartamenteve, privatizimi i tokës ndërtimore dhe privatizimi i ndërmarrjeve⁴ e cila do të elaborohet gjatë punimit.

Instituti i privatizimit në Republikën e Maqedonisë është paraqitur si një proces mjaftë i ndërlikuar, i gjatë dhe i shumëanshëm i cili ka një lidhje të fortë me institutin e nacionalizimit dhe denacionalizimit që e ndjekin njëra tjetrën. Pas rregjimit shumëvjeçar socialist në shtetet e ish federatës Jugosllave me anë të procesit të quajtur nacionalizim pronat private përmes akteve shtetërore kanë kaluar në pronësi dhe kontroll shtetëror dhe sipas ideologjisë mbizotëruese prona i ka takuar „çdokujt,, dhe „askujt,,. Pas përfundimit të sistemit shumëvjeçar shoqëror dhe ekonomik socialist në Republikën e Maqedonisë ka filluar procesi i denacionalizimit i cili është i kundërt me procesin paraprak pasi me anë të denacionalizimit shteti është detyruar t'ua kthej pronën pronarëve të vërtetë prej të cilëve ishte sekuestruar në mënyrë të paligjshme me anë akteve të qeverisë së mëparshme.⁵ Ngjajshmëria apo lidhshmëria mes institutit të denacionalizimit dhe privatizimit qëndron në atë se në të dy rastet kemi kalim të pronës nga pronësia shoqërore në pronësi private, por duhet të theksohet se instituti i privatizimit përfshinë një sferë shumë më të gjerë se sa instituti i denacionalizimit pasi që ajo në vete jo që vetëm e ngërthen institutin e denacionalizimit por bën edhe transferimin e pronave të cilët prej në fillim kanë qenë në pronësi shtetërore në pronë private.

³Grubišić, M., Nušinović, M., Roje, G., Prema učinkovitom upravljanju državnom imovinom, Financijska teorija i praksa 33, (s. 335-374), Zagreb 2009.

⁴ Ervin, M., Državna imovina u Bosni i Hercegovini – geneza problema, Fondacija Centar za javno pravo, str.17.

⁵ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје 2014. стр.47.

Kapitulli i parë – I

1. E drejta e pronësisë

E drejta e pronësisë është institut i lashtë juridik po edhe atë që është e drejta, instituti më i rëndësishëm i vet të drejtës sendore i cili gëzon një trajtim të veçantë në literaturën juridike. E drejta e pronësisë jo vetëm që gëzon mbrojtje ligjore, por ajo garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë me *nenin 30*, si edhe në rrafshin ndërkombëtar gëzon mbrojtje me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948, dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me Protokollet e saj.

1.1 E drejta e pronësisë në të drejtën romake

Në shoqërinë skllavopronare romake pronësia si kategori juridike u paraqit me vet themelimin e shtetit skllavopronar romak.

Sipas drejtës klasike romake e drejta e pronësisë (*proprietas*) është definuar si e drejtë që titullarit të vet i jep pushtet të plotë mbi sendet (*proprietas est plena in re potestas*) edhe atë në tri mënyra:

1. *Jus utendi* (e drejta e posedimit dhe e përdorimit të sendit);
2. *Jus frutendi* (e drejta e mbledhjes së fryteve natyrale dhe civile nga sendi frytdhënës);
3. *Jus abutendi* (e drejta e disponimit me sendin);⁶

Kompetencat e pronarëve mbi sendet ishin mjaftë të gjëra që do të thotë se ata sendin mund ta përdorin sipas nevojës dhe dëshirës së tyre. Por sidoqoft pushteti mbi sendin nuk ishte absolut

⁶ Живковска, Р., Стварно право, Скопје, 2005 год., стр. 41.

ekzistonin disa kufizime lidhur me ndalimin e keqpërdorimit të sendit (male enim nostro iure uti non debemus).⁷

Ligji për 12 Tabelat përcakton kufizime për pronarët privatë me qëllim të eliminimit të konflikteve mes pronarëve të vegjël të tokave në gëzimin dhe përpunimin e të mirave bujqësore.⁸

Në drejtën romake kanë ekzistuar disa lloje të pronave private. Karakteristikat e bartësit të detyrimit (pronarit), mënyrat e fitimit të sendit ose vendi ku gjendet sendi kanë shërbyer si kriter për ndarjen e pronës private. Sipas kriterit të parë pra karakteristikave të bartësit të detyrimit (pronarit) është bërë dallimi mes pronësisë romake dhe peregrine. Prona Romake është themeluar nga ius civile ndërsa peregrina me urdhrat juridikë të shteteve autonome, sepse këtë pronë e gëzonin personat në shtetin romak të cilët nuk kishin status civitatis. Sipas mënyrës së fitimit të sendit prona private romake është ndarë në pronë kuintet dhe botanik. Kurse sipas vendndodhjes së objektit ajo është ndarë në pronë provinciale dhe pronë e tokave italiane.⁹

Mbrojtja e të drejtave pronësore në të drejtën romake është realizuar me anë të padive. E drejta romake është ndërtuar si një sistem i padive e jo si një sistem i drejtave subjektive. Kjo do të thotë që mbrojtja e drejtave pronësore është realizuar në ato raste kur ka ekzistuar një padi individuale për mbrojtjen e një të drejte të caktuar pronësore. Në raste të mungesës së padive për mbrojtje të drejtave pronësore të caktuara janë përdorur metodat alternative të mbrojtjes të të drejtave pronësore, të cilët paraqesin baza të ligjit të sotëm të arbitrazhit.¹⁰

Së fundit lidhur për të drejtën romake, normat dhe parimet e saja mund të themi lirisht që ajo paraqet bazën apo fundamentin në të cilën sot është ngritur dhe jetësuar e drejta pronësore në Evropë.

⁷ Пухан, И., и Поленак, А, М., Римско право, Скопје, 2001 година, стр.150.

⁸ По ату, fq. 151.

⁹ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје 2014, стр. 12.

¹⁰ По ату.

1.2 E drejta pronësore në periudhën e feudalizmit

Në shoqërinë feudale nuk janë bërë përpjekje të duhura për të përcaktuar drejtën e pronësisë.¹¹ Në shoqërinë feudale zakonisht mbreti ka qenë pronar i të gjithë pronave në territorin e tij dhe vetëm ai ka mundur të jep në përdorim të vasalëve. Si rezultat i kësaj janë shkaktuar pasoja në sistemin e pronësisë në mesjetë.¹²

Prona feudale është kuptuar si e drejtë e pasurisë së ndarë, pjesët themelore të së cilës kanë qenë:

dominium eminens – pjesë e cila i ka takuar sundimtarit,

dominium directum- pjesë e cila i ka takuar zotërinjve feudalë dhe

dominium utule- pjesë e cila i ka takur fshatarëve të varur.¹³

Në shoqërinë feudale ka mbizotëruar ekonomia natyrore edhe atë prodhimtaria bujqësore ku toka ishte mjeti kryesor e asaj prodhimtarie. Në shoqërinë feudale, toka u përvetësua njëkohësisht si nga sundimtari, ashtu edhe nga feudali dhe nga fshatari i varur. Sundimtari ishte mbajtësi i pronës supreme, feudali mbajtës i pronës së drejtpërdrejtë kurse fshatari i varur paraqitej vetëm si shfrytëzues. Ata prodhonin pothuajse gjithçka që u duhej jo vetëm për veten e tyre, por edhe për feudalët.¹⁴

1.3 E drejta pronësore në shoqërinë borgjeze

Kodet borgjeze të shekullit XIX e kanë pranuar treshen klasike romake lidhur për kualifikimin e të drejtave të pronësisë, servitutit dhe pengut.¹⁵ Në shoqërinë borgjeze, nocioni i së drejtës së pronësisë është kuptuar si një fuqi e plotë mbi sendet, si e drejtë për të poseduar sendin, për

¹¹ <https://hr.wikipedia.org/wiki/Feudalizam> (20.04.2020).

¹² Cenčić, J., Zakon o rastavi crkve I drzavi u Francusko I kanonsko pravo, p. 275.

¹³ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014 год, стр. 12.

¹⁴ По ату, fq. 12- 13.

¹⁵ Живковска, Р., Стварно право, Скопје, 2005 год, стр.43.

ta përdorur atë dhe për të disponuar lirshëm me sendin . Një kuptim i tillë i të drejtave pronësore është pranuar edhe sot në legjislacionet bashkëkohore.

Në një shoqëri kapitaliste, prodhimi i mallrave ka qenë mbizotërues dhe është zhvilluar në ndërmarrjet kapitaliste (prodhimi i mallrave kapitalist), në pronësinë e tokës në shkallë të vogël, dhe në punëtorinë artizanale (prodhimi i mallrave të imët). Në ndërmarrjet kapitaliste prodhuesit e drejtpërdrejtë kanë qenë punëtorët të cilët edhe pse kanë qenë të lirë por kanë qenë pa mjete dhe për këtë arsye janë detyruar të shesin forcën e tyre të punës, e cila në vetvete bëhet mall. Procesi i përqendrimit dhe i centralizimit të kapitalit ka ndikuar në shfaqjen e shoqërive aksionare si persona juridikë që kanë filluar të kryejnë përvetësimin e drejtpërdrejtë të fondeve të prodhimit dhe produkteve nga puna e punëtorëve të punësuar. Më vonë në kapitalizmin shtetëror vetë shteti ka filluar të ndaj aksione dhe dividendë të duhur.¹⁶

Prona private është kuptuar si e drejtë e përdorimit dhe disponimit të sendeve në mënyrën absolute me kusht që kjo e drejtë të mos jetë e ndaluar me ligj dhe rregullore, ose si një e drejtë në përdorimin e sendit me vullnetin e vet të plotë të personit duke përjashtuar të gjithë të drejtat e personave të tjerë rreth atij sendi (neni 354 i Kodit Civil Austriak).¹⁷ Më vonë në periudhën kapitalizmit të zhvilluar shteti ka filluar të ndërhyrjë në jetën ekonomike e cila ka patur për qëllim ruajtjen e interesave të klasës kapitaliste dhe shoqërisë kapitaliste në tërësi. Ndërhyrja e shtetit kapitalist në jetën ekonomike dhe veçanërisht në fushën e prodhimit të mallrave vjen në shprehje gjatë Luftës së Parë Botërore. Kontrolli shtetëror mbi prodhimin e ndërmarrjeve të caktuara kapitaliste fillon të pasqyrohet si një kufizim i asaj prone dhe veçanërisht si një kufizim i absolutitetit dhe ekskluzivitetit si karakteristikat e tij themelore. Gjatë kohës së kapitalizmit shtetëror ndërhyrja e shtetit është rritur përkohësisht në një fenomen të përhershëm dhe ka pasur për qëllim përcaktimin e programeve të prodhimit të ndërmarrjeve të caktuara kapitaliste private që përcaktojnë sasinë, asortimentin dhe cilësinë e prodhimit të tyre. Një karakteristikë specifike e ligjit borgjez është se për herë të parë drejtës pronësore i jepet një funksion shoqëror në interes të shoqërisë të shprehur gjatë Kushtetutës

¹⁶ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014, стр. 13.

¹⁷ Станкович, О., Водинелич, В., Увод у граѓанско право, Београд, 1992, стр.40

së Weimar-it të vitit 1919 e cila paraqet ndryshim thelbësor që ligji borgjez bëri mbi të drejtën Romake në pjesën e drejtës pronësore me të cilën nënkuptohej fuqi maksimale mbi sendet.¹⁸

1.4 E drejta pronësore gjatë periudhës së socializmit

Një nga detyrat themelore të revolucioneve socialiste ishte shëndërrimi i pronës private mbi mjetet e prodhimit në pronë shoqërore.¹⁹ Forcat revolucionare me forcë kanë marrë mjetet e prodhimit pa kompensim ose me kompensim të pjesshëm nga pronësia private dhe i kanë shëndërruar ato në pronësi shoqërore, duke pasur parasysh që edhe qeveria e shtetit paraqet gjithashtu një formë të diktaturës së proletariatit.²⁰

Në të drejtën civile të shteteve socialiste janë bërë përpjekje për të përcaktuar nocionin e përgjithshëm të të drejtave pronësore. Në këtë mënyrë dallimet në përcaktimin e nocionit pronësi mund të vërehen në literaturën juridike të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) dhe Republikën Socialiste Federative Jugosllave (RSFJ).

Në BRSS kanë dominuar kryesisht dy definime të së drejtës së pronësisë, dhe përgjithësisht pranohet ai *Venediktovit* sipas të cilit e drejta e pronësisë është e drejtë e pronarit që të përdorë mjetet e prodhimit dhe produktet e tjera të punës njerëzore sipas vullnetit dhe interesit dhe këtë ta bëjë në kuadër të marrëdhënieve të klasës sunduese. Në Jugosllavinë socialiste ka ekzistuar një përceptim se e drejta e pronësisë paraqet një tërësi të normave juridike që rregullojnë përvetësimin e të mirat ekonomike, e cila në thelb ka karakter normativ.

Ligji për marrëdhënie themelore juridike pronësore e përcakton të drejtën e pronësisë si e drejtë e pronarit për të mbajtur sendin e tij, ta përdorë atë dhe të disponojë brenda kufijve të

¹⁸ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, стр. 14, Скопје

¹⁹ Стојановски, Ј., Политичка економија, Просветно дело Скопје, Скопје, 1976 год, стр. 218.

²⁰ По ату, fq.218 – 219.

përcaktuar me ligj.²¹ Sipas mendimit të teoricienëve juridiko-civilë të Maqedonisë pronësia duhet të përcaktohet si e drejtë e përdorimit dhe disponimit me një send të caktuar. Në mënyrë që përdorimi dhe asgjësimi të realizohet pra të ushtrohet e drejta mbi sendin, sendi duhet të jetë në posedim d.m.th. "në duart" e ushtruesit të së drejtës. Prandaj, e drejta e pronësisë paraqitet si pushtet juridik që titullari e ushtron mbi sendin.²²

1. 5 Rregjimi juridik i së drejtës pronësore në Republikën e Maqedonisë

1.5.1. E drejta pronësore në Jugosllavinë socialiste

E drejta moderne materiale civile e ka bazën e saj në kodet civile të shekullit të tetëmbëdhjetë. E drejta civile dhe rrjedhimisht e drejta reale si pjesë përbërëse e saj e cila e rregullon të drejtën e pronës është krijesë e organizimit shoqëror shtetëror.

Në vitin 1934 është miratuar Kodi Civil në Mbretërinë e SKS i cili i ka rregulluar institutet themelore të së drejtës civile të rindërtuar në sistematikën institucionale tripalëshe: personae (persona), res (sende) dhe actiones (padi). Qysh nga atëherë brenda kornizave të së drejtës sendore ka filluar rregullimi i drejtës pronësore. Ky trend ka vazhduar edhe gjatë socializmit pasi të drejtat pronësore në Jugosllavinë socialiste rregulloheshin në kornizat e drejtës sendore si një ndër degët juridike.²³

Nocioni e drejta e pronësisë nënkuptonte një sistem normash për rregullimin e marrëdhënieve të caktuara shoqërore mes njerëzve e ashtuquajtur si e drejtë objektive e pronësisë. Nga ana tjetër të drejtat civile nënkuptonin të drejtat e ndryshme që ligji themelor i një vendi (kushtetuta) u njeh qytetarëve dhe që përcakton pozicionin e tyre të përgjithshëm juridik dhe shoqërorë . Të drejtat civile ndërmjet të cilave është edhe e drejta e pronësisë në atë periudhë

²¹ Законот за основните сопственосно правни односи, член 3, објавен во Службен лист на СФРЈ бр.6/1980 година.

²² Mitrovic, Milovan Svoina kao drustvena moc, Filozofski fakultet, Novi Sad, (e marrë më 24.04.2020) <http://www.socioloskaluca.ac.me/PDF6/Mitrovic,%20M.,%20Svojina%20kao%20drustvena%20moc.pdf>.

²³ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014, стр. 22

ishte rregulluar në Kapitullin III të RSF-së Kushtetuese të vitit 1974 ku qytetarëve u siguronte një numër të caktuar të lirive, të drejtave dhe detyrimeve.²⁴

Si institute më të rëndësishme juridiko-pronësore konsiderohen prona, kontrata, testamenti dhe përgjegjësia materiale (përgjegjësia për dëmet). Sistemi i së drejtës pronësore në atë kohë ishte bazuar në sistemin pandekt sipas të cilit e drejta civile përbëheshte prej disa pjesëve edhe atë: pjesës së përgjithshme, drejtës reale, drejtës detyrimore, drejtës familjare dhe trashëgimore.

E drejta sendore rregullonte pronësinë dhe të drejtat e tjera mbi sendet. Duke pasur parasysh se prona nënkupton ndarjen grupe ose individuale të mjeteve të prodhimit dhe konsumit të domosdoshëm për jetën e njeriut, ajo nënkupton marrëdhëniet mes njerëzve në lidhje me ato pasuri të njohura si mjetet themelore të prodhimit - mjetet me të cilat përshtaten dhe rezultatet e punës të krijuara apo të prodhuara nga ato mjete.²⁵

E drejta e pronësisë në këtë rend kushtetues nënkuptonte pronësinë individuale të individëve ose grupeve të personave (bashkëshortët, bashkëpronarët), si dhe pronësinë e disa personave juridikë që nuk janë me karakter shoqëror- juridik ose që paraqiten si një lloj forme kalimtare mes personave civilo -juridiku dhe shoqëro - juridik. Në sistemin socialist kufizimi themelor i pronësisë individuale kishte të bënte me madhësinë e pasurive që mund të zotëroheshin nga ana e individëve. Parimi themelor kishte të bëj me atë se pasurit e mëdha nuk mund të jenë në pronësi individuale dhe prandaj shoqëria dhe ligji socialist nuk lejojnë atë pronë të madhe, e cila në fakt duhet të shprehet si pronë kapitaliste. Si psh. për bujqët maksimumi i paraparë ishte 10 hektarë tokë,²⁶ Ligji për organizimin e transportit rrugor parashikonte të drejtën e pronësisë maksimum për 9 karrike udhëtimi etj.

Në rendin socialist kishte vend për pronat e vogla të cilat nuk duhet të ishin shfrytëzuese dhe bazoheshin kryesisht në punën personale me shpenzimet e veta. Në këtë drejtim, Kushtetuta e

²⁴ По аты, fq.23.

²⁵ Për më shumë shihni në Имотно (граѓанско) право –втор дел Стварно право, д-р Асен Групче, Култура 1983, Скопје.

²⁶ Neni 21 i kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1963.

RSF-së (neni 78 paragrafi 1) garanton të drejtën e pronësisë mbi objektet që shërbejnë për konsum personal ose plotësojnë nevojat e tyre kulturore dhe personale.

Për këtë sistem juridik është e rëndësishme të përmendet se të drejtat e pronësisë kishin të bënin me masa të përgjithësuara mbi bazën e të cilave prona private ishte transferuar në pronë shoqërore, me vetmin qëllim që të kufizonte pronësinë private. Në këtë kontekst mund të përmendet nacionalizimi, ekspropriimi, konfiskimi, komasacioni të cilët kanë shërbyer si mënyra për kufizimin e pronës private në llogari shoqërore.²⁷ Pronësia shoqërore si fenomen në marrëdhëniet pronësore në sistemet juridike socialiste ka qenë një mohim i plotë i pronës private.

1.5.2 E drejta e pronësisë sipas Ligjit për pronësi dhe të drejtat sendore

Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i vitit 2001 të Republikës së Maqedonisë është tekst ligjor i përgatitur në bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, e cila është e përbërë prej katër pjesëve edhe atë: pjesa e parë i referohet drejtës së pronësisë, pjesa e dytë posedimit, pjesa e tretë drejtave tjera sendore dhe pjesa e katërt të drejtave sendore të të huajve. Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore si titullar i drejtave i njeh jo vetëm personat juridik dhe fizik të vendit por edhe të huaj, si dhe shtetin dhe njësitë e vetëadministrimit lokal. Në bazë të nenit 8 të ligjit pronari ka të drejtë ta mbaj sendin, ta përdorë sendin dhe të disponoj me të sipas vullnetit derisa nuk është në kundërshtim me ligjin ose me të drejtën e ndonjë personi tjetër, pasi që ushtruesit e të drejtave duhet të përmbahen sjeljeve me anë të cilëve do ti çënojnë të drejtat e personave të tjerë.

Nëse e analizojmë përkufizimin juridik të së drejtës së pronësisë sipas Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore mund të konkludojmë se e drejta e pronësisë është një e drejtë reale e përcaktuar me ligj. Ligji në mënyrë taksative (numerus clausus) i përcakton të drejtat reale ku njëri prej tyre është edhe e drejta e pronësisë si e drejtë subjektive civile reale. Titullari apo

²⁷ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014, стр. 24.

ushtruesi i së drejtës nuk mund të krijojë vullnetarisht të drejta të tjera sendore d.m.th nuk mund të krijojë një mënyrë tjetër të përfitimit të së drejtës së pronësisë jashtë asaj që është e parashikuar me ligj. Kjo është si pasojë e natyrës absolute të së drejtës së pronësisë si e drejtë reale që kërkon edhe siguri juridike.²⁸

E drejta e pronësisë është një e drejtë reale që i jep mundësi titullarit të vet të ndjekë sendin dhe të kërkojë kthimin e sendit nga kushdo që e posedon pavarësisht nëse personi tjetër ka një bazë juridike apo jo. Këtu vjen në shprehje pronari i vërtetë i pronës (e drejta e përkatësisë) *contra omnes*. E drejta e pronësisë poashtu është një e drejtë reale që i përket grupit të të drejtave subjektive absolute që i sigurojnë titullarit fuqi të plotë mbi sendin.

Objekt i së drejtës së pronësisë sipas Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore janë të gjitha sendet me natyrë materiale që mund t'u takojnë personave fizikë dhe juridikë, ndërsa format themelore të pronësisë janë: pronësia private (individuale dhe grupe), shtetërore dhe pronësia e njërive të vetëadministrimit lokal. Në këtë mënyrë në Ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore në përputhje me Kushtetutën janë paraqitur dy risi kryesore edhe atë pluralizmi pronësor dhe ndarja e pronësisë së shtetit nga pronësia e njërive të vetëadministrimit lokal.²⁹

Megenëse ligji e ndan pronësinë shtetërore nga pronësia e njërive të vetqeverisjes lokale si dy specie të së drejtës së pronësisë, lind pyetja se a është dhe sa është e justifikuar në mënyrë ligjore.³⁰ Kjo çështje kryesisht është problematike pasi prona shtetërore pa përjashtim përfshin të gjitha të mirat materiale që janë kusht i domosdoshëm për kryerjen e funksioneve të saj si qeveri dhe se shteti është trashëgimtarë i drejtpërdrejtë i pasurive shoqërore dhe pronar i burimeve natyrore, si dhe efektet financiare të përfituara gjatë transformimit të pronës shoqërore do ti takojnë shtetit pra pasurisë shtetërore.³¹

²⁸ Попов, Д., Граѓанско право (Општ дел), Нови Сад, 2007 година, стр. 137- 138.

²⁹ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014, стр. 31.

³⁰ Për më shumë shiko në: Асен Групче, За републиката и општината како два сегмента на државната власт и за нивната сопственост, Скопје, 2001 година

³¹ Живковска, Р., Стварно право, Скопје, 2005 година, стр. 109-110,

Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore nga neni 122 deri më 155 flet për mënyrat e përfitimit të pronësisë, rregullimi i mënyrave të përfitimit të drejtës së pronësisë me dispozita ligjore i përkufizon palët në aspektin e krijimit të mënyrave të tjera për përfitimin e pronësisë, në këtë mënyrë parandalohet mundësia e abuzimit të fitimit të së drejtës së pronësisë nga palët e pandershme dhe në të njëjtën kohë sigurohet siguria juridike.

E drejta e pronësisë sipas Ligjit për pronësi dhe të drejta sendore fitohet në katër mënyra alternative edhe atë:

- 1) me ligj
- 2) në bazë të punës juridike
- 3) me trashëgimi
- 4) me vendim të organit shtetëror kompetent.³²

Sa i përket mbrojtjes së drejtave pronësore ajo është e garantuar si në nivel nacional dhe ndërkombëtarë. Sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, secili person i të cilit i cënohen apo i rrezikohen drejtat dhe liritë nga Konventa kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtje tek autoritetet kombëtare si dhe në instancë të fundit pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me qendër në Strasburg. Në këtë mënyrë krijohet një lidhje specifike mes sistemit kombëtar dhe evropian për mbrojtjen e të drejtave të garantuara dhe krijohet një mekanizëm mbikombëtar i kontrollit për mbrojtjen e të drejtave të garantuara duke përfshirë këtu edhe të drejtën e pronësisë.³³

Mbrojtja e së drejtës së pronësisë në nivel nacional është e dyfishtë d.m.th ajo mbrohet me Kushtetutë dhe Ligj. Korniza e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë parashikohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si akti më i lartë juridik i shtetit në nenin 50 sipas të cilit të gjithë qytetarët mund të kërkojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave (pra edhe të drejtën e pronësisë).

³² Neni 122 i Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore i Republikës së Maqedonisë.

³³ Јаневски, А., Зороска, К, Т., Граѓанско процесно право, Парнично право, Правен факултет Јустинијан Први, Скопје, 2009 година, стр. 35.

Çështja e mbrojtjes së drejtave pronësore nuk është çështje e pjesës materiale civile por ligjit procedural civil dhe administrativ.³⁴ Këtu titullari ka të drejtë të kërkojë mbrojtje të së drejtës së pronësisë qoftë para gjykatës civile, qoftë para një organi administrativ ose gjykate administrative në varësi të llojit të shkeljes. Kjo siguron një mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave pronësore si një e drejtë absolute reale në nivel nacional. Republika e Maqedonisë lejon mbrojtjen e së drejtës së pronësisë me anë të disa llojeve të padive të përcaktuara me dispozita ligjore të cilët e mbrojnë të drejtën e pronësisë si një e drejtë absolute civile subjektive.

Kapitulli i dytë – II

2. Nocioni i privatizimit

Instituti i privatizimit zë një vend mjaft të rëndësishëm në të drejtën sendore civile, pasi shërben për transferimin e pronës shoqërore në pronë private, gjë që përveç interesit privat është shumë i rëndësishëm që të mbrohet edhe interesi shoqëror. Pasi intenca e vet e procesit të privatizimit kishte të bëj me përmirësimin e kushteve ekonomike të vendit, për tregun e lirë të punës, gjallërinë ekonomike dhe rritjen e standardit jetësor të shoqërisë, gjë që nuk mund të mendohet që privatizimet që do të realizohen në Republikën e Maqedonisë të jenë në dëm të vetë shoqërisë.

Privatizimi në vitet 80-ta ishte një ndër temat kyçe të debateve në sferën ekonomike. Ideja konsistonte në kufizimin e kontrollit shtetërorë në sferën ekonomike dhe zgjerimin e sektorit privat.

Mënyrat e transferimit të pronës dhe funksioneve të kontrollit nga sektori publik në sektorin privat, rritja në mënyrë të dukshme rolit të sektorit privat krahas asaj publik janë fenomene të shumëllojshme dhe të ndryshueshme gjë që e vështëron definimin e nocionit të privatizimit . Shumë autorë që janë marrë me zgjidhjen e këtij problemi në kërkim të një përkufizimi të

³⁴ Simonetti, P., Ownership and its transformation, warranty and protection ...Coll.Rights.factor.Rij.(1991) v. 31, no.1, .

thjeshtë dhe operativ i referohen përkufizimit të profesorit D.Heald të vitit 1984. Sipas të cilit nën termin privatizim hynë katër komponente edhe atë:

1. Privatizimi i financimit të shërbimeve të caktuara, prodhimi i të cilave vazhdon të mbetet në sektorin publik.
2. Privatizimi i financimit të disa shërbimeve të caktuara, financimi i të cilave mbetet në kompetencën e sektorit publik si p.sh kontrata mbi vepër apo contracting out. Sipas kësaj sektorët privat kryejnë shërbime të caktuara për sektorët publik si p.sh. përgatitja e ushqimit për spitalet dhe shkollat shtetërore.
3. Denacionalizimi i cili kuptohet si shitje e ndërmarrjeve publike dhe transferim i funksioneve shtetërore në sektorin privat.
4. Liberalizimi në drejtim të shfuqizimit të pjesshëm ose të plotë të rregulloreve normative që ishin pengesë për sektorët privat që të hyjnë në aktivitete dhe tregje të caktuara.³⁵

Nocioni i privatizimit në Republikën e Maqedonisë do të thotë proces i transformimit të pronës shoqërore (publike) në pronë private, Në Ligjin për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë të vitit 1993³⁶ i cili në vazhdim do të shënohet si LTNKSH me nenin 2 përcaktohen se cilët ndërmarrje konsiderohen me kapital shoqërorë, edhe atë *ndërmarrjet me kapital shoqëror janë ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet me pronësi të përzier, kur bazohen në asetet shoqërore të investuara në to, nuk kanë fituar të drejta pronësore mbi ndërmarrjet. Ndërmarrjet me kapital shoqëror, sipas këtij ligji, janë organizatat e shoqërive të punës dhe të biznesit që kryejnë veprimtari ekonomike dhe nuk janë ende të organizuar si ndërmarrje.*

Nocioni i privatizimit në shtetet e Evropës Kontinentale,

Në Gjermani privatizimi emërtohet me termin *privatisierung* (nga lat. *Privatus*) në kuptimin e ngushtë i referohet shëndërrimit të pasurive publike në pronë private. Në një kuptim më të

³⁵ Славески, Т., Приватизација пазар држава, Скопје, 1997 година, стр.3

³⁶ Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror i shpallur në Gazetën Zyrtare me nr.48/1993, e shpallur më 21.06.1993, e hyrë në fuqi më 29.06.1993.

*gjerë privatizimi nënkuptohet zhvendosjen nga aktivitetet shtetërore në sektorin privat të ekonomisë.*³⁷

Në literaturën *Italiane* privatizimi njihet me nocionin *di privatizzazione*, proces ekonomik dhe juridik i transferimit të një mire, një aktiviteti, një subjekti nga regjimi i ligjit publik në atë të së drejtës private.³⁸

Në shtetin *Francez* përdoret termi *La privatisation*, me të cilin nënkuptohet procesi i transferimit përmes shitjes së aseteve, një aktiviteti ose një biznesi nga sektori publik në sektorin privat.³⁹

Kuptimi i nocionit të privatizimit ne sistemin anglosakson,

Në *SHBA* privatizimi (privatization) përceptohet si proces i transferimit të pronësisë së një biznesi, ndërmarrjeje, agjencie, bamirësie ose shërbimi publik nga sektori publik (shteti ose qeveria) në sektorin privat (bizneset që operojnë për një fitim privat) fitimprurëse. Në një kuptim më të gjerë, privatizimi i referohet transferimit të çdo funksioni qeveritar në sektorin privat. Privatizimi është përkufizuar edhe si shitje e pasurive publike për kompanitë private, të cilat pastaj e ofrojnë atë shërbim në shoqëri ose komunë me një çmim konkurrues. Ideja e tërë prapa çështjes së privatizimit është se ofruesi i ri do të jetë në gjendje të ofrojë të njëjtin shërbim por në një kosto të reduktuar për qytetarët dhe komunat. Qytetarët dhe komunat mendohet të përfitojnë nga ulja e koston që ishte e lidhur me funksionimin e objektit publik.⁴⁰

Në *Angli* shitja e industrive shtetërore ka qenë e njohur si privatizimi që nga viti 1980, termi privatizimi është gjerësisht sinonim me 'de-nacionalizimin'.

Instituti i privatizimit njihet me nocionin "*privatisation*" që do të thotë një transaksion ose një seri transaksionesh nëpërmjet të cilave qeveritë shesin të gjitha ose një pjesë të një interesi në një pasuri shtetërore.⁴¹

³⁷ https://de.wikipedia.org/wiki/Privatisierung#cite_note-1 (15.02.2020)

³⁸ https://it.wikipedia.org/wiki/Privatizzazione_in_Italia (15.02.2020)

³⁹ <http://www.toupie.org/Dictionnaire/Privatisation.htm> (15.02.2020)

⁴⁰ https://en.wikipedia.org/wiki/Privatization_in_the_United_States#cite_note-Co-operative_News_2005-3 (15.02.2020)

⁴¹ <https://en.wikipedia.org/wiki/Privatization> (15.02.2020)

2.1 Arsyet se pse shtetet shkojnë në privatizim

Siç shihet edhe më lartë në sistemet e ndryshme ligjore, shtetet e ndryshme kanë dhënë definime të ndryshme lidhur me privatizimin, shihet se nuk ekziston një definim i unifikuar në të drejtën komparative lidhur me të edhe pse një numër i konsiderueshëm i shteteve e kanë perjetuar këtë proces. Por mungesa e një definimi të unifikuar lidhur me definicionin e institutit të privatizimit nuk e çënon esencën, thelbin e saj ajo në çdo shtet është manifestuar me kalimin e pronës publike në pronë private por gjatë zhvillimit të procesit të privatizimit janë përdorur mënyra, metodave të ndryshme si dhe arritjet e suksesi nga ky proces ka qenë i ndryshueshëm nga shteti në shtet.

Sipas ekonomistes së njohur amerikane dhe njëkohësisht edhe presidentes se Institutit Ronald Coase, Mary M. Sharley thotë se qeveritë mund të kenë shumë arsye për privatizim, por fokusi gjithmonë duhet të mbetet te shkaqet apo arsyet e vërteta se pse pronat shoqërore duhet të privatizohen respektivisht të kalojnë në pronësi private. Sipas Sharley –it ekzistojnë tre arsye se pse qeveritë duhet të privatizojnë pronat shoqërore, pasi që:

1. *Privatizimi përmirëson përdorimin e burimeve publike*
2. *Privatizimi përmirëson efikasitetin e operimit*
3. *Privatizimi përmirëson efikasitetin dinamik*

Poashtu Sharley thekson se një shtet i cili do ta bazoj procesin e privatizimit në këto tre arsye të lartë përmendura gjasat për dështim janë shumë të ulta, madje një shtet demokratik doemos duhet ta mbështes procedurën e privatizimit në këto parime përndryshe nuk mund të flitet për mbrojtjen e interesit dhe të mirën e shoqërisë,⁴² kurse sipas profesorëve tanë prof. Naum Grizo dhe Borçe Davitovski motivet kryesore të shteteve për të shkuar në privatizim qëndrojnë në katër arsye themelore edhe atë se:

1. *Ndërmarrjet private në thelb janë më të efektshme se ndërmarrjet publike.*
2. *Pronësia publike rrezikon lirinë ekonomike.*
3. *Ekziston një bindje se ndikimi i sindikatave është tepër i madh.*

⁴² <https://www.oecd.org/daf/ca/corporategovernanceofstate-ownedenterprises/1929649.pdf> (20.11.2019)

4. Shitja e ndërmarrjeve shtetërore siguron të ardhura të konsiderueshme për shtetin.⁴³

2.2 Historiku i institucionit të privatizimit

Privatizimi para shekullit 20 – të , siç përmendëm edhe më lartë ky institut ka qenë mjaft i përhapur në botë, zanafilla e saj daton qysh nga Greqia Antike ku pothuajse qeveritë çdo gjë kanë lënë në pushtetin privat, kurse në Perandorinë e Lashtë Romake personat juridik dhe kompanitë private kanë pasur një fushëveprim të gjerë edhe atë mbledhjen e tatimeve (bujqësinë tatimore), furnizimet e ushtrisë (kontraktorët ushtarakë), sakrificat fetare dhe ndërtimet.⁴⁴

Një ndër ndër lëvizjet e para ideologjike lidhur me institutin e privatizimit rrjedhin edhe nga epoka e artë e Kinës gjatë dinastisë Han, ku Taoizmi erdhi për herë të parë në nivel shtetërorë dhe mbështeti parimin "*laissez-faire të Wu wei* " që do të thotë të mos bëj asgjë. Sundimtarët u këshilluan nga kleriku taoist se një sundimtarë i fuqishëm është pothuajse i padukshëm.⁴⁵

Gjatë periudhës së rilindjes derisa shumica e vendeve evropiane ishin ende duke ndjekur modelin ekonomik feudal. Dinastia Ming në Kinë kishte filluar ta praktikojë privatizimin për të dytën herë, veçanërisht në industritë prodhuese. Kjo ishte një përmbysje e politikave të dinastisë së mëparshme Song të cilët kishin përmbysur politikat e mëparshme të dinastisë Han dhe kishin vendosur sistemin e një kontrolli rigoroz shtetëror.⁴⁶

Privatizimi i sektorit publik pas shekullit 20 – të ka qenë një nga politikat përcaktuese të ekonomisë botërore që nga vitet 70-ta. Ndërmarrjet shtetërore dhe monopolet janë shitur ose transferuar në sektorin privat në teorinë neoliberalë se "tregu" është më racional dhe më i aftë për të menaxhuar ndërmarrjet e tilla. Sipas studiuesit spanjoll Germà Bel Adreson ideja e privatizimit vjen nga neoliberalizmi, i bazuar në një përparësi të tregut, është ideologji gjithëpërfshirëse e privatizimit.⁴⁷

⁴³ Гризо, Н., Давитковски, Б., Приватизация во светот, Куманово, 1994 година, стр.18,

⁴⁴ <https://en.wikipedia.org/wiki/Privatization> (10.10.2019)

⁴⁵ <https://en.wikipedia.org/wiki/Privatization#CITEREFLiZheng2001> (10.10.2019).

⁴⁶ https://en.wikipedia.org/wiki/Privatization#cite_note-10 (10.10.2019).

⁴⁷ https://www.researchgate.net/publication/28312632_The_First_Privatization_Policy_In_A_Democracy_Selling_State-Owned_Enterprises_In_1948-1950_Puerto_Rico (10.10.2019).

Hapat e para të privatizimit u dëgjuan në Gjermaninë naziste, privatizimi u krijua nga përvoja gjermane në mesin e viteve 30-ta. Reprivatisierung, ose ri-privatizimi, shënoi përpjekjet e regjimit nazist për të de-nacionalizuar sektorët e ekonomisë gjermane. Siç vëren Bel, "privatizimi gjerman i viteve 1930 kishte për qëllim të përfitonte sektorët më të pasur dhe të përmirësonte pozitën ekonomike dhe mbështetjen politike të elitës". Në Gjermanin Naziste në fillim të viteve 30-ta filloi shitja e pronës publike në çelik, miniera, banka, linjat e anijeve dhe hekurudhave për shkak të katastrofës ekonomike të Depresionit të Madh. Megjithatë, Bel thotë se privatizimi i nazistëve ishte vendosur "brenda një kuadri të kontrollit shtetëror në rritje të të gjithë ekonomisë nëpërmjet rregullimit dhe ndërhyrjes politike". Industrialistët jo bashkëpunues, si kreu i kompanisë së avionëve Junkers, u hoqën nga pozicionet e tyre, tregu ishte shumë i kontrolluar nga partia.⁴⁸

Por lëvizjet më të mëdhaja në sferën e privatizimit janë nga vitet 70-ta në Angli dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e më pas edhe në shtetet e Evropës Lindore të shkëputura nga rregjimi komunist, privatizimi është përhapur në më shumë se 100 vende që kolektivisht kanë privatizuar dhjetëra mijëra firma, dhe kanë fituar të ardhura pothuajse 1.5 trilionë dollarë. Privatizimi ka prodhuar substanciale përfitime fiskale: në shumë vende të ardhurat nga privatizimi përbënin 10 për qind ose më shumë buxhetet e qeverisë në disa vite dhe ruajtur pothuajse aq sa nëpërmjet eliminimit të nevojës subvencione të mëtejshme për ndërmarrjet shtetërore, por përvojat më dramatike të privatizimit kanë ndodhur në vendet e tranzicionit ku ekonomitë sociale janë bërë kryesisht në pronësi private brenda një dekade.⁴⁹

2.3 Historiku i procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë

Në vendet e ish-bllokut socialist, transformimi i pronësisë (privatizimi i kapitalit social) u shëndërrua në një faktor vendimtar për kalimin në një ekonomi tregu. Mënyrat e mundshme të realizimit të tij u bënë një çështje me interes të madh dhe debate të shumta publike. Zgjedhja e modelit të privatizimit në një masë të madhe varet nga karakteristikat e ekonomisë, të cilat

⁴⁸ <http://www.ub.edu/graap/nazi.pdf> (12.10.2019)

⁴⁹ <https://siteresources.worldbank.org/INTDECABC2006/Resources/gurievmeeggison.PDF>

kishin përjetuar më parë fenomenin e privatizimit. Pas sistemit shumë vjeçar të organizimit shoqëror dhe ekonomik socialist në Republikën e Maqedonisë me të cilën prona private e cilës do formë qoftë si dhe shpërndarja e të ardhurave u nënshtroa kontrollit shtetëror prona u takonte 'të gjithëve' dhe 'askujt', pra të gjithë shoqërisë, e cila ishte vet arsyeja se pse u quajt kapital shoqëror.

Në vitin 1989 u bën hapat e para në procesit të privatizimit, atëherë kur Republika e Maqedonisë ishte akoma republikë në federatën e atëhershme jugosllave, me sjelljen e Ligjit mbi kapitalin shoqëror dhe të Ligjit për të ardhurat personale, ndryshe të cilët njihen edhe si ligjet e Ante Markoviqit Kryeministrit të atëhershëm të cilët kontribuan në futjen e korporatizimit të caktuar të ndërmarrjeve dhe privatizimin e tyre përmes të ashtuquajturës "aksione të brendshme". Këto aksione janë lëshuar në shumën e kapitalit shoqëror të ndërmarrjeve në vlerën kontabël të tyre të cilat në kushte të hiperinflacionit nënkuptonin një erozion të madh të vlerës së kapitalit shoqëror, kështu që ato ishin "blerë" me një zbritje të skontuar, kryesisht nga punëtorët dhe me kushte shumë të favorshme pagesash që përfshijnë një tarifë në periudhë 10 vjeçare. Një numër i konsiderueshëm të aksioneve ishin "të ngrirë" në numër të caktuar të marrëveshjeve mes punëtorëve dhe ekipeve të menaxhimit në kompani ku metoda e zgjedhur e privatizimit ishte mjaftë e favorshme për menaxherët të cilët shmangnin çdo përfshirje të investitorëve të huaj të mundshëm.⁵⁰

Në këtë proces, mbi 600 ndërmarrje në Maqedoni u shëndërruan në shoqëri aksionare apo në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.⁵¹

Me shpalljen e pavarësisë së Republiës së Maqedonisë me Kushtetutën e vitit 1991⁵² në Republikën e Maqedonisë është futur një rend i ri kushtetues kështu edhe një sistem i ri i rregullimit të marrëdhënieve pasurore ndërmjet qytetarëve.

Kushtetuta e vitit 1991 është miratuar në një kohë kur është shfaqur një krizë e madhe shoqërore në të cilën është gjendur jo vetëm Maqedonia por edhe shtetet tjera të ish-RSFJ-së.

⁵⁰ Славески, Т., Privatization in the Republic of Macedonia, Eastern EUROPEAN Economics, vol.35, no.1,1997, стр.32.

⁵¹ http://www.jewishcommunitybitola.mk/documents/doc_view/107-privatization-in-the-republic-of-macedonia.html (9.10.2019)

⁵² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991, e sjellur më 17 nëntorë 1991

Kjo Kushtetutë është paraqitur si një kushtetutë liberalo-demokratik ku hoqi dorë nga vlerat ideologjike që i kishte mbështetur qeveria e mëparshme edhe atë nga: vetëqeverisja social demokate - qeverisja e klasës punëtore, sundimi absolut i një partie, puna e përbashkët dhe marrëdhëniet e produktionit social, puna e lirë dhe vetëqeverisje.⁵³ Duke marrë parasysh tekstin e plotë të Kushtetutës mund të nënvizohet fakti që u zgjodh prona private si formë themelore e pronësisë në Republikën e Maqedonisë. Kjo veçanërisht bëhet e dukshme nga dispozitat që përcaktojnë bazat e marrëdhënieve ekonomike në Republikën e Maqedonisë si dhe lirinë e tregut dhe ndërmarrësinë si themelet kryesore të sistemit ekonomik por sidoqoftë ekzistonte edhe pronësia shoqërore.⁵⁴

Prania e pronës shoqërore nuk ishte e rregulluar si një formë e veçantë e pronësisë por vetëm është përmendur edhe atë jo në mënyrë të qartë por vetëm në lidhje me burimet natyrore. Qëllimi kryesor i Kushtetutës së vitit 1991 ka qenë shëndërrimi i pronës shoqërore në pronë shtetërore ose private.⁵⁵

Ky proces i shndërrimit të pronës shoqërore në pronë shtetërore ose private fillon përmes masave të privatizimit, restitucionit dhe denacionalizimit. Bazuar në këtë, u miratuan ligjet për privatizim.⁵⁶ Në vitin 1993 me miratimin e Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë filloni privatizimi i ndërmarrjeve me kapital shoqërorë, krahas privatizimit të bankave, tokave ndërtimore dhe hapësirave banesore.

Në mesin e viteve 90- ta në Republikën e Maqedonisë filluan reforma intensive dhe të gjëra strukturore. Reformat u kryen kryesisht në katër fusha edhe atë në:

1. *Shfaqjen e ndërmarrjeve private.*
2. *Privatizimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror.*
3. *Rindërtimin apo rikonstruktimin e ndërmarrjeve.*
4. *Avancimin e qeverisjes korporative në ndërmarrje.*

⁵³ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014, стр. 41

⁵⁴ По ату, fq. 42 -46.

⁵⁵ Беловски, В., Заштита на правотот на сопственост, монографија, Скопје, 2014, стр. 47

⁵⁶ Grubišić, M., Nušinović, M., Roje, G., Prema učinkovitom upravljanju državnom imovinom, Financijska teorija i praksa 33, Zagreb, 2009, str. 335-374.

Sipas profesorit Bobek Shuklev privatizimi në atë kohë u përcaktua si një bosht i reformave ekonomike dhe politike të vendit.⁵⁷ Qysh në fillim të realizimit të saj, procesi i privatizimit në Republikën e Maqedonisë ishte i stërmbushur me shumë paqartësi lidhur me atë se si shteti duhej ta udhëhiqte procesin dhe për modelin e ardhshëm të sistemit ekonomik politik social. Braktisja e rendit ekonomik socialist dominues të 50 viteve të fundit kishte për qëllim arritjen e efikasitetit më të madh me mjetet e prodhimit dhe gradualisht adoptimin e logjikës së tregut dhe nxitjen e frymës sipërmarrëse, paralelisht me këto procese privatizimi duhet të kishte mundësuar një rritje të vazhdueshme të produktit social i cili do të kontribonte në progresin e përgjithshëm social të vendit në tërësi e si rezultat i gjithë kësaj do të ishte krijimi i një sektori privat të fortë dhe dinamik i cili është çelësi për arritjen e tranzicionit dhe ekonomisë së tregut. Gjithashtu gjatë udhëheqjes së procesit ekzistonin edhe polemika të shumta lidhur me atë se Republika e Maqedonisë a e ka zgjedhur rrugën e drejtë për privatizim të kapitalit shoqëror apo është një akt kriminel, grabitje e dhunshme e pasurisë shoqërore?!

Karakteristike për periudhën fillestare të privatizimit në Republikën e Maqedonisë është se në krahasim me republikat e tjera jugosllave më të avancuara, procesi i shpërndarjes së aksioneve të brendshme në Republikën e Maqedonisë ka vazhduar edhe pas shpërbërjes së RSFJ-së. Megjithatë në gusht të vitit 1991, Qeveria maqedonase ka njoftuar se Ligji Federal për Privatizimin nuk ishte më i vlefshëm dhe kanë filluar përgatitjet për një strategji të pavarur të privatizimit. Qeveria ka punuar për një ligj të ri mbi privatizimin gati se dy vjet, i cili u miratua nga Asambleja e RM-së në fund të qershorit të vitit 1993. Vakumi dy vjeçar ligjor dhe kalimi i më shumë se një viti pas miratimit të LTNKS – së mbi deri në marrjen e aksioneve të para, ishte një periudhë e shpronësimit të shpejtë të kapitalit shoqërorë.⁵⁸

Të lënë në një vakum ligjor dhe institucional dhe të ballafaquar me pasiguri rreth drejtimit të ardhshëm të procesit të privatizimit, kompanitë kanë mbyllur të gjitha aktivitetet për ristrukturimin organizativ, teknik, teknologjik dhe personal. Ekipet e menaxhimit dhe punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore u gjendën në një situatë paradoksale për të mos investuar në zgjerimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes shoqërore pasi çdo rritje dhe zhvillim që në të ardhmen

⁵⁷ Шуклев, Б., Privatization in the Republic of Macedonia, Eastern Europe Economics, vol.34, no.6, 1994, стр.5.

⁵⁸ Неновски, Т., Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Скопје, 2015 година, стр.13

në masë të madhe mund të rrezikonte gjasat e tyre për të fituar të drejta pronësore në ndërmarrjet e "tyre" kështu që privatizimi i bllokuar ka lënë hapësirë për privatizimin e "spontan" të qetë. Privatizimi spontan ka të bëjë me marrjen e kundër ligjshme të pasurisë nëpërmjet grabitjes së kapitalit social (lidhja e kontratave të dëmshme, kalimi i kapitalit në sektorin privat). Në ndërmarrjet shoqërore të cilat sipas të dhënave zyrtare në atë kohë prodhonin rreth 85 % të produktit social të vendit, në kushte të drejtave pronësore padefinuara për një periudhe të shkurtë kohore u vetë - shkatërruan. Ky proces ishte dramatik gjatë periudhës së vakumit (1992 / 1993) kur në kushtet e rënies së produktit social me 15 % , kurse në pagat u regjistrua një rritje reale, madje me rreth 26% e cila shfaqte një praktikë e tillë e "ngrënjes" së përshpejtuar të kapitalit social.⁵⁹ Gjithashtu është e diskutueshme nëse privatizimi (i ligjshëm dhe i jashtëligjshëm) që ishte kryer deri atëherë do të ishte politikisht i lejueshëm dhe pa goditje të mëdha shoqërore. Nga ana tjetër një praktikë e tillë ishte në funksion të kryerjes së një vlerësimi të holluar të kapitalit me shpresën se në këtë mënyrë çmimi i saj do të ishte më i afërt se sa mundësitë e ngushta për të investuar aspirantë për blerjen e ndërmarrjeve shoqërore.

2.4 Korniza institucionale për zbatimin e privatizimit

Fillimi i transformimit të kapitalit shoqëror në RSFJ me Ligjin për kapital shoqëror të vitit 1989 , i cili u soll pa ndonjë diskutim shkencor apo profesional ku qeveria e atëhershme e RSFJ-së me vete morri rrezik për dështim eventual të procesit të privatizimit.

Pas një periudhe të shkurtë kohore dështoi procesi i privatizimit i cili ishte i pritur qysh nga fillimi i saj, praktika tregoi se koncepti i këshillit ekzekutiv federal lidhur me privatizimin ishte i stërngarkuar me dobësi të shumta, me pasoja negative në zbatimin të saj në planin mikro dhe makro si dhe me implikime serioze negative në sferën sociale. Të gjithë këto shkaqe të lartëpërmendura ishin arsye se pse ish-shtetet e RSFJ-së një nga një filluan ta pezullonin

⁵⁹ Славетски, Т., Македонската економија во транзиција, Институт отворено општество Македонија, Скопје , 1995 година, стр.5,

vlefshmërinë e Ligjit për kapital shoqëror në territoret e tyre, si dhe të fillonin për themelimin e një strategjie të re kombëtare në sferën e privatizimit. Ndryshe nga shtetet tjera Republika e Maqedonisë nuk e suspendoi ligjin e federatës deri më 18 gusht të vitit 1991, përkatësisht deri në ditën kur dispozitat për lëshimin e aksioneve të brendshme mund të zbatohen sipas kushteve të përcaktuara në ligj. Më datë 14 qershor të vitit 1993 kuvendi i Republikës së Maqedonisë e solli Ligjin për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqërorë i cili do të shërbente për realizimin e procesit të privatizimit në trojet e Republikës së Maqedonisë. Një ndër karakteristikat kryesore të realizimit të procesit të privatizimit ishte themelimi i një institucioni i cili do të administrojë procesin e privatizimit – Agjencia e Republikës së Maqedonisë për transferim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror e formuar më 21 tetor të vitit 1993 sipas ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë.⁶⁰ Sipas Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të 31 dhjetor të vitit 1992, gjithsej 1.856 ndërmarrje me kapital shoqëror duheshin të inkludoheshin në procesin e privatizimit ku 100 prej tyre kanë qenë ndërmarrje të mëdha, 229 të mesme dhe 1.069 të vogla. Sipas të dhënave nga prof. Tome Nenovski vlera e ndërmarrjeve objekt të procesit të privatizimit ishte 18.6 miliardë denar apo 1.1 miliardë dollar. Gjithashtu duhet të theksohet se këta ndërmarrje përfaqësojnë apo përbëjnë 50.4% e aktiviteteve të përgjithshme të ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, ku janë të punësuar 53.2% e numrit të përgjithshëm të punëtorëve të Republikës së Maqedonisë.⁶¹

Kapitulli i tretë - III

3. Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror

Burim kryesor për realizimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror në Republikën e Maqedonisë pas shpalljes së pavarësisë dhe themelimit si shtet i pavarur

⁶⁰ Гризо, Н., Давитковски, Б., Приватизација во светот, 1994 година, стр. 149

⁶¹ Неновски, Т., Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Скопје, 2015 година, стр. 23.

autonom është Ligji për transformim ndërmarrjeve me kapital shoqëror⁶² i sjellur nga Asambleja Republikës së Maqedonisë më datë 14 qershor 1993 me të cilën rregullohen kushtet, mënyrat dhe procedura për transformim të ndërmarrjes me kapital shoqëror në ndërmarrje me pronar të njohur (përcaktuar), ku paraprakishtë në gusht të vitit 1991 me vendim të qeverisë u shfuqizua Ligji për kapital shoqëror të cilën Republika e Maqedonisë e kishte trashëguar nga RSFJ si dhe privatizimet deri më atëherë ishin zhvilluar konform dispozita të këtij ligji.

Ligji i ri është sjellur pas debateve të shumta shkencore dhe profesionale të cilët zgjatën diku 2,5 vjet kurse praktika juridike e bazuar në ligjin e ri ka filluar me themelimin e Agjencionit të Republikës së Maqedonisë për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror më tetor të vitit 1993. Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror ndryshe thënë ligji për privatizim përbëhet prej 116 neneve dhe dhjetë kapitujve:

- I. Dispozitat e përgjithshme
- II. Mbrojta e të drejtave të pronarëve të mëparshëm dhe pasardhësve të tyre ligjor
- III. Mënyrat dhe procedurat për transformim
- IV. Dhënia e ndërmarrjes me qira
- V. Transformim me shitjen e të gjitha pasurive të ndërmarrjes
- VI. Transformimi i ndërmarrjes me falimentim
- VII. Agjencia e Republikës së Maqedonisë për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror
- VIII. Zbatimi i dispozitave ligjore
- IX. Dispozitat ndëshkuese
- X. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Qëllimi kryesor i ligjit është *transformimi i ndërmarrjeve me kapital shoqëror në ndërmarrje me të drejta të plota pronësore*, kurse si qëllime dytësore janë:

- *Rritja e efikasitetit ekonomik*

⁶² Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror i shpallur në Gazetën Zyrtare me nr.48/1993, më 21.06.1993, i hyrë në fuqi më 29.06.1993.

- *Tërheqjen e kapital të huaj*
- *Zhvillimin e tregut të kapitaleve*
- *Krijimi i mundësive të reja për shlyerjen e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të shtetit*

Vonesa për sjelljen e një ligji të ri për privatizim në Maqedoni ishte i dukshëm, për vonesën e të cilës ekzistonin arsye të shumta. Arsyeja e parë dhe më e rëndësishmja ka të bëjë me atë se në vendin tonë drejtat pronësore nuk ishin të definuara ashtu siç duhet (mendohet për pronësinë shoqërore dhe vetëmenaxhimin e punëtorëve). Në kushtet e pronësisë shoqërore ka një situatë qesharake: punëtorët të cilët e blejnë ndërmarrjen vet e përcaktojnë çmimin. Së dyti privatizimi masiv dhe i pakontrolluar sipas Ligjit mbi kapitalin social të Markoviqit. Së treti u neglizhua njohuria e njerëzve kompetentë që kanë një pasqyrë në përvojat e procesit të privatizimit në vendet e Europës Perëndimore dhe në zhvillim.⁶³

3.1 Objekti i procesit të privatizimit

Në nenit 2 të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror në mënyrë decide numërohen ndërmarrjet të cilët mund të jenë objekt i procesit të privatizimit edhe atë:

1. *Ndërmarrjet shoqërore*
2. *Ndërmarrjet me pronësi të përziera kur, në bazë të aseteve shoqërore të investuara në to, nuk janë marrë drejtat pronësore mbi ndërmarrjet*
3. *Organizatat e shoqërive të punës dhe të biznesit që kryejnë veprimtari ekonomike dhe ende nuk janë organizuar si ndërmarrje*

Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror në vazhdim në nenin 3 flet për ndërmarrjet të cilët nuk mund të jenë lëndë e privatizimit edhe atë:

⁶³ Славетски, Т., Македонската економија во транзиција, Институт отворено општество Македонија, Скопје, 1995 година, стр.95.

1. *Ndërmarrjet dhe organizatat, të cilat me ligj dhe me vendim të bazuar në ligj kryejnë veprimtari apo aktivitete me interes të veçantë shoqëror, përkatësisht shërbim publik ose kanë statusin e ndërmarrjes publike*
2. *Ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë që menaxhojnë ujërat, pyjet, tokën dhe mirat tjera publike, si dhe banesat dhe hapësirat afariste*
3. *Ndërmarrjet shoqërore, aktiviteti i të cilëve është organizimi i lojërave të fatit*
4. *Ndërmarrjet që në përputhje me ligjin kanë pozitë monopole*
5. *Bankat dhe organizatat financiare*
6. *Organizatat e sigurimeve*
7. *Kooperativat*

Në procesin e transformimit të ndërmarrjeve me kapital social, duhet të merren në konsideratë disa kushte dhe veprime të veçanta si:

- a) *Nuk mund të fitohen drejtat pronësore mbi burimet natyrore, botën e kafshëve dhe bimëve, të mirat në interes të përgjithshëm, objektet dhe sendet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike*
- b) *ndërmarrjet që kanë treguar humbje gjatë performancës nuk mund të transformohen nëse mbulimi i humbjes bëhet duke e reduktuar vlerën e kapitalit social*
- c) *Ndërmarrjet për të cilat është hapur procedura e falimentimit duhet të riparohen dhe riorganizohen*
- d) *Ndërmarrjet për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ndërmarrjet për punësimin të personave me nevoja të veçanta si dhe pjesët e ndërmarrjeve të organizuara si punëtori mbrojtëse mund të transformohen me kusht që të sigurohet e drejta për punësim dhe e drejta për punë të tyre mbi këtë bazë*

3.2 Subjektët me drejtë pjesëmarrjeje në procesin e privatizimit

Subjektët të cilët gjatë procesit të privatizimit mund të paraqiten në statusin e blerësit të pronës e cila është lëndë apo objekt i privatizimit quhen përfitues të privatizimit apo subjekt me

të drejtë pjesëmarrjeje në procesin e privatizimit. Sipas LTNPК-së subjektët të cilët mund të marrin pjesë në procesin e privatizimit janë:

a) Personat fizik dhe juridik të vendit

b) Personat fizik dhe juridik të huaj

Kjo do të thotë se subjektët vendas dhe të huaj kanë trajtim të barabartë në lidhje me blerjen e ndërmarrjeve me kapital shoqëror. Dallimet mes tyre ekzistojnë në kushtet në të cilat disa prej tyre mund të bëhen pronar të ndërmarrjeve me kapital shoqëror.

Kështu, për të përmirësuar efikasitetin e procesit të privatizimit dhe për të justifikuar parimin e drejtësisë në procesin e privatizimit, ligjvënësi ka parashikuar devijime të caktuara në llojin e subjekteve që mund të marrin pjesë në procesin e privatizimit gjithashtu në pozitën e tyre në atë proces.

Kështu, ndërmarrja dhe subjekti tjetër ligjor në të cilin kapitali shoqëror merr pjesë me më shumë se 30% në vlerën e ndërmarrjes, nuk mund të marrin pjesë në transformimin e një ndërmarrjeje tjetër. Parimi i regjistrimit parashikon edhe subjektet që kanë të drejtë blerjeje në kushte preferenciale. Këto janë punëtorët që kanë punuar në ndërmarrje të paktën 2 vjet para privatizimit ose nuk kanë punuar për 2 vitet e fundit ose pensionistë që kanë punuar në atë ndërmarrje për të paktën 2 vjet. Përfitimet e këtyre subjekteve reflektohen në zbritjet që ua ofrohen kështu që ata kanë të drejtë në një zbritje fillestare prej 30% plus 1% për çdo vit të punës në kompani. Për objektet në pronësi shoqërore zbritja fillestare është 50% plus 1% për çdo vit shërbimi në ndërmarrje, kështu që zbritja maksimale mund të shkojë deri në 90%. Punëtorët gjithashtu mund të blejnë aksione me një zbritje deri në 25,000 marka gjermane dhe jo më shumë se 30% të vlerës së vlerësuar të ndërmarrjes.⁶⁴

Në këtë pikë, duhet të theksojmë veçanërisht emetimin falas të aksioneve. Përkatësisht në një fazë të hershme të procesit të privatizimit të një ndërmarrje, ajo automatikisht duhet të

⁶⁴ Гризо, Н., Давитковски, Б., Приватизација во светот, Скопје, 1994 година, стр 154.

transferojë 15% të kapitalit shoqëror (në formën e aksioneve falas)në fondin e pensionit, dhe pritët të përmirësojë pozicionin financiar të fondit në një pjesë të mirë.⁶⁵

Sipas ligjit⁶⁶, ish-pronarët që kanë të drejta të caktuara pronësore mund të paraqiten gjithashtu si subjekte. Pra, derisa të miratohet ligji për denacionalizimin, i cili do të rregullojë çështjen e marrëdhënieve të pronësisë me ish-pronarët, LTNKS është marrë për zgjidhjen e çështjes në një mënyrë të suksesshme. Pra para se të merret vendim për privatizimin, ndërmarrja është detyruar të publikoj shpallje dhe të informojë publikun se do të privatizohet si dhe të ftoj ish-pronarët (paditësit siç i quan ligjvënësi) ose pasardhësit e tyre ligjorë brenda afatit 60 ditorë të paraqesin kërkesat e tyre. Lidhur me kërkesën e ish pronarëve, ndërmarrja duhet të transferojë aksione në Agjenci të cilët do t'i zotërojë si pronar me mirëbesim deri sa të miratohet një ligj i veçantë që do ta rregulloj çështjen (në këtë rast Ligji për denacionalizi), derisa pronarët e mëparshëm të marrin vendim ligjorë që ata mund të ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore mbi kapitalin e ndërmarrjes).

Parimi i hyrjes së lirë nënkupton edhe ekzistimin e kushteve të barabarta për përvetësimin e kapitalit shoqëror nga ndërmarrja. Kurse realizimi në praktik i privatizimit të kapitalit shoqëror ka reflektuar ndryshe, ajo ka rezervuar blerjen e pronësisë së ndërmarrjes së kapitalit shoqëror vetëm për punëtorët aktualë të ndërmarrjes kurse të tjerët janë përjashtuar ose kanë patur mundësi të kufizuar në privatizimin e kapitalit shoqëror pasi që kjo është konsideruar si një zgjidhje e vetme e drejtë si dhe një zgjidhje që do të mundësonte privatizimin e shpejtë dhe frontal të kapitalit shoqëror. Por duhet të theksohet se ideja e drejtësisë sociale në konceptimin e sistemit të privatizimit u bazua në premisat thelbësisht të gabuara që kapitali shoqëror është vetëm një nënprodukt i punëtorëve të ndërmarrjes.

Të gjithë personat fizik dhe juridik , vendas dhe të huaj kanë trajtim të barabartë dhe i nënshtrohen kushteve të njëjta gjatë procesit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital social. Në këtë kontekst paraqiten tre kategori:

Së pari, punëtorët aktualë, ish-punëtorët dhe pensionistët kanë privilegje të dyanshme

⁶⁵ Për më shume shihni në nenin 19 të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror

⁶⁶ Për më shumë shihni nenet 33- 44 të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror

- *E drejta e përparësisë në fitimin e pronësisë në ndërmarrjen në të cilën ata punojnë ose kanë punuar.*
- *Blerja në kushte preferencial me zbritje themelore prej 30%.*

Së dyti, Fondi i Pensionit dhe Sigurimit invalidor merr 15% të vlerës totale të aksioneve të emetuara, ose aksioneve të ndërmarrjeve të shëndërruara falas. E drejta e dividendit fiksohet në 2% në vit, pastaj e drejta për pjesën proporcionale në pjesën tjetër të fitimeve, si e drejta për pjesëmarrje proporcionale në rast falimentimi ose likuidimi.

Së treti, ish pronarët dhe trashëgimtarët e tyre ushtrojnë të drejtën e tyre për riprivatizim në rrugë gjyqësore kurse vendimi përfundimtarë për të drejtat e tyre sillet në bazë të ligjit për denacionalizim. Sidoqoftë kërkesa e tyre krijon detyrim për ndërmarrjen që të emetojë aksione Agjencisë në lartësi të shumës së kërkesës së tyre.⁶⁷

3.3 Dokumentet e nevojshme në procesin e privatizimit

Programi i privatizimit do të duhet të zbatohet në përputhje me udhëzimet për përgatitjen e programeve të privatizimit të përgatitura nga agjencia e privatizimit. Agjencia e Privatizimit i ka përcaktuar dokumentet e nevojshme të cilët ndërmarrjet duhet ti përgatitnin dhe të dorëzonin pranë autoriteteve kompetente për zbatimin e procesit të privatizimit. Dokumenti kryesor i nevojshëm për privatizim është vendimi për transformim të ndërmarrjes me kapital shoqëror i përpiluar nga organi drejtues i ndërmarrjes. Së bashku me vendimin për transformim ndërmarrja duhet ti paraqet edhe dokumentet në vijim:

1. *Vendimi i vlerës së ndërmarrjes*
2. *Programi për metodën e propozuar të privatizimit*
3. *Raporti i revizionit për zbatimin e ligjit të kapitalit shoqëror*
4. *Regjistrimi gjyqësor i ndërmarrjes*

⁶⁷ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр.13.

5. Dëshmi për të drejtat sendore mbi pasuritë e ndërmarrjes⁶⁸

Pas mbledhjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme, kompania i dorëzon ato në Agjenci, Agjencia do ti shqyrtoj ato dokumente dhe do të jep mendimin e saj në Komisionin e Privatizimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i cili merr një vendim përfundimtar duke bërë të mundur që të fillojë transaksioni. Nëse ndërmarrja ka filluar procesin e privatizimit në përputhje me ligjin e mëparshëm, ajo do të jetë subjekt i rishikimit nga Zyra e të Ardhurave Publike. Në të njëjtën kohë vendimi për fillimin e privatizimit në ndërmarrje të caktuar duhet të shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" ose në njërën nga gazetatat ditore, me qëllim të informimit të kreditorëve të ndërmarrjes.

3.4 Efektet e pritura nga procesi i privatizimit

Efektet nga vendimet për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror priten të jenë të shumëanshëm dhe pjesë e strategjisë për ndryshim të sistemit të deriatëhershëm ekonomik. Qëllimet globale të strategjisë së privatizimit korrespondojnë me efektet e pritura edhe atë.⁶⁹

1. *Të rrit besueshmërinë dhe mbështetjen për reformat*
2. *Të sigurojë një ekonomi më efikase dhe më të përgjegjshme*
3. *Të tërheq kapitalin e huaj*
4. *Të aktivizoj kapitalin vendas statik*
5. *Të shkarkoj bilanci të sistemit bankar*
6. *Të ul deficitin buxhetor, veçanërisht në fondin e pensioneve*
7. *Të siguroj sigurim social popullatës*
8. *Të siguroj dinamikë stabile të zhvillimit ekonomik*
9. *Të zhvilloj tregun e kapitalit*

⁶⁸ Për më shumë shihni në nenin 15 – 16 të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë.

⁶⁹ M.Sukarov, Report of Privatization in Macedonia, United Nations on and Swedish International services Conference on Privatization of Public Sector Activities, Stockholm, 5 – 7 sept. 1994 , page. 7.

Procesi i privatizimit mbi të gjitha ka efekte financiare, sociale, institucionale, juridike, zhvilluese e të tjera.

Efektet finaciare pasqyrohen në të ardhurat që i realizon shteti drejtpërdrejt nga shitjet⁷⁰ dhe në mënyrë indirekte përmes rritjes së pritshme të aktivitetit ekonomik të ekonomisë (taksat nga shitjet, taksat e korporatave, kontributet nga shëndetësia, sigurimet invalidore dhe pensionale e të tjera) si dhe duke e tërhequr kapitalin e huaj për investime në fondet fikse dhe qarkulluese, aktivizimin e parave të imobilizuara të popullatës dhe rritjen e besueshmërisë së sistemit bankar pas shkarkimit të balanceve të tyre.

Efektet sociale pasqyrohen nga tendenca e përgjithshme për të optimizuar kombinimin e faktorëve të prodhimit ku mund të pritet rritje e punësimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

3.5 Agjencioni për privatizim – Institucion kryesor

Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror i vitit 1993 i Republikës së Maqedonisë për herë të parë ka paraparë një instancë më të lartë juridike apo institucion i cili do të do të ketë autorizime të caktuara me ligj si dhe do të jetë përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe kontrollin e procesit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror. Më datë 21 tetor të vitit 1993 sipas ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë u themelua Agjencia e Republikës së Maqedonisë për transformim të kapitali shoqëror, institucion për të administruar dhe për të mbështetur procesin e privatizimit në Republikën e Maqedonisë. Agjensioni ka statusin e personit juridik roli i së cilës është:

1. *Punë ekspertuese dhe këshilluese lidhur me procesin e privatizimit*
2. *Disponimi me kapitalin shoqëror, respektivisht ushtrimi i të drejtave pronësore mbi kapitalin shoqëror gjatë procesit të privatizimit të saj.*⁷¹

⁷⁰ М.Шукароб, С. Ристовска, В. Хаџи Василева – Марковска, Платформа за преговори со ММФ, сепарат: Сопственичка трансформација на претпријатијата со општествен капитал, Влада на Р. Македонија, Скопје, 1993 година, стр.42 .

⁷¹ Недков.М., Беличанец.Т., Коментар на законот за трансформација на претпријатија со општествен капитал со модели на акти за негова примена, Скопје, год.1993, стр.183

Kur flasim për statusin e përgjithshëm të Agjencisë duhet të theksojmë se është një ndërmarrje publike faktikisht një institucion kuazi – qeveritar e cila financohet nga të ardhurat që burojnë nga shitja e ndërmarrjeve me kapital shoqëror (pas mbulimit të shpenzimeve të Agjencisë, pjesa e ngelur e fondit duhet të transferohet në buxhetin e republikës, ky aktivitet përsëritet një herë në muaj). Agjencia për privatizim drejtohet nga Këshilli apo Bordi i drejtorëve i përbërë nga nëntë anëtarë nën udhëheqjen e drejtorit (drejtori dhe anëtarët e bordit emërohen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë), Agjencia e privatizimit poashtu është e detyruar të dërgojë rrjedhimisht raport gjashtë mujor Qeverisë për punën e saj dhe raport vjetor Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Nga të dhënat e lartëshënuara lidhur me statusin e institucionit të privatizimit respektivisht Agjencisë për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror mund të konkludohen tre karakteristika thelbësore edhe atë:

1. *Institucion me status të personit juridik*
2. *Institucion me autorizime publike – institucion kuazi – qeveritar*
3. *Institucion me pavarësi operative*

Këto karakteristika të lartëpërmendura lidhur me statusin e agjencisë për privatizim në radhë të parë duken më ndryshe në krahasim me organet tjera shtetërore, pra nuk është dhe nuk mund të krahasohet me organet shtetërore edhe pse disponon me një sasi të madhe të kompetencave publike të cilat hyjnë në zonën tipike juridiko administrative.⁷² Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror rrjedh se Agjencioni është organizatë e pavarur me statusin e personit juridik i cili me kompetencat e tij të cilët burojnë vet nga ligji, dhe vet kujdeset për mbarësinë e procesit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror. Por nëse bazohet në mënyrën e formimit, emërimit e organeve, përgjegjësinë për zgjidhjen e çështje të lidhura me statusin dhe financimin atëherë lirisht mund të definohet si organizatë qeveritare d.m.th një organizatë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që njihet si person juridik dhe me autonomi në punën e saj si dhe

⁷² Недков.М., Беличанец.Т., Коментар на законот за трансформација на претпријатија со општествен капитал со модели на акти за негова примена, Скопје, год.1993, стр.183

përgjegjës për organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin e procesit të transformimit të ndërmarrjes me kapital shoqëror.⁷³

Në këtë pikë duhet të theksohet gjithashtu roli i Agjencisë në organizimin, administrimin dhe kontrollin e transformimit të ndërmarrjes me kapital shoqëror edhe atë në tre role :

1. *Pjesëmarrja në organizimin e procesit të transformimit të ndërmarrjeve.*
2. *Kryerja e menjëhershme e procedurave të transformimit të ndërmarrjeve .*
3. *Kontrolli mbi proceset e transformimit të ndërmarrjeve.*

3.5.1 Detyrimet e Agjencisë për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror

Krahas kompetencave dhe të drejtave të Agjencisë të cilët burojnë nga ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, kemi edhe detyrimet e Agjencisë gjatë zhvillimi të procesit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror të cilët mund ti grupojmë në pesë grupe edhe atë:⁷⁴

1. Detyrimet e Agjencisë (të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë) në lidhje me programet e transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, të cilat përbëhen nga:
 - a) *administrimi dhe kontrolli i programeve të transformimit*
 - b) *dhënia e këshillave juridike në Komisionin e Qeverisë në lidhje me programet individuale të transformimit*
 - c) *pjesëmarrje në bordet e transformimit lidhur në përgatitjen e transformimit të ndërmarrjeve të mëdha.*
 - d) *drejtimi i procedurave të transformimit për ndërmarrjet të cilët nuk do të paraqesin programet e tyre për transformim brenda afatit të paraparë ligjor.*

⁷³ Недков.М., Беличанец.Т., Коментар на законот за трансформација на претпријатија со општествен капитал со модели на акти за негова примена, Скопје, год.1993, стр.184.

⁷⁴ Гризо,Н., Давитковски,Б., Приватизација во светот, Скопје, 1994 година, стр 157-159,

2. Detyrimet / Përgjegjësitë e Agjencisë për shitjen e aksioneve dhe ushtrimi i drejtave pronësore mbi aksionet që përbëhen nga:
 - a) *shitja e aksioneve të pashitura duke i shndërruar ato nga aksione preferenciale në aksione të zakonshme.*
 - b) *regjistrimi dhe evidentimi i aksioneve të zakonshëm të Agjencisë në ndërmarrjen e privatizuar dhe pjesëmarrja në menaxhimin e tyre, sipas numrit të aksioneve të saj.*
 - c) *pronësia e aksioneve në emër të ish-pronarëve deri sa ata .*
 - d) *të dëshmojnë pronësinë e tyre.*
3. Detyrimet për vlerësimin e vlerës së vërtetë të ndërmarrjeve që përbëhen nga:
 - a) *përgatitja e metodologjisë për vlerësimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror*
 - b) *autorizim për vlerësim*
 - c) *kontrollim i raporteve vlerësuese*
4. Detyrimet financiare ose operacionet financiare të agjencisë, që përbëhen nga:
 - a) *mbledhja e të ardhurave nga shitjet, dividendët dhe të ardhurat e tjera nga procesi i privatizimit dhe transferimi i mëtejshëm i tyre në buxhet.*
 - b) *çështjet administrative që lidhen me pagesa të bëra në bazë të valutës së huaj të mbajtur si llogari bankare të kursimeve.*
 - c) *ndërmarrja e detyrimeve financiare të ndërmarrjeve që do të pushojnë së funksionuari.*
5. Detyrimet / kompetencat të karakterit ligjor të agjencisë, që përbëhen nga:
 - a) *zhvillimi i negociatave me investitorët e ardhshëm (tretës) dhe lidhja e kontratave*
 - b) *mbledhja e dokumentacioneve (kërkesat, propozimet, provat etj) nga ish-pronarët*
 - c) *ofrimin e ndihmës juridike për të përfunduar kontratat e ndërmarrjeve që e kryejnë procesin e transformimit*

Për sa u theksua mund të konkludohet se Agjencia është e pavarur në punën e saj, pavarësia e së cilës shprehet përmes miratimit të programit vjetor të punës dhe planit financiar të miratuar nga Bordi drejtues i Agjencisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e cila jep pëlqimin e saj për miratimin e tyre. Nga ana tjetër marrëdhëniet e Agjencisë rregullohen nga statuti unik i Agjencisë që rregullon ngushtë organizimin e operacioneve të agjencisë, gjegjësisht Agjencia organizon punën e saj në disa sektorë edhe atë:

- 1) *Spektori i Transformimit të Pronësisë dhe Ristrukturimit të Ndërmarrjeve*
- 2) *Spektori financiar*
- 3) *Spektori i kontrollit*
- 4) *Spektori juridik*
- 5) *Spektori për marrëdhënie me publikun*
- 6) *Spektori administrativ*

Përndryshe statuti i Agjencisë për privatizim miratohet nga Bordi drejtues i Agjencisë brenda 30 ditëve nga themelimi i tij por ajo bëhet i vlefshëm pasi Qeveria e Republikës së Maqedonisë të ketë dhënë pëlqimin e saj. Përveç Agjencisë, një komision i veçantë qeveritar është parashikuar të kryejë transformimin si një organ që merr pjesë në mënyrë aktive në këtë proces. Ky komision është i përbërë nga 5 anëtarë dhe kompetenca themelore e tij është të marrë vendime përfundimtare për zhvillimin e procedurës instancionale dhe kryerjen e mbikëqyerjes intancionale në lidhje me transformimin e ndërmarrjeve. Përveç këtij komisioni ekziston një ministër (pa portofol) i ngarkuar me procesin e privatizimit dhe pse në Republikën e Maqedonisë nuk ka një ministri të veçantë të privatizimit (të cilët ministri ekzistojnë pothuajse në të gjitha vendet postkomuniste).⁷⁵

3.6 Ndarja e ndërmarrjeve me kapital shoqëror

Transformimi i kapitalit shoqëror në Republikën e Maqedonisë zhvillohet në mënyrë autonome dhe të decentralizuar kurse ndërmarrjet varësisht nga madhësia e tyre janë subjekt kryesor të

⁷⁵ Гризо,Н., Давитковски,Б., Приватизација во светот, Скопје, год.1994, стр 160.

procesit të transformimit. Ndarja e ndërmarrjeve në ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha përcaktohet nga numri mesatar i të punësuarve, në bazë të orëve punuese gjatë një viti, të ardhurave vjetore të kuantizuara në pagat e rregullta mujore për punëtorët e ndërmarrjeve të Republikës së Maqedonisë dhe vlerën mesatare të aktiveve të biznesit (nga fillimi deri në fund të vitit) në krahasim me pagat mesatare mujore të punëtorëve të ndërmarrjeve të Republikës së Maqedonisë.

Kështu që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë të pavarura në aspektin e përcaktimit mënyrës dhe procedurës së transformimit derisa ndërmarrjet e mëdha lidhur për këto çështje vendosin në mënyrë të përbashkët me agjencionin për privatizim.⁷⁶

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë të detyruar të vendosin lidhur për transformimin e tyre në afat prej një viti, kurse ndërmarrjet e mëdha deri në periudhën e kontraktuar me agjencionin e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dy vjet nga dita e hyjes në fuqi të metodologjisë së vlerësimit të ndërmarrjes e miratuar nga qeveria e Republikës së Maqedonisë.⁷⁷

Madhësia	Numri mesatar i punëtorëve	Të ardhurat vjetore	Vlera mesatare e aseteve të biznesit
Ndërmarrje të vogla	Deri 50 punëtorë	Më pak se 8.000 rroga	Më pak se 6.000 rroga
Ndërmarrje të mesme	Deri 250 punëtorë	Më pak se 40.000 rroga	Më pak se 30.000 rroga
Ndërmarrje të mëdha	Mbi 250 punëtorë	Më shumë se 40.000 rroga	Më shumë se 30.000 rroga

⁷⁸

⁷⁶ Стефановски,Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 14.

⁷⁷ Стефановски,Б., Приватизација на општествените претпријатија, Скопје, год.1994, стр.14

⁷⁸ По ату, fq.14.

3.7 Fazat e procesit të privatizimit

Procesi i privatizimit në Republikën e Maqedonisë njihet si një ndër proceset të zhvilluara në një periudhë të gjatë kohore, me kompleksitete të shumëfishta dhe paqartësi të shumta. Nëse do të duhet të bëhet përcaktimi i fazave nëpër të cilat ka kaluar procesi i transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror mund të përcaktojmë kryesishtë tre faza edhe atë:

Faza e parë e cila njihet si faza fillestare e procesit të privatizimit, që daton qysh nga viti 1990 në bazë të Ligjit për qarkullim dhe disponim me kapitalin shoqëror⁷⁹ të miratuar nga qeveria e fundit federale e ish-RSFJ-së. Zbatimi i këtij ligji në Republikën e Maqedonisë u realizua me entuziazmin më të madh dhe më të gjatë krahasuar me republikat e tjera të ish-federatës. Nuk do të ishte gabim të thuhet se Ligjet e Ante Markovigjit ishin ligje të cilët kishin gjetur zbatim kryesisht në territoret e Republikës së Maqedonisë me anë të cilëve ishte kryer procesi i privatizimit përderisa politikat e shteteve të ish-federatës si atë të Sllovenisë dhe Kroacisë ishin drejt pezullimit të Ligjeve të Ante Markovigjit dhe formimit të strategjisë kombëtare për privatizimin e kapitalit shoqërorë kurse ligjet e privatizimit të ish-RSFJ-së në Republikën Serbe gjetën zbatim në mënyrë kufizuese. Ndarja e pushtetit në sistemin politik maqedonas ishte e tillë që i ashtuquajturi "lobi i drejtorit" pasi filloi të quhej si grup joformal i drejtorëve të ndërmarrjeve të mëdha shoqërore ishte në gjendje të prishë çdo përpjekje për të pezulluar ligjin e Markoviqit deri në përfundimin e tij në mënyrë efektive, pra deri më 18 gusht 1991.⁸⁰ Mundësia për të blerë aksione me zbritje si dhe disa shtrembërime në zbatimin e rregulloreve, veçanërisht ato që lidhen me pagimin e pagave, pothuajse e kanë shndërruar konceptin në një proces privatizimi falas. Shumë shpesh menaxherët dhe punëtorët kanë gjetur mënyra për të rritur në mënyrë fiktive pagat e tyre që janë përdorur për pagesën e aksioneve të lëshuara. Në atë mënyrë ata mund të fitonin një përqindje më të madhe të pronësisë në kompanitë e tyre duke paguar një shumë të parave të papërfillshme.⁸¹

⁷⁹ [Закон за прометот и располагањето со општествениот капитал](#), Службен лист на СФРЈ 84/89.

⁸⁰ Арсов С., Stock Market Rationale under Conditions of Defective Corporate Governance- The case of Macedonia, Mediterranean Journal of Social Sciences, vol.4. no.2,2013, fq.303.

⁸¹ По аty, fq.303.

Faza e dytë mund të shënohet si një periudhë e përgatitjes dhe e betejave politike mbi miratimin e ligjit për transformimin e ndërmarrjeve shoqërore. Një periudhë e vakumit ligjor në privatizim që zgjati më shumë se dy vjet, pra një periudhë e gjatë kohore. Pasiguria në të cilën subjektet ekonomike u gjendën në Republikën e Maqedonisë, më saktë agonia në ekonomi, ishte një nga gjeneruesit bazë të krizës së atëhershme të thellë ekonomike në të cilën Republika e Maqedonisë u gjend.

Me miratimin e ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, privatizimi në Maqedoni hyri në fazën e tretë. Ligji u bazua në një metodë të ashtuquajtur privatizim të " jashtëm" d.m.th privatizim "rast pas rasti" i cili në atë kohë ishte anakronik krahasuar me përvojat dhe përcaktimet e shumicës së vendeve në tranzicion, pas përpjekjeve të pa suksesshme për privatizim në ekonomitë e tyre, bazuar kryesisht te shitja e ndërmarrjeve njëra pas tjetrës në një variant të shpejtë dhe masiv të privatizimit, përmes shpërndarjes falas (ose tarifës nominale) të letrave me vlerë që përfaqësonin një pjesë të pasurisë shoqërore që i nënshtrohet privatizimit.⁸²

Fakti që për një periudhë kohore të gjatë prej 20 muajsh nga data e miratimit të ligjit deri në tre mujorin e parë të vitit 1995, asnjë kompani e re nuk u privatizua sipas ligjit të ri, flet mjaftueshëm për shkallën shumë të ulët të zbatueshmërisë dhe efektivitetit të modelit të zgjedhur të privatizimit.⁸³

Vala e parë e privatizimit rezultoi me krijimin e mallrave të mëdha pronësore (aksione ose pjesëve) nga punëtorët dhe menaxherët. Përqindja totale e kapitalit privat në Maqedoni arriti diku rreth 19%, ndërsa mesatarja për të gjitha ish- republikat jugosllave ishte 10%. Kjo ishte pengesë e madhe për fazën e tretë, ku kompanitë nuk ishin të hapura për hyrjen e investitorëve të tjerë. Por menaxherëve iu dha mundësia për të formuar procesin në një mënyrë që do të ishte më e përshtatshme për të mbajtur kontrollin në kompani/ndërmarrje. Në një situatë të tillë ishte dukshëm mbizotërimi i metodës së "blerjes nga ana e punëtorëve" dhe "blerjes nga ana e menaxherëve", të cilat kur zbatoheshin në kushte të kapitalit të privatizuar

⁸² Неновски Т., Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Стручна мон., 2015, fq. 39.

⁸³ Славески Т., Македонската економија во транзиција, Институт отворено општество Македонија, 1995, fq.109.

më parë nga 40-50 % jepnin më pak mundësi për hyrjen e investorëve të jashtëm në procesin e privatizimit.⁸⁴

Kjo nga ana tjetër rezultoi me një përqendrim më të lartë të pronësisë në duart e menaxherëve. Menaxherët në mënyrë efektive dhe pa kundërshtim kishin kontrollin e kompanisë sepse një përqindje e madhe e aksioneve të mbetura ishin në pronësi të të punësuarve. Punëtorët nuk ishin në gjendje të vepronin si aksionarë të mirëfilltë, pasi ata varen nga të njëjtët menaxherë për të mbajtur punët e tyre pasi që posedimi i një pune në një shtet me një papunësi prej 32% është shumë më e rëndësishme sesa të qenit aksionar aktiv ose investor.⁸⁵

3.8 Procesi i transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror

Procesi i transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror në përputhje me dispozitat e Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror kalon në disa procedura edhe atë:⁸⁶

- a) Në ndërmarrje sillet vendim për të transformuar ndërmarrjen, iniciativa për marrje të vendimit për privatizim i takon Drejtorit Menaxhues të ndërmarrjes. Pas propozimit të parashtruar nga autoriteti menaxhues/ekzekutiv të ndërmarrjes në lidhje me fillimin e transformimit të ndërmarrjes, vendimi për transformim të ndërmarrjes me kapital shoqëror do të merret nga ana e organit drejtues të ndërmarrjes. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vendimi për transformim merret në mënyrë të pavarur nga organet e tyre drejtuese. Por kur është fjala për ndërmarrjet e mëdha, atëherë vendimi për transformim përgatitet nga Bordi i transformimit i formuar në bazë barazie nga organi menaxhues i ndërmarrjes dhe Agjencia e privatizimit, dhe vetë vendimi i transformimit është bërë në përputhje me Agjencinë e privatizimit.
- b) Ndërmarrja zhvillon një program mbi atë se si të realizohet transformimi, brenda të cilit specifikohen metodat, mënyrat dhe procedura e transformimit të cilët varen kryesisht

⁸⁴ Арсов С., Stock Market Rationale under Conditions of Defective Corporate Governance- The case of Macedonia, Mediterranean Journal of Social Sciences, vol.4. no.2,2013, pag.303.

⁸⁵ По аty, fq.304.

⁸⁶ Гризо Н., Давитовски Б., Приватизација во светот, Просвета –Куманово, 1994, стр..160-163.

nga madhësia e ndërmarrjes. Përkatësisht ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme mund të shëndërrohen në shoqëri aksionare, nga ana tjetër ndërmarrjet e mesme me pëlqimin e agjencisë mund të shëndërrohen në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Sa i përket ndërmarrjeve të vogla ata mund të shëndërrohen në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me përjashtim me pëlqimin paraprak të agjencisë së privatizimit ndërmarrjet e vogla mund të shëndërrohen në shoqëri aksionare.

- c) Realizohet përgatitja e një raporti mbi vlerën e vlerësuar të ndërmarrjes. Në këtë fazë kompania punëson një prej vlerësuesve të rrethit i cili duhet të kryente vlerësimin e vetë kompanisë. Duhet të theksohet në mënyrë të veçantë që ndërmarrjet që iniciuan procesin e transformimit në përputhje me ligjin për kapitalin shoqëror, duhet të vazhdojnë të kontrollohen nga shërbimi i kontabilitetit shoqëror dhe të kryejnë aktivitetet e tyre të mëtejshme në lidhje me transformimin në përputhje me aktivitetet e përfshira dhe të treguara në raportin e shërbimit të kontabilitetit shoqëror.
- d) Dorëzimi i dokumenteve të nevojshme (së bashku me vendimin për transformim) deri te Agjencioni për privatizim. Vendimi për transformim të ndërmarrjes i komunikohet Agjencionit dhe Komisionit pranë Qeverisë brenda 15 ditëve nga miratimi i vendimit për transformim. Para sjelljes së vendimit për transformim, ndërmarrja është e detyruar që të shpallë një thirrje për ish-pronarët e ndërmarrjes dhe trashëgimtarët e tyre ligjor që brenda 60 ditëve nga dita e shpalljes të paraqesin e tyre ndaj ndërmarrjes.
- e) Agjencia për privatizimit duhet të paraqet mendimin e saj në Komisionin Qeveritar lidhur me transformimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, nëse transformimi i propozuar përputhet me kushtet, mënyrën dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Sipas ligjit, Agjencioni në afat prej 60 ditësh duhet të jep mendim për atë se transformimi i zhvilluar a është në përputhje me dispozitat ligjore. Bazuar në konstatimin e dhënë nga ana e Agjencionit, Komisioni përgjegjës për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror duhet të merr një vendim brenda 30 ditëve lidhur me fillimin e procedurës së transformimit. Nga ana tjetër ekziston mundësia që të fillojë transformimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha me kapital shoqëror edhe pa dhënien e pëlqimit nga ana e Komisionit Qeveritar të paraqitur me akt juridik zyrtar -vendim.

- f) Vendimi për transformim të ndërmarrjes me kapital shoqëror shpallet në gazetën zyrtare. Ndërmarrja është e obliguar që vendimin për transformimin e saj ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në njërën prej gazetave ditore që botohen në Republikën e Maqedonisë në afat kohor prej 8 ditëve nga dita e pranimi të pëlqimit për transformim të ndërmarrjes nga ana e Komisionit pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.
- g) Në bazë të dokumenteve dhe procedurave të lartpërmendura ndërmarrja shëndërrohet në një shoqëri aksionare apo në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në këtë mënyrë ndërmarrja e shëndërruar në shoqëri aksionare apo në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar bëhet ndjekës i drejtpërdrejtë i ndërmarrjes së transformuar, duke siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë, ekzistencën dhe funksionimin e personit juridik. Me fjalë të tjera të gjitha aktivet dhe detyrimet e ndërmarrjes së mëparshme do të merren përsipër nga shoqëria e re.⁸⁷
- h) Transformimi i ndërmarrjeve rregjistrohet në rregjistër gjyqësorë. Sipas dispozitave të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, transformimi i ndërmarrjeve të realizuara në përputhje me dispozitat ligjore duhet të rregjistrohen në rregjistër gjyqësor, transformimi në shoqëri aksionare apo në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të konsiderohet si i përfunduar në ditën e rregjistrimit në rregjistrin gjyqësorë, me të cilën përfundon edhe procesi i transformimit të ndërmarrjes me kapital shoqërorë.

3.9 Metodat dhe teknikat në procedurën e transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë

Gjatë zhvillimit të procesit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë respektimi i dispozitave ligjore gjatë jetësimit të procesit të privatizimit, profesionalizmi i institucionit udhëheqës janë faktorë vendimtar dhe kyç për një proces të mirëfilltë dhe të suksesshëm, por një faktorë tjetër mjaft i rëndësishëm janë metodat dhe teknikat që duhet të zbatohen apo do

⁸⁷ Po aty, fq.161.

të duheshte të zbatohen gjatë zhvillimit të procesit të privatizimit të cilët përfshinë një sërë elementesh politike, juridike dhe shoqërore që burojnë nga kompleksiteti dhe shumësia e interesave që duhet të përmbushen për zbatimin e suksesshëm të synimeve specifike në procesin e reformimit të strukturës së pronësisë në ekonomi. Përvoja e procesit të privatizimit në mbarë botën ka dëshmuar se metodat e zgjedhura në mënyrë joadekuate janë shkak për të devijuar nga aktivitetet e filluara dhe shpesh faktor kufizues në zbatimin aktual të programeve të privatizimit.

Sipas Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror gjatë procesit të privatizimit varësisht nga madhësia e ndërmarrjeve që janë objekt të privatizimit do të përdoren metoda dhe teknika adekuate, pra faktor kryesor për zgjedhjen e modelit të privatizimit është madhësia e ndërmarrjes. Gjatë procesit të transformimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përdoren metoda dhe teknika më të thjeshta të cilët si rezultat mundësojnë një privatizim më racional, të shpejtë dhe ekonomikisht të qëndrueshëm, derisa transformimi i ndërmarrjeve të mëdha është më e ndërlikuar dhe vendimi për transformim sillet në bashkëpunim mes ndërmarrje, Agjencionit për privatizim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror dhe Komisionit Qeveritar. Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror parasheh 10 mënyra apo metoda ku disa prej metodave vlejnë për të gjitha ndërmarrjet, disa vetëm për ndërmarrjet e vogla, e disa për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna lidhur me metodat e privatizimit dhe zbatimin e tyre në ndërmarrjet me kapital shoqëror.⁸⁸

⁸⁸ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 18.

Metodat dhe teknikat e privatizimit	Madhësia e ndërmarrjeve		
	Të vogla	Të mesme	Të mëdha
Blerja e ndërmarrjes nga ana e punëtorëve	✓		
Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes	✓	✓	✓
Blerja e ndërmarrjes		✓	✓
Shitja e ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes		✓	✓
Emetimi i aksioneve për investime shtesë		✓	✓
Shëndërrimi i kërkesave të kreditorëve në depozita të përhershme		✓	✓
Dhënia e ndërmarrjeve me qira		✓	✓
Shitja e të gjitha pasurive të ndërmarrjes	✓	✓	✓
Transformimi i ndërmarrjes në falimentim	✓	✓	✓
Mbrojta e drejtave të ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre ligjor	✓	✓	✓

3.9.1 Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla

Sipas nenit 41 të LTNKS-së, ndërmarrjet e vogla me kapital shoqërorë transformohen përmes dy mënyrave edhe atë:

1. Blerja e ndërmarrjes nga ana e punëtorëve
2. Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes

Këto dy modele të parapara në ligji janë modelet më të thjeshta, spontane dhe të shpejta, ku interes më të madh për privatizimin e ndërmarrjeve kanë punëtorët që punojnë pranë ndërmarrjes. Kryerja e transformimit të ndërmarrjes së vogël me kapital shoqëror me anë të metodës së blerjes së ndërmarrjes nga ana e punëtorëve e përjashton mundësin e privatizimit të ndërmarrjes me anë të shitjes së pjesës ideale të ndërmarrjes. Pra zbatimi i modelit të parë për privatizim të ndërmarrjes përjashton mundësinë për shitjen e pjesës ideale pasi nuk mbetet

pjesë për shitje dhe anasjelltas shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes vë në rrezik shitjen e ndërmarrjes.

3.9.1.1. Blerja e ndërmarrjes nga ana e punëtorëve

Blerja e ndërmarrjes nga ana e punëtorëve është metodë e veçantë për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror si dhe karakteristikë për ndërmarrjet e vogla. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla me kapital shoqëror me anë të metodës së blerjes së ndërmarrjes nga ana e punëtorëve rregullohet me nenet 42- 47 të LTNKS -së. Të drejtë blerjeje kanë të gjithë të punësuarit e ndërmarrjes dhe atë në kushte të barabarta, ku fillimishtë duhet të blejnë 51% e vlerës së parashikuar të ndërmarrjes në mënyrë dhe kushte të parapara në vendimin për transformim të ndërmarrjes. Ndërmarrja për pjesën e pablerë të kapitalit shoqëror Agjencionit për Privatizim i lëshon një certifikatë për aksione.

Duke u bazuar në nenet 42- 47 të ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror të cilët e rregullojnë metodën e privatizimit me anë të blerjes së ndërmarrjes nga ana e punëtorëve mund të përcaktohen karakteristikat e më poshtme lidhur për metodën edhe atë:

- a) Aksionarët kanë të drejtë të menaxhojnë ndërmarrjen në përputhje me vendimin për të organizuar ndërmarrjen në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të drejtën e dividendit dhe të drejtën për një pjesë proporcionale të pjesës të ngelur të pronës pas pagesës së kreditorëve në rast të likuidimit dhe falimentimit.
- b) Agjencioni si pjesëmarrës aksionar në ndërmarrjet e vogla ka të drejtë për një dividend fikse prej 2% në vit dhe një pjesë të fitimit nëse dividendi nga aksionet e tjera që mund të marrin është më i madh se 2% si dhe e drejta për një pjesë proporcionale të pjesës së mbetur të pasurisë pas pagimit të kreditorëve në rast të likuidimit dhe falimentimit të ndërmarrjes.

- c) Aksionarët janë të detyruar në periudhë kohore prej 5 vite prej ditës së rregjistrimit të transformimit të ndërmarrjes me kapital shoqëror në rregjistrin gjyqësorë të blejnë pjesën e ngelur të aksioneve në vlerën nominale të tyre, të shprehur në bazë të ligjit.
- d) Aksionarët në qoftë se nuk do të blejnë të paktën 1/5- të e aksioneve të mbajtur nga Agjencia, në bazë të kësaj Agjencia ka të drejtë të menaxhojë me aksionet njëjtë si aksionarët tjerë. Për pjesën e cila nuk arrihet të shitet në periudhën e paraparë kohore agjencia e vendos në shitje publike.
- e) Aksionarët në ndërmarrje mund të përdorin dividendën çdo vit për të riblerur pjesë të njësish që zotëron agjencia, derisandërmarrja të shlyhet plotësisht.

3.9.1.2 Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjen

Modeli i dytë i privatizimit të ndërmarrjeve të vogla është shitja e një pjese ideale të ndërmarrjes ku blerësi me blerjen e një pjese ideale të ndërmarrjes bëhet pronar i vetëm i një pjese të ndërmarrjes dhe ndërmarrja shëndërrohet në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Sipas nenit 48 të ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror ekzistojnë dy mënyra për shitjen e pjesës ideale të ndërmarrjes edhe atë:

1. *Me thirrje publike për tender*
2. *Marrëveshje të drejtpërdrejtë*

Karakteristikë e kësaj metode është se ndërmarrja nuk shitet plotësisht, thirrja publike për tender dhe negociatat e drejtpërdrejta do të realizohen nga ana e Agjencisë apo nga ndonjë person fizik apo juridik i autorizuar nga Agjencia. Në cilësinë e shitësit të ndërmarrjes paraqitet Agjencia kurse në cilësinë e blerësit personi fizik dhe juridik i vendit apo i huaj. Çmimi fillestar përcaktohet në vlerën e vlerësuar të ndërmarrjes, megjithatë në mënyrë që pjesa ideale e ndërmarrjes të mos shitet me një çmim më të ulët se 80% e vlerës së vlerësuar. Në rrethana të zakonshme shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes realizohet nëpërmjet ankandit publik, nëse ndërmarrja nuk shitet në ankandin e parë publik atëherë pas ankandit të dytë publik shitja mund të realizohet me anë të një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë me kusht që të

mos shitet ndërmarrja me një çmim më të ulët se 80% e vlerës së parashikuar të pjesës ideale të ndërmarrjes. Kontrata e shitjes së ndërmarrjes do të lidhet mes blerësit dhe Agjencionit në formë të shkruar në përputhje me vendimin e transformimit, pjesëmarrësit të drejtat e të cilëve janë shkelur gjatë procedurës kanë të drejtë ankese pranë agjencionit si dhe të drejtë që të kërkojnë mbrojtje juridike pranë gjykatës kompetente.

Sipas nenit 53 të LTNKS-së, blerësi i pjesës ideale të ndërmarrjes, që është më pak se 51% e vlerës së vlerësuar të ndërmarrjes merr vendim që ta organizojë ndërmarrjen si një kompani me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Agjencinë lëshon çertifikatë aksionesh. Ligji parasheh mundësinë e shitjes së ndërmarrjes edhe përmes shitjes së aksioneve, e cila kryhet në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara me vendimin për të organizuar ndërmarrjen si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Aksionet mund të shiten përmes: thirrjes publike dhe negociatave me blerësit e mundshëm të interesuar. Thirrja për shitjen e aksioneve përmban dispozita lidhur me kushtet e blerjes së aksioneve, afateve të regjistrimit dhe pagesës si dhe dispozita tjera, aksionet mund të shiten në disa faza gjatë gjithë vitit. Shitja nuk mund të jetë e shumëfishtë, afati i fundit për shitjen e aksioneve nuk mund të jetë më i gjatë se një vit.⁸⁹

3.9.2 Transformimi i ndërmarrjeve të mesme

Neni 55 i LTNKS –së numëron pesë metoda për transformim të ndërmarrjeve të mesëm edhe atë:

1. Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes
2. Blerja e kompanisë
3. Shitja e ndërmarrjes të personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes
4. Emetimi i aksioneve për investime shtesë
5. Shëndërrimi i kërkesave të kreditorëve në depozita të përhershme.

⁸⁹⁸⁹ Për më shumë shihni në nenin 54 e LTNKS –së..

3.9.2.1 Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes

Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes së mesme kryhet në bazë të kushteve dhe procedurës së përcaktuar njëlloj si shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes së vogël, pra me thirrje publike për tender dhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë me pjesëmarrjen e agjencisë ose personit fizik/juridik të autorizuar nga vet agjencia.

3.9.2.2 Blerja e ndërmarrjes

Karakteristikat kryesore të metodës së dytë për transformim të ndërmarrjeve të mesme, blerja e ndërmarrjes janë:

- a) Është blerje e njëhershme të kompanisë në vlerë prej 51% të vlerës të përcaktuar të ndërmarrjes, blerësit pas blerjes së parë nuk janë të detyruar të blejnë pjesën e ngelur, e as nga agjencioni nuk kërkohet që aksionet e transferuara ti rezervoj për blerësit për një afat të caktuar kohor.
- b) në cilësinë e blerësve të ndërmarrjeve të mesme mund të paraqiten punëtorët që punojnë në ndërmarrjen në fjalë si dhe persona jashtë ndërmarrjes.
- c) ndërmarrja do të përgatitet për blerje duke u organizuar si shoqëri aksionare.⁹⁰

Në statusin e blerësve të ndërmarrjeve të mesme me kapital shoqëror mund të paraqiten si personat fizik dhe juridik vendas ashtu edhe personat fizik dhe juridik të huaj. Gjatë blerjes së një ndërmarrjeje të mesme punëtorët dhe personat jashtë ndërmarrjes kanë trajtim të barabartë. Blerësi i cili do të ofroj kushte më të favorshme do të jetë më i privilegjuar në krahasim me blerësit tjerë potencial. Kur themi kushte të favorshme nuk duhet kuptuar një ofertë me një çmim më të lartë apo një pagesë më e favorshme por pagesë e njëhershme ose pagesë në valutë të huaj të Konvertueshme.

Termi kushte të favorshme paraqet një fushë më të gjerë dhe nën termin kushte të favorshme duhet të meren parasysh disa aspekte edhe atë:

⁹⁰ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 18

1. *pagesa e favorshme - pagesa e siguruar.*
2. *Investimi në ndërmarrje – sipërmarrje për zhvillimin e ndërmarrjes.*
3. *Forca punëtore - mbajtja dhe rritja e numrit të punësuarve për një periudhë të caktuar kohore.* ⁹¹

Kushte e favorshme janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve dhe synimeve themelore të një ndërmarrjeje edhe atë : zhvillimin e saj, konkurrencën në treg dhe realizimit e profitit. Blerja e ndërmarrjes do të konsiderohet si e suksesshme nëse aksionet e blerë përbëjnë të paktën 51% të vlerës së kapitalit shoqëror. Kjo do të thotë që qëllimi kryesor i një blerjeje të ndërmarrjes së mesme është që blerësit të bëhen pronarë kryesorë të asaj ndërmarrjeje dhe administrimi i ndërmarrjes të kryhet nga këta persona, ku blerësit e ndërmarrjes fitojnë aksione të thjeshta. Sipas nenit 59 të LTNKS –së aksionet e pashitura ndërmarrja i transferon te agjencia si aksione prioritare, të cilët agjencionit i japin të drejtë për një dividendë prej 2% në vit dhe një pjesë proporcionale të pjesës të pasurisë së ngelur pas pagesës të kreditorëve (nëse është kryer likuidimi ose falimentimi mbi ndërmarrjen). Agjencia i ofron aksionet në shitje jo më vonë se tre muaj nga dita e blerjes, por para shitjes i transformon aksionet prioritare në aksione të zakonshme.

3.9.2.3 Shitja e ndërmarrjes tek personat që marrin përsipër administrimin e saj

Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror nga neni 60 deri në nenin 64 e rregullon modelin e tretë për transformim të ndërmarrjeve të mesme. Sipas nenit 60 ndërmarrjet e mesme mund të shiten në personat të cilët marrin përsipër administrimin dhe udhëheqjen e punëve të ndërmarrjes. Administrimin e ndërmarrjes mund ta marrin në sipër vetëm personat të cilët ofrojnë një program për zhvillim e ndërmarrjes. Ky model i shitjes së ndërmarrjes së mesme paraqet shitje graduale e pjesës mazhoritare të ndërmarrjeje e cila fillimisht fillon me blerjen e një përqindjeje të vogël të vlerës së kapitalit shoqëror e cila është

⁹¹ Po aty, fq.26.

e mjaftueshme për të filluar shitjen e ndërmarrjes për ata që marrin përsipër menaxhimin kurse qëllimi i shitjes do të arrihet pasi blerësit të kenë fituar një aksion kontrollues prej të paktën 51% të vlerës së kapitalit shoqëror brenda pesë viteve.

Bazuar në nenet të cilët e rregullojnë modelin e tretë për transformim të ndërmarrjes së mesme, për të realizuar transformimin e ndërmarrjes përmes shitjes së ndërmarrjes tek personat që marrin përsipër administrimin e saj duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- a) Shitja e ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes realizohet përmes thirrjes publike për ofertë e cila shpallet nga Agjencia e Republikës së Maqedonisë për transformi të ndërmarrjeve me kapital shoqëror.*
- b) Personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes duhet të paraqesin program për zhvillimin e ndërmarrjes.*
- c) Personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes fillimisht janë të detyruar të bllejnë së paku 20% të vlerës së përcaktuar të ndërmarrjes.*
- d) Personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes në periudhë kohore jo më gjatë se 5 vite duhet të blerjnë të paktën 51% e vlerës së përcaktuar të ndërmarrjes.*
- e) Zgjedhja e blerësve caktohet sipas cilësisë së programit të ofruar dhe kushteve tjera të favorshme. Agjencia në mënyrë të pavarur vlerëson programin e ofruar dhe kushtet tjera të favorshme dhe bën zgjedhjen më të mirë për ardhmërinë e ndërmarrjes.*

Personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes me Agjencioni lidhin kontratë për shitje me kusht që brenda afatit kohor 5 vite të blehet së paku 51% e vlerës së kapitalit shoqëror, aksionet të cilët nuk blehen ndërmarrja i transferon te Agjencioni si aksione prioritare. Sipas ligjit nëse në afatin e caktuar kohor aksionet nuk do të blehen atëherë aksionet transferon nga aksione prioritare në aksione të thjeshta. Në bazë të kontratës për shitje të lidhur mes Agjencisë dhe personave që marrin përsipër administrimin, ndërmarrja në bazë të kushteve dhe procedurës së përcaktuar organizohet si shoqëri aksionare. Në nenin 64 të LTNKS –së në mënyrë decide janë të caktuara shkaqet për ndërpritjen e kontratës për shitjen e ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes edhe atë kur:

- a) *Personat që kanë marrë përsipër administrimin e ndërmarrjes nuk i përmbushin detyrimet të cilat rrjedhin nga marrëveshtja.*
- b) *Ndërmarrja në llogarinë vjetore tregon zvogëlim të vlerës së përcaktuar të ndërmarrjes.*
- c) *Ndërmarrja në llogarinë vjetore tregon humbje si rezultat i administrimit të ndërmarrjes në kundërshtim me kontratën si dhe nga menaxhimi jo i përshtatshëm i personave që kanë qenë pjesëmarrës në administrimin e ndërmarrjes. Humbja e raportuar do të mbulohet në mënyrë solidare nga personat pjesëmarrës në procesin e administrimit të ndërmarrjes. Për të siguruar arkëtimin e kërkesave personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes kanë vënë në hipotekë pronën e tyre private.*

3.9.2.4 Emetimi i aksioneve për investime shtesë

Modeli i katër i transformimit të ndërmarrjeve të mesme është emetimi i aksioneve për investime shtesë. Vendimin për emetim të aksioneve e sjell ndërmarrja në përputhje me ligjin për letra me vlerë.⁹² Kjo metodë e transformimit të ndërmarrjes nënkupton atë se gjithçka që do të investohet do të ngel te shoqëria aksionare si pasardhës ligjor i ndërmarrjes me kapital shoqëror.

Blerësit e aksioneve dhe ndërmarrja mes vete lidhin kontratë për rregullimin e marrëdhënieve reciproke dhe mënyrën e organizimit të ndërmarrjes si shoqëri aksionare, por paraprakisht ndërmarrja merr pëlqim nga agjencioni për lidhjen e kontratës. Nëse vlera nominale e aksioneve të fituara paraqet të paktën 30% e vlerës së ndërmarrjes, ndërmarrja në procesin e organizimit si shoqëri aksionare për vlerën e kapitalit jo të privatizuar agjencisë do të lëshoj aksione të prioritare. Në kontratë përcaktohet edhe afati i fundit të blerjes të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes i cili të paktën duhet të përbëjë 51% e vlerës së përcaktuar të ndërmarrjes dhe të blehet në periudhë të përcaktuar kohore e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet. Mbajtësit e aksioneve të thjeshta në bazë të investimeve shtesë mund të përdorin dividendën vetëm për

⁹² Neni 65 i Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror të vitit 1993.

të blerë aksionet e mbajtura nga agjencia. Nëse aksionet nuk janë blehen brenda afatit të caktuar Agjencia do ti shëndërroj aksionet prioritare në aksione të thjeshta.

Metoda e katërt për transformim të ndërmarrjes së mesme sipas prof. Stefanovski⁹³ është mjaft e veçantë dhe dallon nga metodat e mëparshme edhe atë me tetë karakteristikat esenciale të numëruara më poshtë:

- a) Investitorët e kapitalit shtesë në ndërmarrjet me kapital shoqëror mund të jenë persona vendas dhe të huaj, ashtu që për investimet e personave huaj vlen ligji për investimet e huaj.*
- b) Në rastin për investime shtesë aksionet nuk mund të blehen me lirim, pasi që lirimi është rezervuar vetëm për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror.*
- c) Investitorët për t'u bërë pronarë kryesorë të ndërmarrjes duhet të blejnë së paku 51% të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes.*
- d) Agjencioni është organi i cili duhet të jep pëlqim për lidhjen e marrëveshjes mes ndërmarrjes dhe investorëve.*
- e) Në bazë të kontratës për investime shtesë ndërmarrja sjell vendim për emetim të aksioneve dhe vendim për organizimin e ndërmarrjes si shoqëri aksionare.*
- f) Varësisht nga lartësia e investimeve shtesë lëshohen aksione të prioritare ose aksione të thjeshta. Për shembull, nëse vlera nominale e aksioneve të blera për një investim shtesë tejkalon 30% emetohen aksionet preferenciale, nëse kjo vlerë është më pak se 30% atëherë emetohen aksione të zakonshme.*
- g) Në shumën prej 15% të vlerës nominale të emetimit të aksioneve, ndërmarrja do t'i lëshojë aksione Fondit të Pensionit dhe Sigurimit Invalidor.*
- h) Pozita e agjencionit krahas ndërmarrjes në të cilën është bërë investimi shtesë varet nga lloji i aksioneve, nëse ka fituar aksione prioritare ka rol apo paraqitet si pronar pasiv, nëse ka fituar aksione të zakonshme ka rol aktiv.*

⁹³ ⁹³ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 29.

3.9.2.5 Shëndërrimi i kërkesës së kreditorit në investim të përhershëm

Modeli i pestë dhe i fundit i privatizimit të një ndërmarrje të mesme është shëndërrimi i kërkesës së kreditorit në një investim të përhershëm. Ndërmarrja në marrëveshje me kreditorin e shoqërisë vendos ta kthejë kërkesën e saj në një depozitë të përhershme për të cilën lëshon aksione në shoqërinë aksionare, d.m.th., një pjesë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, kështu që bën të mundur kompenzimin e kërkesës së kreditorit. Për pjesët respektivisht aksionet e fituara ndërmarrja me kreditorin lidhin kontratë në formë të shkruar, dhe në përputhje me marrëveshjen organi drejtues i ndërmarrjes merr vendim për organizim të ndërmarrjes si shoqëri aksionare respektivisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shëndërrimi i kërkesës së kreditorit në depozitë të përhershme ka të bëjë me shlyerjen e borxhit me anë të emetimit të aksioneve dhe pjesëve, me anë të cilës përfundon detyrimi i debitorit ndaj kreditorit. Konvertimi i borxhit të ndërmarrjes në investime të përhershme nuk paraqet kapital të ri gjithashtu nuk ka të bëjë me shlyerjen e borxhit në tërësi, por me uljen e borxhit të ndërmarrjes dhe shndërrimin e borxhit në investim të përhershëm.⁹⁴

3.9.3 Transformimi i ndërmarrjeve të mëdha

Mënyra dhe procedura e privatizimit të kapitalit shoqëror në ndërmarrje të mëdha kryhet në bashkëpunim me Agjencinë e Privatizimit të Republikës së Maqedonisë. Vendimi për privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha merret brenda një afati kohor të dakorduar me Agjencinë, fillimisht ndërmarrja e madhe merr pëlqim nga Agjencioni për privatizim, e pas saj sjell vendimin për transformim të ndërmarrjes së madhe me kapital shoqëror.⁹⁵ Kur flasim për privatizim të ndërmarrjeve të mëdha patjetër duhet të referohemi neneve 69, 70, 71 dhe 72 të

⁹⁴ ⁹⁴ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, стр. 30, Скопје, 1994 година.

⁹⁵ По ату, fq. 34.

ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror prej nga rrjedhin edhe karakteristikat themelore të transformimit të ndërmarrjeve të mëdha edhe atë:

- a) *Fillimisht ndërmarrja e madhe merr vendim për transformimin në përputhje me agjencinë. Pa pëlqimin e Agjencisë nuk mund të fillohet një procedurë për transformimin e kapitalit shoqëror, kjo nënkupton rolin vendimmarrës të Agjencisë gjatë transformimit të ndërmarrjeve të mëdha me kapital shoqëror.*
- b) *Organi për administrim të ndërmarrjeve të mëdha dhe Agjencioni formojnë Bordin për transformim të ndërmarrjeve. Bordi ka rol të dukshëm në përcaktimin e mënyrës dhe procedurës së transformimit të ndërmarrjeve të mëdha. Bordi gjithashtu përgatit edhe vendim për transformim të ndërmarrjeve të mëdha ku përveç pjesëve përbërëse (programi, raportet, të dhënat, deklaratat dhe provat) rëndësi të veçantë i kushtohet edhe veprimtarive të ristrukturimit të ndërmarrjes.*
- c) *Agjencia për privatizim pothuajse i lidh të gjitha kontratat për transformim të ndërmarrjeve të mëdha me kapital shoqëror, edhe atë: kontratat për shitjen e ndërmarrjes së madhe ose të një pjese ideale të ndërmarrjes, për investimin e kapitalit në ndërmarrje, për shëndërrimin e investimit në baza kontraktuale dhe për kërkesën mbi ndërmarrjen si investim i përhershëm.*
- d) *Në procesin e transformimit të ndërmarrjes së madhe me kapital shoqëror vëmendje të veçantë i kushtohet ristrukturimit organizativ dhe financiar të ndërmarrjes. Ristrukturimi organizativ i ndërmarrjes do të thotë ndarje e ndërmarrjes në një numër ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme ose me riorganizimin e ndërmarrjes në një ndërmarrje nënë (mbajtëse) me një numër të caktuar ndërmarrjesh bijë, e cila mundëson aplikimin individual të modeleve të privatizimit të parashikuara me ligj dhe një gatishmëri për të kryer më shpejt privatizimin e kapitalit shoqëror. Me fjalë të tjera ristrukturimi organizativ mundëson privatizimin e kapitalit në pjesët e caktuara të një ndërmarrje të madhe pasi që në ata kushte ekonomike tregu nuk kanë pasur gatishmëri dhe aftësi që të transformojnë plotësisht ndërmarrjen e madhe. Krahas ristrukturimit organizativ rol të veçantë në transformimin e ndërmarrjeve të mëdha luan edhe ristrukturimi financiar i cili është i lidhur ngushtë me rikuperimin financiar ose rigjallërimin e pjesëve të caktuara*

të ndërmarrjes së madhe. Rikuperimi financiar paraqitet në pjesët e ndërmarrjeve që kanë kushtet për të ndërtuar marrëdhënie të shëndosha financiare, themelore dhe tregu, kurse në pjesët e ndërmarrjeve pa perspektivë financiare, investimesh dhe tregu mund të jenë subjekt i falimentimit ose trajtimit të procedurës së likuidimit.

- e) Teknikat dhe metodat e privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha mund të nxirren nga nenit 71 i LTNKS -së. Metodatat për transformim të ndërmarrjeve të mëdha me kapital shoqëror janë të njëjta ose të ngjashme me metodatat e aplikuara në një ndërmarrje të mesme, me disa përjashtime.*

3.9.3.1 Shitja e pjesës ideale

Shitja e një pjese ideale të ndërmarrjes do të thotë shitje e një pjese të saj me një thirrje publike për oferta dhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë me ndërmjetësim të Agjencionit për privatizim apo ndonjë personi fizik / juridik të autorizuar nga Agjencioni. Karakteristikat e përgjithshme të metodës së lartëpërmendur për transformim të ndërmarrjeve të mëdha janë:

- a) Shitja e pjesës ideale të ndërmarrjes*
- b) Shitja bëhet me anë të një ftese publike për tender ose me marrëveshje të drejtpërdrejtë*
- c) Pjesa ideale ofrohet me vlerën e përcaktuar në treg , kurse shitja e pjesës ideale nuk mund të jetë më e ulur se 80% e vlerës së përcaktuar.*
- d) Në procesin e shitjes së pjesës ideale të ndërmarrjes merr pjesë edhe Agjencioni i cili i lidh kontratat për shitjen e pjesës ideale të ndërmarrjes.*

3.9.3.2 Blerja e ndërmarrjes

Blerja e ndërmarrjes realizohet nga blerje e njehershme e ndërmarrjes në shumën jo më të ulët se 51% të vlerës së përcaktuar, ku blerësit e parë (blerësit e 51% të ndërmarrjes) nuk kanë

asnjë detyrim të blejnë pjesën e ngelur të ndërmarrjes së pashitur ndërsa Agjencioni ka detyrim që ti rezervoj blerësve aksionet e pashitura për një periudhë kohore të përcaktuar.

- a) *Blerja e ndërmarrjes bëhet sipas mënyrës dhe kushteve të procesit të transformimit, në të njëjtën kohë duke marrë vendim për emetimin e aksioneve dhe vendim për të organizuar një ndërmarrje si shoqëri aksionare.*
- b) *Klientët që ofrojnë kushte më të favorshme kanë përparësi gjatë blerjes së ndërmarrjes, kurse në kushte të barabarta përparësi kanë vet punëtorët e ndërmarrjes.*
- c) *Blerja e ndërmarrjes konsiderohet si e suksesshme nëse aksionet e blerë përbëjnë të paktën 51% e vlerës së përcaktuar të kapitalit shoqëror.*
- d) *Aksionet e pashitura transferohen në Agjenci si aksione prioritare me një dividendë prej 2% në vit si dhe me një pjesë proporcionale nga pasuria e ngelur pasi të jetë shlyer borxhi i kreditorëve.⁹⁶*

3.9.3.3 Shitja e ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes

Sipas këtij modeli ndërmarrja mund të shitet tek personat që do të marrin përsipër administrimin dhe që do të ofrojnë një program të mirëfilltë për zhvillimin e ndërmarrjes. Ky model supozon një blerje graduale të shumicës së aksioneve të ndërmarrjes, e cila fillon fillimisht me blerje të një përqindjeje të vogël të vlerës së kapitalit shoqëror që konsiderohet si e mjaftueshme për të filluar shitjen e ndërmarrjes ndaj personave që ata po e menaxhojnë atë. Qëllimi i shitjes së ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes do të arrihet brenda pesë viteve kur blerësit e ndërmarrjes do të fitojnë kontrollin e plotë mbi ndërmarrjen. Për zbatimin e kësaj procedure të privatizimit duhet të përmbushen disa kushte:

- a) *Personat që ndërmarrin menaxhimin e ndërmarrjes duhet të ofrojnë një program për zhvillimin të ndërmarrjes dhe plan të mirëfilltë për konkurrencën e ndërmarrjes.*

^{96 96} Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 38,

- b) Shitja e ndërmarrjes te personat që marrin përsipër administrimin kryhet përmes një thirrje publike për oferta nga Agjencia, e cila në të njëjtën kohë lidh kontratë shitjeje të ndërmarrjes me personat që marrin përsipër administrimin e tyre.*
- c) Zgjedhja e blerësve varet nga cilësia e programit të ofruar për zhvillimin e ndërmarrjes dhe kushteve të tjera të favorshme.*
- d) Personat që marrin përsipër rolin e administrimit janë të detyruar të blejnë të paktën 10 % e vlerës së përcaktuar të ndërmarrjes.*
- e) Personat që marrin përsipër administrimin e ndërmarrjes janë të detyruar të blejnë të paktën 51% të vlerës së aksioneve në periudhë të caktuar kohore, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet.*
- f) Personi që merr përsipër rolin e administrimit dividendën mund ta përdorin vetëm për të blerë aksionet rezervë të mbajtura nga Agjencia.*
- g) Nëse aksionet nuk blehen brenda afatit të kontraktuar, ato konvertohen nga aksione prioritare në aksione të thjeshta.⁹⁷*

3.9.3.4 Emetimi i aksioneve për investime shtesë

Privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha sipas modelit të katërt me anë të emetimit të aksioneve për investime shtesë kryhet përmes vendimit për emetim të aksioneve në përputhje me Ligjin për letrat me vlerë. Aksionet lëshohen pa zbritje kurse të ardhurat nga aksionet e shitura për investim shtesë mbeten në buxhetin e ndërmarrjes, që do të thotë se gjithçka që investohet do të ngel në shoqërinë aksionare si pasardhës ligjor i ndërmarrjes shoqërore. Bazuar në nenin 67 të LTNKS-së rrjedhin karakteristikat e poshtëshënuara lidhur me metodën e emetimit të aksioneve për investime shtesë edhe atë:

- a) Aksionet e emetuara për qëllim të krijimit të kapitalit shtesë ofrohen pa zbritje.*
- b) Të ardhurat e grumbulluara nga shitja e aksioneve për investime shtesë ngelin në arkën e ndërmarrjes së madhe.*

⁹⁷ ⁹⁷ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 39 -40.

- c) *Vlera nominale e aksioneve të shitura për investime shitesë duhet të përbëjnë së paku 15% e vlerës së ndërmarrjes.*
- d) *Për vlerën e kapitalit të ndërmarrjes që nuk është e privatizuar, Agjencionit i lëshohen aksione prioritare.*
- e) *Personat që kanë blerë aksione për investime shitesë janë të detyruar që brenda periudhës kohore 5 vjeçare të blejnë së paku 51% të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes.*
- f) *Pronarët e aksioneve dividendët e tyre mund t'përdorin vetëm për blerjen e aksioneve që posedon Agjencioni.*
- g) *Aksionet nëse nuk shiten Brenda afatit të kontraktuar atëherë Agjencioni i nxjerr aksionet në shitje, por para se ti nxjerr në shitje aksonet prioritare transferohen në aksione të thjeshta.*

3.9.3.5 Shëndërrimi i kërkesës së debitorit në depozitë të përhershme

Modeli i pestë dhe i fundit për transformim të ndërmarrjeve të mëdha është shëndërrimi i kërkesës së kreditorëve në depozitë të përhershme ku ndërmarrja si njëri subjekt i marrëveshjes së bashku me subjektin tjetër kreditorin i cili kërkesat e tij nuk i ka realizuar lidhin marrëveshje për shëndërrim të kërkesës së parealizuar në depozitë të përhershme. ku ndërmarrjen e madhe organizohet si shoqëri aksionare apo si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Vendimi për emetim të aksioneve merret në përputhshmëri me Ligjin për Letra me Vlerë.⁹⁸ Gjatë procesit të privatizimit ndërmarrjes me kapitali shoqëror duke e shëndërruar kërkesën e kreditorëve në depozitë të përhershme duhet të merren parasysh karakteristikat e mëposhtme edhe atë:

- a) *Ndërmarrja mundet që kërkesën e kreditorëve ta shëndërroj në depozitë të përhershme por për këtë kreditorëve duhet ti lëshoj aksione respektivisht pjesë.*

⁹⁸ Ligji për letra me vlerë e botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë me nr.5/93

- b) Për aksionet respektivisht pjesët e fituara, Agjencioni dhe kreditorët duhet të lidhin kontratë në formë të shkruar.*
- c) Ndërmarrja në marrëveshje me kreditorët pretendimet e të cilëve janë konvertuar në depozitë të përhershme sjellin vendim për organizimin e ndërmarrjes si shoqëri aksionare respektivisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.*
- d) Nëse kapitali shoqëror mbetet i paprivatizuar ekziston mundësia për aksione prioritare.⁹⁹*

3.9.3 Teknika speciale për privatizimin e kapitalit shoqëror

Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror parashen në vete metoda speciale për privatizim të ndërmarrjeve shoqërore edhe atë:

- 1. Dhënia e ndërmarrjes me qera.*
- 2. Transformimi me anë të shitjes së pasurive të ndërmarrjes.*
- 3. Transformimi i ndërmarrjes në falimentim.*
- 4. Mbrojta e të drejtave të ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre ligjor.*

3.9.4.1 Dhënia e ndërmarrjes me qera

Dhënia me qera e ndërmarrjes është e rregulluar me nenet 73 - 75 të LTNKS-së, si model i veçantë për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore. Ideja e kësaj metode është fitimi i drejtës së pronësisë mbi ndërmarrjen shoqërore pas skadimit të afatit të qirasë, që do të thotë se personi mbi sendet që ka ushtruar të drejtën e qirasë pas periudhës së caktuar kohore do të ushtroj të drejtën e pronësisë. Aplikimi i kësaj metode në ndërmarrjet me kapital shoqëror përfshinë marrjen me qira të një pjese të pasurisë së ndërmarrjes e cila me kalimin e një

⁹⁹ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр. 41

periudhe të caktuar kohore çon në ndryshimin e pronarit të asaj pjese të pasurisë së ndërmarrjes. Karakteristikë e kësaj metode është se marrja me qira e një pjese të pasurisë së ndërmarrjes për një interval të caktuar kohor privatizon atë pjesë të pasurisë së ndërmarrjes. Gjatë procedurës së dhënies me qira të ndërmarrjes, orientimi i ndërmarrjes është kah tjetërsimi i një pjese të fondeve të cilët janë të panevojshme për aktivitete të mëtejshme të biznesit, investimeve dhe tregut. Aplikimit të kësaj metode për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror i paraprijnë disa etapa edhe atë:

- 1. Përcaktimin e vlerës së pasurive të ndërmarrjes të marra me qira*
- 2. Shpallja e një thirrjeje publike për oferta*
- 3. Lidhja e kontratës së qirasë*

Duke u bazuar në Ligjin për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror lidhur për metodën e lartëpërmendur mund ti veçojmë karakteristikat e mëposhtme:

- a) Përcaktimi i vlerës së pasurive të marra me qira para ose pas sjelljes së vendimit për marrje me qira të një pjese të pasurisë së ndërmarrjes.*
- b) Shpallja e thirrjes publike për oferta si mënyre e vetme për zgjedhjen e qiramarrësit.*
- c) Lidhja e marrëveshjes së qirasë për një pjesë të pasurisë së ndërmarrjes me klauzol për shitjen e cila nuk mund të jetë më e gjatë se shtatë vjet (pas pagesës së qirasë kryhet edhe blerja e pasurisë së ndërmarrjes.)*
- d) Lidhja e marrëveshjes për qira kryhet në qoftë se ndërmarrja merr pëlqim nga Komisioni për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror pranë Qeverisë.*
- e) Kërkesën për marrje me qira të një pjese të pasurisë së ndërmarrjes, ndërmarrja e paraqet njëkohësisht tek Agjencioni dhe Komisioni pranë Qeverisë.*
- f) Agjencioni në një periudhë kohore prej 60 ditëve do të jep mendimin e tij lidhur me kërkesën e paraqitur nga qiramarrësi potencial kurse Komisioni pranë Qeverisë duke u bazuar në mendimin e Agjencionit në afat kohor prej 30 ditëve duhet të sjell*

*vendim. Nëse vendimi nuk sillet në afatin e paraparë kohor, konsiderohet se pëlqimi është i dhënë.*¹⁰⁰

3.9.4.2 Transformimi me anë të shitjes së pasurive të ndërmarrjes

Shitja e të gjitha pasurive të një ndërmarrje të specifikuar në nenet 76 -79 të LTNKS -së përbën një mënyrë të veçantë për transformimin e pronës shoqërore. Karakteristikë e kësaj teknike të privatizimit është se shitja e të gjitha pasurive të ndërmarrjes rezulton në shuarjen e ndërmarrjes, shuarje e ndërmarrjes pa likuidim. Veçantia e kësaj metode në krahasim me metodat paraprake qëndron në atë se ndërmarrja shoqërore nuk shndërrohet në shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si në rastet tjera, por pushon së ekzistuari si person juridik. Duke u bazuar në nenet e Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror lidhur për këtë metodë mund ti veçojmë karakteristikat e mëposhtme:

- a) Shitja e të gjitha pasurive të ndërmarrjes rezulton në ndërprerjen e ndërmarrjes, kontrata e shitjes lidhet mes Agjencionit dhe blerësit pasi të merret miratimi nga ana e Komisionit pranë Qeverisë.*
- b) Ndërmarrja pushon së ekzistuari në ditën e specifikuar në kontratën për shitje të gjitha pasurive të ndërmarrjes. Nga ajo ditë për punëtorët e ndërmarrjes fillojnë të rrjedhin pasojat juridike të ngjajshme sikurse në procedurën e falimentimit. Ekziston mundësia që në kontratë të parashihet e drejta e punësimit dhe të drejtat tjera të punëtorëve të pronari i ri i ndërmarrjes.*
- c) Agjencia e dorëzon kontratën për shitjen e të gjitha pasurive të ndërmarrjes në Gjykatën rregjistrim, për qëllim të fshirjes së ndërmarrjes nga rregjistri gjyqësor e cila pas fshirjes shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.*
- d) Vendimin për shitjen e të gjithë pasurisë së ndërmarrjes sjell organi për administrim të ndërmarrjes, i cili para se të lidh kontrat merr miratim nga Komisioni pranë Qeverisë.*¹⁰¹

¹⁰⁰ Стефановски,Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф , Скопје, 1994 година, стр. 43.

3.9.4.3. Transformimi i ndërmarrjeve në falimentim

Transformimi i një ndërmarrje në falimentim të parashikuar në nenet 80 dhe 86 të ligjit lejon që procedura e transformimit të ndërmarrjes me kapital shoqëror të kryhet gjatë procedurës së falimentimit, e cila nënkupton çlirimin nga detyrimet dhe puna e tepërt, konsolidimin financiar dhe transformimin e pronësisë. Me zbatimin e kësaj metode procedura e falimentimit pezullohet përkohësisht dhe ndërmarrja vazhdon punën e saj. Një procesi i suksesshëm transformimit të ndërmarrjeve në falimentim përfshin eliminimin e procedurës së falimentimit. Gjatë transformimit të ndërmarrjeve në falimentim duhet të merret parasysh disa çështje edhe atë:

1. Inicimi i procedurës për transformim të ndërmarrjeve në falimentim kryhet vetëm nga ana e kreditorëve duke parashtruar kërkesë në Këshillin Falimentues. Me propozim të kreditorëve dhe me vendim të Këshillit Falimentues procedura e falimentimit ndërpritet dhe ndërmarrja vazhdon me aktivitetet e saj. Nga kjo rrjedh se me miratimin e vendimit për transformim të ndërmarrjeve në falimentim krijohen marrëdhënie të reja juridike si më poshtë:
 - *Menaxhimi i ndërmarrjes kryhet nga ana e organeve të sapoformuara(Këshilli Falimentues, Bordi i Kreditorëve i cili më pas emërohet si Bordi i Drejtorëve)*
 - *Ndërprerja e përkohshme e procedurës së falimentimit.*
 - *Vazhdimi i ndërmarrjes me punë dhe aktivitete tjera.*
2. Çështja e konsolidimit afatgjatë luan një rol të rëndësishëm në transformimin e ndërmarrjeve në falimentim. Për këtë qëllim Bordi i Drejtorëve miraton një program financiar dhe të transformimit të pronësisë që përfshin masa, veprime dhe aktivitete për konsolidimin afatgjatë të ndërmarrjes:
 - *Marrja e borxheve nga ana e kreditorëve*
 - *Shlyerja e borxheve*
 - *Shëndërrimi i borxhit në depozitë të përhershme.*

¹⁰¹ Стефановски,Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф , Скопје, 1994 година, стр.44,

- *Garancioni dhe besueshmëria e kreditorëve.*
 - *Përcaktimi i strukturës së kapitalit dhe caktimi i pronarëve të kapitalit në shoqërinë e ardhshme.*
3. Transformimi i ndërmarrjes në falimentim do të kryhet në qoftë se riorganizimi dhe riaftësimi i ndërmarrjes i jep rezultatet e pritura. Pasi të arrihen rezultatet e pritura brenda periudhës kohore të paraparë, jo më gjatë se 12 muaj nga data e sjelljes së vendimit të plotfuqishëm për ndërprerje të procedurës së falimentimit, Bordi i Drejtorëve me miratim paraparak të Këshillit Falimentues merr vendim për shëndërrim apo transformim të ndërmarrjes në shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me të cilën përfundon procedura e falimentimit ndaj ndërmarrjes.
 4. Gjatë riorganizimit dhe riaftësimit të ndërmarrjes zbatohen dispozitat ligjore nga Ligji për falimentim, likuidim etj.¹⁰²

3.9.4.4 Mbrojtja e të drejtave të ish-pronarëve dhe pasardhësve ligjor

Një ndër çështjet më të rëndësishme në Ligjin për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror ka të bëjë me mbrojtje e të drejtave të ish-pronarëve të ndërmarrjeve dhe pasardhësve të tyre ligjor. Ky ligj përcakton vetëm procedurën për mbrojtjen e të drejtave të ish-pronarëve kurse pronat tek pronarët e mëparshëm do të kthehen në bazë të dhënave për denocionalizim. Gjatë procedurës së transformimit të ndërmarrjeve do të respektohen kërkesat e ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre ligjor që janë shtetas të Republikës së Maqedonisë. Pas sjelljes së vendimit për transformim, ndërmarrja është e detyruar që Brenda 60 ditëve nga shpallja ti thërret ish-pronarët dhe pasardhësit e tyre ligjor që ti paraqesin kërkesat e tyre nga ndërmarrja. Kërkesa e parashtruar nga ish-pronarët apo pasardhësit ligjor duhet të jetë në formën e përcaktuar nga Agjencioni për privatizim dhe kërkesa ti dërgohet njëkohësisht ndërmarrjes dhe Agjencionit . Agjencioni në afat prej 15 ditëve nga dita e skadimit të afatit për parashtrim të kërkesave duhet ta informojë ndërmarrjen në lidhje me kërkesat e parashtruara

¹⁰² Po aty, fq.45 – 46.

apo të lëshoj një konfirmim në lidhje me atë se nuk janë parashtruar kërkesa nga ana e ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre ligjor.¹⁰³

Ndërmarrja me kapital shoqëror në raste të caktuara mund të vazhdoj me procedurë për transformim të kapitalit shoqëror edhe atë:

- 1. Me anë të konfirmimit të Agjencionit se askush në afatin e paraparë ligjorë nuk ka parashtruar kërkesë.*
- 2. Nëse ndërmarrja vërteton se nuk disponon me pasuri të paluajtshme ose me pasuri tjera për të cilat është bërë kërkesa si dhe nuk e ka përvetësuar apo nuk ka investuar në ndonjë ndërmarrje tjetër nga dita kur ka hyrë ligji në fuqi dhe gjashtë muaj para se të hyj në fuqi dhe nëse kreditori nuk i kundërshton veprimet juridike të ndërmarrja nga ndërmarrja deri në atë moment.*
- 3. Nëse me aktin për transformim është arritur që aksionet me vlerë që korespondojnë me kërkesat e ish-pronarëve, si aksione prioritare në mënyrë fiduciare të transferohen te Agjencioni.¹⁰⁴*

3.10 Procesi i privatizimit në praktikë

Metoda më e favorizuar për privatizimin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha nga ana e Agjencionit në periudhën e fundit veçanërisht gjatë vitit 1995 duket se ka qenë metoda e privatizimit nga ana e personave që marrin përsipër administrimin.

Një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha pavarësisht protestave të shumta publike e kanë zgjedhur këtë metodë të inkurajuar nga Agjencia për privatizim, e cila duket se ka vendosur të rregullojë vonesën e konsiderueshme në procesin e privatizimit dhe të përmbushë kërkesën e Bankës Botërore për privatizimin e 790 ndërmarrjeve Brenda vitin 1995, e cila ishte një nga kushtet primare për të marrë një kësht të dytë të kredisë nga FESAC (një

¹⁰³ Стефановски, Б., Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф, Скопје, 1994 година, стр.47

¹⁰⁴ Për më shumë shihni në nenet 33-40 të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë.

kredi e aprovuar nga Banka Botërore për ristrukturimin e sektorëve financiar dhe ekonomik), me të cilin qeveria maqedonase u pajtua pavarësisht rezervave serioze për përmbushjen e saj. Sipas të dhënave zyrtare, deri në fund të vitit 1996 transformimi u përdorë në mënyrë eufemistike për të treguar privatizimin në masën që u emërua një pjesë mbizotëruese e kapitalit të përgjithshëm privat, u krye nga 914 ndërmarrje me një total prej 144.539 punonjës dhe vlerë totale 2.36 miliardë marka gjermane.¹⁰⁵

- Struktura e ndërmarrjeve të cilët kanë e kryer transformimin deri më vitin 31.12.1995

Ndërmarrje	Numri i ndërmarrjeve	Numri i punëtorëve	Vlera e vlerësuar në DM
E vogël	104	-	1.664.494.789
E mesme	174	-	470.875.945
Emadhe	636	-	222.197.944
Gjithsej	914	144.539	2.357.568.6789

Nga: Agjencia për transformim(1996a)fq.51-53.

- Ndërmarrjet e privatizuara sipas metodës së privatizimit deri më vitin 31.12.1996.

Metoda për privatizim	Ndërmarrje	Numri i të punësuarëve	Vlera në DM
Ligji për kapitalin shoqëror	65	11.545	112.068.350
Blerja nga ana e të punësuarëve	301	12.239	123.857.770
Aksione	23	7.266	142.346.863
Ekipet menaxheriale	123	44.66	882.206.888
Qira	4	217	1.872.950
Kapital shtesë	14	3.892	41.504.915
Transfer	35	13.989	294.923.403
Depozitë e përhershme	15	8.269	316.822.372
Kapital i huaj	154	1.922	52.095.369
Kapital privat	55	1.869	10.919.476
Likuidim	38	2.618	6.496.788
Blerje	87	26.053	372.453.533
Gjithsej	914	144.539	2.357.568.677

Nga: Agjencia për transformim (1996a) fq. 50.

¹⁰⁵ Славески,Т., Приватизација пазар држава, стр.127,Скопје, 1997 година.

Nga tabelat e lartë ilustruara vërehet se në numri më i madh i ndërmarrjeve janë të privatizuara me anë të metodës së blerjes nga ana e punëtorëve. Shikuar nga aspekti i numrit të punëtorëve e veçënisht nga vlera e kapitalit metoda e administrimit të ndërmarrjeve nga ana e ekipeve menaxheriale është metoda më dominante. Kjo është një shenjë pozitive për Agjencinë nga perspektiva e rritjes së efikasitetit ekonomik për shkak të përqendrimit të pronësisë. Por sidoqoft duhet të merret parasysh se një numër jo i vogël i blerjeve të ashtuquajtura blerje menaxheriale kanë ndodhur me pjesëmarrjen e shumicës së kolektivit dhe në të vërtetë është shëndërruar në ashtuquajturën blerje nga ana e menaxhmentit dhe punëtorëve.¹⁰⁶

Me kalimin e kohës Agjencia e privatizimit shkoi shumë larg në "zbatimin" e ligjit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror. Nën presionin e gabimeve strategjike në procesin e privatizimit ajo ka ndërmarrë një seri hapash që kanë kompromentuar në masë të madhe procesin e privatizimit në sytë e publikut. Për shembull, ekipet e menaxhimit janë grupe ekskluzivisht drejtuese të vetë ndërmarrjeve të dobësuara ose të përforcuara pas përpjekjeve të njëri-tjetrit për të krijuar koalicione dhe për të fituar mbështetje nga punëtorët tjerë (duke përdorur të gjitha mjetet e mundshme nga bindja deri në kërcënime) për të unifikuar emërimin e tyre. Madhësia e ekipeve menaxheriale ishte variabile, në disa ndërmarrje numri shkonte deri në 5-6, në disa ndërmarrje deri në 100, e në disa raste deri në 1000, gjë që ishte tallje për publikun. Ekipeve të menaxhimit në përpjekjet e tyre për të filluar procesin e privatizimit u dhanë akcione shumë më të mëdha se ato të parashikuara me ligj dhe janë shikuar brenda gishtave sjelljet e tyre të paligjshme për të siguruar shumicën e aksioneve.¹⁰⁷

Si pasojë e kësaj, filozofia e "privatizimit të paguar" një nga argumentet kryesore kundër çdo lloj privatizimi masiv u komprometua plotësisht. Publiku filloi të shtrojë pyetje të pakëndshme pasi u publikuan të dhënat për fondet e privatizimit. Efekti i përgjithshëm nga privatizimet e realizuara deri më 31.12.1995 arriti diku 60.9 miliardë marka gjermane, gjë që përbënte vetëm 6,5% të vlerës së përgjithshme të ndërmarrjeve të privatizuara. Nga kjo shumë 22.17 miliardë

¹⁰⁶ Агенција на Република Македонија за трансформација на претпријатија со општествен капитал, 1996, стр.16

¹⁰⁷ Славески Т., Приватизација пазар држава, Скопје, 1997, стр.129.

marka gjermane janë fituar nga shitja e ndërmarrjeve, 36.68 miliardë marka gjermane nga të ardhurat dhe kontributet nga aksionet interne të emetuara më parë dhe vetëm 23.800 miliardë marka gjermane nga shitja e aksioneve. Më e rëndësishmja është se vetëm 19.2 miliardë ishin në para të gatshme dhe pjesa tjetër u pagua në valutë të bllokuar. Shumica e parave të gatshme ishin pagesa tatimore dhe kontributesh në aksione të fituara më parë (18.6 miliardë). 632,726 marka gjermane të mbledhura në para ishin nga shitja e ndërmarrjeve, dhe nga shitja e aksioneve deri më 31.12.1995 janë fituar vetëm 10,452 marka gjermane. Nga ana tjetër Agjencioni për operacionet e saj në vitin 1995 harxhoi rreth 2 milion marka gjermane. Është interesante poashtu të theksohet se nga shitja e aksioneve për hapësira të zyrave në periudhën tetor 1994 - gusht 1995 përafërsisht u grumbulluan 42 miliardë marka gjermane.¹⁰⁸

Situata u përmirësua pak më shumë në vitin 1996 ku sipas të dhënave të Agjencisë ndikimi i përgjithshëm financiar i privatizimit arriti në 106.6 miliardë marka gjermane. Kjo rritje ishte si pasojë e arritjes së datës për pagimin e kësteve të para nga ana e ndërmarrjeve të privatizuara me anë të metodës së blerjes së ndërmarrjes nga ana e punëtorëve dhe marrjes së administrimit nga ana e ekipeve menaxheriale. Në strukturat e këtyre pasurive paratë e gatshme janë vetëm 2.44 milion marka gjermane, detyrimet me vlerë rreth 60 milion marka gjermane shlyhen duke i përdorur kursimet e ngrira në valutë të huaj. Kurse për herë të parë në vitin 1996 si një mjet për pagimin e detyrimeve në bazë të privatizimit paraqiten bonot qeveritare në vlerë prej 44.5 milion marka gjermane.¹⁰⁹ Nga kjo mund të konkludojmë se duke pasur parasysh ekzistencën e një tregu sekondar për depozitat e kursimeve në valutë të huaj dhe bonot qeveritare në të cilat ato shiten me zbritje nga 40% deri në 50%, ata që hynë në posedim të kapitalit në ndërmarrjet e privatizuara përmes këtyre transaksioneve gjejnë mënyra për të përgjysmuar detyrimet e tyre. Përdorimi i bonove qeveritare për shlyerjen e detyrimeve është veçanërisht problematik. Publiku nuk ka pothuajse asnjë informacion mbi këto

¹⁰⁸ По ату, fq.129

¹⁰⁹ Славески Т., Приватизација пазар држава, Скопје, 1997, стр.130

transaksione dhe duket se shteti është me shpenzimet e veta pretendime për privatizim që janë më shumë me detyrime në bazë të bonove të emetuara për shkak të viteve të ardhshme.¹¹⁰

Interesi i kapitalit të huaj për privatizimin e ndërmarrjeve maqedonase ishte jashtëzakonisht i vogël. Përveç rreziqeve të larta jo-tregtare për të investuar në Maqedoni shkak tjetër mjaft i rëndësishëm ishte mënyra në të cilën u krye privatizimi. Illustrative është shembulli i ndërmarrjeve multinacionale që vendosën të tërhiqen nga negociatat për të blerë pjesë të industrisë maqedonase të duhanit pasi i panë konfliktet e mundshme me personat e brendshëm me të drejta në atë kompani. Është e qartë se mënyra se si u krye privatizimi në Maqedoni nuk stimulon zhvillimin e tregut të kapitalit. Bursa e Maqedonisë është hapur në 28 Mars të vitit 1996 dhe është e karakterizuar me vëllim të jashtëzakonisht të ulët tregtar dhe likuiditet të ulët. Institucionet financiare në vend janë zhvilluar shumë ngadalë. Për shembull, asnjë fond investimesh deri në fund të vitit 1997 nuk ishte regjistruar në Republikën e Maqedonisë.¹¹¹

Gjithashtu siç u tha më lartë, marrëveshjet që ndalojnë tregtimin e aksioneve me subjektet jashtë ndërmarrjes me anë të variantit maqedonas "management buy –out" vetëm do të ngadalësojnë zhvillimin e tregut të kapitalit dhe ka gjasa të ketë një ndikim negativ në ristrukturimin e këtyre ndërmarrjeve, si dhe në aftësinë për të siguruar kapitalit në të ardhmen.

Në ndërmarrje jo vetëm që nuk hynë kapital i freskët, por akoma vazhdon të bie gjë që do të ndodhë edhe në të ardhmen si rezultat i angazhimeve të marra dhe aspiratave të strukturave të menaxhimit për të marrë statusin e pronarëve dominues duke përdorur kapitalin e ndërmarrjeve gjë që në rrethana të tjera do të mund të përdoreshte në mënyrë më produktive. Pagesa e detyrimeve ndaj shtetit me fonde nga ndërmarrja de facto është zvogëluar në tatime shtesë të subjekteve ekonomike. Kjo është një arsye për shqetësim sepse në historinë ekonomike të asnjë vendi në recesion, nuk u tërhoqën fonde shtesë nga ekonomia, por tatimet totale u ulën. Gjithashtu është i njohur fakti se në ndërmarrjet me mbizotërim të brendshëm

¹¹⁰ Po aty faq.129.

¹¹¹ Po aty, fq. 130.

nuk janë të gatshëm dhe nuk favorizojnë investime nga subjektet jashta ndërmarrjes pavarësisht mundësive të kufizuara për vetë-investim.¹¹²

Ligji i Republikës së Maqedonisë siç është cekur edhe më herët ka hyrë në fuqi në fund të muajit gusht të vitit 1993. Por privatizimet e para sipas dispozitave të këtij ligji pas 20 muajve nga dita e hyrjes së ligjit në fuqi edhe atë në mënyrë të diskutueshme dhe jo transparente. Në ndërkohë me bashkimin e fondit republikan për zhvillim dhe agjencisë për ristrukturim institucional dhe privatizim të cilët institucione ishin të krijuara sipas ligjit për kapitalin shoqëror, u krijua Agjencia për privatizim dhe u emërua bordi i saj. Disa përgatitje janë bërë edhe për zbatimin e ligjit siç janë miratimi i statutit të agjencisë, trajnimi i vlerësuesve dhe të tjerët. Përveç kësaj, shërbimi i kontabilitetit shoqëror më vonë u shëndërrua në një zyrë pagese dhe zyrë e të ardhurave publike dhe filloi të kontrollojë privatizimin e kryer sipas ligjit të vjetër federal.¹¹³

Janë nevojitur katër muaj (katër herë më shumë nga ajo e parashikuar me Ligjin për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror) për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Agjencionit nga ana e Qeverisë. Ky proces i emërimit është zhvilluar nën tensione të konsiderueshme politike mes dy partive edhe atë Bashkimit Socialdemokrat dhe Partisë Liberale. Në këto rrethana ishte shumë normale që gjatë përzgjedhjes kriteret politike të jenë më të forta në krahasim me kriteret e ekspertëve. Një nga çështjet më interesante është emërimi i drejtorëve të cilët kanë lidhje të drejtëpërdrejtë apo indirekte me partitë e lartpërmendura në ndërmarrjet me kapital shoqëror në të cilat zhvillohet procesi i privatizimit. Gjatë kësaj periudhe si dhe në vazhdim nuk i është kushtuar vëmendje e duhur çështjes së konfliktit të interesit.¹¹⁴

Gjatë kontrollimit të proceseve të zhvilluara të privatizimeve të mëparshme nga vet ndërmarrjet është konstatuar se Qeveria ka treguar një qëndrim mjaft "të butë" pavarësisht mbizotërimit negativ të publikut dhe akuzave për vjedhje ose privatizim të nomenklaturës.

¹¹² Po aty, fq. 131.

¹¹³ Po aty, fq.131.

¹¹⁴ Po aty, fq. 131,

Disa nga udhëheqësit kryesorë të privatizimit maqedonas përfshirë z. Jane Milovski, për një studim përgatitor mbi konceptin e ardhshëm të privatizimit të Maqedonisë të botuar në shtator 1991, shpreh shqetësimin për zbatimin e Ligjit federal të privatizimit duke u shprehur: "Padyshim marrëzia më e madhe si juridike ashtu edhe ekonomike dhe morale në zbatimin e ligjit për kapitalin shoqëror në Maqedoni ka ndodhur dhe akoma po ndodh me blerjen ose shitjen e aksioneve të brendshme nga ana e punëtorëve të ndërmarrjeve të cilët e inicuan procesin e ristrukturimi të pronësisë". Më tej vazhdon duke thënë : " E gjetëm veten në një lloj hipokrizie. Ne e kemi pranuar parimin e shitjes me një zbritje të caktuar në transformimin e kapitalit shoqëror, dhe në realizimin praktik të projektit në thelb është zvogëluar në shpërndarjen falas të aksioneve të brendshme mes punëtorëve të ndërmarrjes që iniconin këtë proces".¹¹⁵

Sipas nenit 3 të LTNKS -së, nga procesi i privatizimit janë të përjashtuara ndërmarrjet që kanë pozitë monopolistike. Por Maqedonia ende në këtë moment nuk ka ligje për sjellje monopolistike ose politikave të konkurrencës, i cili kërkohet të përcaktojë raste që do t'i nënshtroheshin dispozitave të përmendura. Kjo ka rezultuar në ngritjen e tensioneve për disa raste, dhe atë në veçanti për rastin e përpjekjeve për privatizimin e "Panairit të Shkupit". Pavarësisht nga pozicioni i saj monopolisti, kompania ishte e përfshirë në listën e 21 kompanive në të ashtuquajturin Programi Pilot i Privatizimit nga ana e Agjencisë. Ky program siç dihet ka përfunduar një fiasko, por që flet shumë për sjelljen e autoriteteve të Agjencisë. Më vonë u dha leje për privatizimin e "Panairit të Shkupit" duke përdorur metodën e emetimit të aksioneve me qëllim të investimit shtesë. (Kompania tashmë ishte privatizuar me 26% sipas rregullave të vjetra federale). Por e gjithë procedura u kthye në një skandal. Aksionet nuk ishin lëshuar në Agjencionin për privatizim kurse Agjencia kishte shpallur thirrje për oferta. Ofertat nga subjektet e brendshme ishin dy dhe më shumë herë më të ulëta se ofertat nga subjektet e jashtme. U bë e qartë se vlera e kësaj ndërmarrje ishte vlerësuar shumë. Ndërkohë Dhoma e Tregtisë së Republikës së Maqedonisë u përgjigj me një pretendim për investime të bëra në të

¹¹⁵ Недков, М., Приватизација на општествениот капитал во Република Македонија, Истражувачки проект, Правен Факултет, стр.142 Скопје, 1991.

kaluarën, duke pretenduar pjesë nga vlera e kapitalit. Pas gjithë kësaj ndodhi ndërhyrja nga ana e qeverisë e cila e anuloi tërë procedurën.¹¹⁶

Më e diskutueshme apo më kontaverze duket se ka qenë privatizimi me variantin e lartpërmendur të "management buy- out" një privatizim i quajtur eufemistikisht nga "njerëzit që marrin përsipër menaxhimin". Pasi u konstatua se privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ishte vështirë i realizueshëm, megjithë lëshimet e ofruara në ligj (10% ose 20% interes dhe një kredi 5 vjeëare pa interes për pagesën e aksioneve), sepse askush nuk tregoi interes për të vendosur para në tryezë, ky problem u zgjidh në një mënyrë "originale", kështu që ekipeve të menaxhimit nga kompanitë u lejuan të përdorin aksionet e tyre të brendshme të fituara më parë në procesin e privatizimit sipas rregulloreve të vjetra. Çuditshmëria e këtij akti shihet në faktin se në momentin e caktuar këto "aksione" kishin vetëm vlerë nominale, dhe në shumicën e rasteve ato nuk ekzistonin (ato ekzistonin si fletë letre të zakonshme që shërbenin si lista të aksioneve "të rregjistruara " dhe si konfirmim për posedim të aksioneve). Për më tepër, aksionet e brendshme u përdorën gjithashtu si hipotekë për të siguruar të drejtën për të blerë pjesën e mbetur deri në të paktën 51% të vlerës së vlerësuar të ndërmarrjes në këste 5 vjet pa interes. Kjo ka qenë një pikë kthese e madhe e privatizimit të Maqedonisë. Këto prioritete apo lëshime për subjektët e brendshëm paraqitën goditje për palët e jashtëm të interesuar që të ofrojnë plane alternative për zhvillimin e ndonjë ndërmarrjeje. Kjo është gjithashtu një shpjegim i faktit se, pothuajse pa përjashtim të marrëveshjet u lidhën me vetë subjektet e brendshme të ndërmarrjeve.¹¹⁷

Publiku përmes mediave ka qenë i informuar për raste të shumta të abuzimeve në procesin e privatizimit. Në mesin e tyre më të njohurat janë rastet e transferimit në mënyrë të pavullnetshme të aksioneve të menaxherët me një çmim nominal apo edhe falas me anë të përdorimit të kërcënimeve të hapura ose të fshehta si dhe ekzistimi i ndëshkimit për ata që

¹¹⁶ Славески Т., Приватизација пазар држава, Скопје, 1997 година, стр.132 -133.

¹¹⁷ Славески Т., Приватизација пазар држава, Скопје, 1997 година, стр.134

refuzojnë "bashkëpunimin" duke përfshirë edhe largimin nga puna. Mjafton të themi se kjo po ndodhte në një vend me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë.¹¹⁸

Në lidhje me këto abuzime dhe ndikimin e tyre negativ në legjitimitetin e procesit të privatizimit u shpreh përfundimisht në raportin vjetor të vitit 1995, dhe agjensia e transformimit: "Disa probleme shfaqen kur zbatohen modele të shitjeve të ndërmarrjeve të personat që marrin përsipër menaxhimin dhe blerjen e ndërmarrjeve nga ana e punëtorëve edhe atë në rastet kur punonëtorëve u bëhet presion të heqin dorë nga aksionet të tyre kundër vullnetit të tyre ose në rastet kur punëtorëve nuk u jeppen informacione lidhur me transformimin e ndërmarrjes, të drejtave të tyre dhe mundësitë për të kyçur në të. Ndonjëherë duke përdorur metoda shumë agresive të shantazhit ose manipulimit të punëtorët vetëm e vetëm për të arritur përfitim personal, grupe të tilla të menaxhimit bëjnë propagandë të drejtpërdrejtë negative në procesin e transformimit „".¹¹⁹

Për partitë kryesore të opozitës që kundërshtojnë qeverinë aktuale dhe politikën e saj, privatizimi ka qenë prej kohësh një nga pikat kryesore të kritikës së tyre. Sidoqoftë vlen të theksohet se ndryshe nga disa vende të tjera në tranzicion, në Maqedoni të paktën nuk ka kërkesa të artikuluar për kthimin në sistemin e vjetër. Partia Demokratike (deri në bashkimin e saj me Partinë Liberale) ka mbrojtur shqyrtimin e rasteve të privatizimit të parregullt, veçanërisht në ato raste kur ka ekzistuar mundësia për investimin e kapitalit të huaj. Pas vizitës së saj në Athinë dhe takimeve me biznesmenët grekë, zonja Verica Hadzi Vasileva Markovska drejtore e Agjencisë së Transformimeve informoi publikun se grekët e interesuar për të investuar në Maqedoni ishin shumë të zhgënjyer kur u tha se privatizimi i kompanive më të rëndësishme maqedonase ishte afër përfundimit. Partia Demokratike deklaroi gjithashtu se do të përdor sistemin e taksave për të korrigjuar padrejtësitë sociale të bëra gjatë procesit të privatizimit. Kurse partia e dytë më e madhe opozitare VMRO – DPMNE në fillim të procesit të transformimit ka mbrojtur mirëmbajtjen e pronësisë shoqërore dhe kontroll më të madh të

¹¹⁸ По аты, fq.134.

¹¹⁹ Агенција на Република Македонија за трансформација на општествен капитал, Скопје, 1996година, стр.29.

shtetit mbi tërë procesin për shkak të karakteristikave të pronave shoqërore e cila ishte e të gjithëve dhe e askujt.

Drejtuesit e partisë nëpër media tregonin për shkelje të shumta të ligjit ekzistues të privatizimit në zbatimin e tij dhe nevojën për sanksione ligjore për veprime të tilla.¹²⁰

Kapitulli i katërt – IV

4. Instituti i privatizimit në të drejtën komparative

4.1 E drejta e privatizimit në Shqipëri

Procesi i privatizimit në Shqipëri është realizuar nëpërmes dy metodave: a) përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, dhe b) përmes krijimit dhe zgjerimit të ndërmarrjeve të reja nga kapitali vendas dhe i huaj . Si model kryesor i procesit të privatizimit ka qenë privatizimi përmes triskave të privatizimit (TP). TP-të ishin të këmbyeshem dhe ka mbizotëruar mundësia e këmbimit të drejtpërdrejtë me ç'rast fletë-aksionet e ndërmarrjeve janë këmbyer me TP. Procesi masiv të privatizimit përmes TP është shoqëruar me grumbullimin e këtyre triskave nga kompani të ndryshme ku një pjesë e këtyre triskave ndodheshin në duart e kampistëve të tregut.¹²¹

Në Shqipëri gjatë realizimit të procesit të privatizimit shoqëritë me kapitale shtetërore ishin të lira të transferonin tërësisht ose pjesërisht tek sektori privat të dy llojet e të drejtave edhe atë: të drejtën e pronësisë dhe të drejtën e përdorimit e të zhvillimit. Në zgjedhjen e metodës së privatizimit kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, përfshirë këtu madhësinë e ndërmarrjes që do të privatizohet, sikurse dhe karakteristikat e blerësve/ investitorëve të mundshëm. Në Shqipëri,

¹²⁰ Po aty, fq. 145.

¹²¹ Selmanaj, S. Globalizimi dhe Tranzicioni (dilemat dhe sfidat) ,Prishtinë, 2006, fq.34

ligji lejon përdorimin e të gjitha llojeve të metodave të privatizimit. Të gjitha këto metoda, janë bazuar në objektet që do të privatizohen.¹²²

Format e privatizimit në Shqipëri mund të ndahen kryesisht në dy grupe edhe atë:

- a) Format "zhveshëse" nga pronësia - duke aplikuar metodat "zhveshëse" shteti e transferon pronësinë tek pronari i ri privat, pa e mbajtur aspak rrishtun financiar. Shitja direkte përmes kësaj forme "zhveshëse", shteti si pronar i shet në mënyrë të drejtpërdrejt ndërmarrjet (ose një pjesë të aksioneve të saj) tek blerësi privat. Shitja direkte si formë mund të realizohet përmes dy mënyrave edhe atë: shitje direkte nëpërmjet ankandit/tenderit dhe shitje tek një blerës i paracaktuar. Forma e dytë ka gjetur zbatim në Shqipëri. Objektet e privatizuara përmes kësaj metode kryesisht kanë qenë shtëpitë banuese, restorantet, dyqanet, pjesë ndërmarrjeve, etj. (ky është i ashtuquajti privatizim i vogël).
- b) Format "jo-zhveshëse" të privatizimit Transformimi – përshin transformimin e një ndërmarrje publike në një shoqëri tregtare private, përcaktuar me ligjet në fuqi.

4.2 Procesi i privatizimit në Kroaci

Procesi i privatizimit në Kroaci ka filluar qysh me fillimin e luftë ka vazhduar edhe me përfundimin e luftës dhe deri më anëtarësimin në mënyrë zyrtare si anëtar i 28-të i Bashkimit Evropian (BE). Në bazë të ligjeve të aprovuara nga Republika e Kroacisë: Ligji mbi kapitalin shoqëror (1989), dhe Ligji mbi transformimin e ndërmarrjeve shoqërore (1991), e në veçanti në bazë të ligjit të dytë, të gjitha ndërmarrjet do duheshin të shndërroheshin në ndërmarrje me kapital të përzier, ose në ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar.¹²³

Gjatë procesit të privatizimit në Kroaci janë përdorur kryesisht modelet e mëposhtme:

- a) *shitja e një pjese ose të ndërmarrjes në tërësi*

¹²² Moisiu, U., The Proces of Privatisation in Albania, Tirana, 2012, fq.22

¹²³ Selmanaj, S. (Globalizimi dhe Tranzicioni (dilemat dhe sfidat) ,Prishtinë, 2006, fq.42

- b) *investimi shtesë në kapitalin e ndërmarrjes*
- c) *transformimi i kërkesave ndaj ndërmarrjes në investime në ndërmarrje*
- d) *transformimi i të gjitha aksioneve në Fondin Kroat për Zhvillim dhe po ashtu edhe në Fondin e Pensioneve*¹²⁴

Pas shpalljes së pavarësisë nga shteti kroat, struktura e kompanive ka filluar të ndahet në njësi dhe nënnjësi. Vlen të theksohet se sipas një hulumtimi të bërë nga Agjencioni i Konkurrencës së Kroacisë, shitja me pakicë përgjatë viteve 2008 – 2010, është rritur nga 52.4% në 58.4% (Agency, 2011). Këto të dhëna, qoftë nga literaturat relevante, apo edhe agjencioni në fjalë, individët dhe hulumtuesit e pavarur, dëshmojnë se procesi i tranzicionit, e në veçanti tranzicioni ekonomik ka ndikuar shumë pozitivisht në 6 Ante Markoviç – President dhe Kryeministër i Republikës së Kroacisë , 1989 – 1991 80 qëndrueshmërinë dhe stabilitetin ekonomik të këtij vendi¹²⁵

Pasi që siç dihet që njëri nga kriteret kryesore që i kërkon BE-ja, është pikërisht plotësimi i standardeve të kriterit ekonomik. Kapitalizmi kroat është specifik, qoftë në formë apo në zhvillimin e tij. Këtë fakt e kanë dëshmuar edhe analizat e shumta të autorëve të ndryshëm kroatë, qoftë për nga aspekti sasior ose cilësor edhe pse Banka Botërore e ka rankuar të 84 të mesin e 1837 shteteve për bërjen e biznesit, mirëpo Banka Europiane për Zhvillim dhe Ndërtim (ERBD) e ka rankuar me notën 3 (nga 1 deri në 3).¹²⁶

4.3 Procesi i privatizimit në Mal të Zi

Faza fillestare e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Malin e zi është bërë nëpërmes shëndrrimit të ndërmarrjeve shoqërore në “shoqëri aksionare”, ose në “shoqëri me përgjegjësi

¹²⁴ Isufi, B., In Privatisation , Prishtinë, 2006. fq.46

¹²⁵ Cvijanovic, V. R, From political capitalism to clientelist capitalism - The case of Croatia, 2011, page. 330-349.

¹²⁶ Cvijanovic, V. R. , From political capitalism to clientelist capitalism - The case of Croatia, 2011, page.330-349 .

të kufizuar”.¹²⁷ Pavarësisht ligjit të aprovuar në vitin 1994, me ç’rast janë paraparë 8 modele të privatizimit¹²⁸, megjithatë në praktikë janë përdorur kryesisht tri modele kryesore edhe atë:

- a) *modeli i dhënies dhe i shitjes së fletë-aksioneve ose pjesëve të aseteve me zbritje, me qëllim të shitjes së kapitalit shoqëror*
- b) *modeli i dhënies dhe i shitjes së fletë-aksioneve me qëllim të krijimit të Sipas të dhënave të vitit 2011 kapitalit shtesë, gjegjësisht rritjes së kapitalit,*
- c) *modeli i bartjes së fletë-aksioneve në fondet pa kompensim: në Fondin për zhvillimin e Republikës së Malit të zi, Fondin e pensioneve dhe Fondin inValideor, në Fondin për punësim ose në korporatën “Holding”, edhe modeli i shpërndarjes së fletë-aksioneve pa kompensim për 10% të vlerës kontabël të kapitalit të ndërmarrjes së privatizuar.¹²⁹*

Fondet ishin të obliguara që fletë-aksionet, të cilat hidheshin në shitje, para se gjithash, duhet t’i ofrohen ndërmarrjes e cila këto fletë-aksionë i ka bartur në fonde në mënyrë që të mund të blejë në llogari të të zënëve me punë. Këtë të drejtë ndërmarrja mund ta realizonte në 2 mënyra: a) me blerjen e fletë-aksioneve për punëtorët dhe persona të tjerë, ndërmarrja vepron në llogari të huaj, dhe b) ndërmarrja mund të veprojë në emër të vet dhe po ashtu edhe në llogari të vet (Selmanaj, 2006)¹³⁰

4.4 Procesi i privatizimit në Slloveni

Në bazë të disa provave përfshirë ligjet, praktikat dhe parashikimet e parapara nga autoritetet kompetente të shtetit slloven, konstatohet se:

- a) *Procesi i privatizimit të pronës shoqërore është realizuar në mënyrë shumë të ngadalshme*

¹²⁷ Simon, D. J. Ekonomske reforme u Jugoslaviji. Izvorni naucili rad , str.104- 128, 2003.

¹²⁸ Ljajovic, D.,Modeli privatizacije DP, Podgoricë,1998. str.37

¹²⁹ Medojević Nebojša, Podgoricë, 1996, fq. 252.

¹³⁰ Selmanaj, S. Globalizimi dhe Tranzicioni (dilemat dhe sfidat).,Prishtinë, 2006, fq.56.

- b) *Shitja e ndërmarrjeve nuk është bërë sipas intensitetit të paraparë*
- c) *Interesimi i kapitalit të huaj ishte dukshëm nën parashikimet sllovene.*¹³¹

Duke u mbështetur në këtë “dështim” nëse ashtu mund ta quajmë, kreatorët e modelit paraprak, u përcaktuan për privatizim masiv nëpërmes “certifikatave” pa kompensim të të gjithë qytetarëve sllovenë duke e përfshirë vetëm moshën e tyre madhore, por natyrisht duke ia përcaktuar edhe çmimin e kësaj “certifikatë”, e cila në atëbotë i takonte ish-valutës gjermanë (markës). Vlerat e “certifikatave” ndryshonin, pasi që çmimi më i lartë ishte për personat me moshë më madhore, Ndërsa çmimi i një “certifikatë” për një të moshës rinore ishte 300%-400% më i ulët.¹³²

Kapitulli i pestë– V

5.Rezultatet nga procesi i privatizimit

Pas një dekade të zbatimit të procesit të privatizimit në ekonominë e Republikës së Maqedonisë, 95% e ndërmarrjeve që kishin hyrë në procesin e privatizimit ishin të privatizuara. Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla mund të konsiderohej si i plotë, ndërsa te privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha po zbatohej plani aksionar për privatizimin dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve humbëse, të cilat ishin kryesisht ndërmarrje të mëdha.

Rezultatet kryesore të procesit të privatizimit më 30 qershor 2001 ishin:

1. *1,646 ndërmarrje të privatizuara plotësisht, dhe 113 të tjera në proces të privatizimit ku priteshin të privatizohen në muajt e ardhshëm.*
2. *të dhënat përkatëse për numrin e të punësuarve në secilin nivel të privatizimit të ndërmarrjeve janë: ndërmarrje të privatizuara me të punësuar më shumë se 226.500 punëtorë dhe ndërmarrje që vazhdonin procesin e privatizimit me të punësuar rreth 12,000 punëtorë.*

¹³¹ Selmanaj, S. Globalizimi dhe Tranzicioni (dilemat dhe sfidat). Faq.60-71 ,Prishtinë, 2006

¹³² Po aty.

3. raportet financiare vlerësuat se kompanitë plotësisht të privatizuara kishin pasuri gati 2.1 miliardë dollarë, dhe vlera e aseteve të kompanive që do të privatizoheshin rreth 50 milion dollarë.¹³³

Shumica e ndërmarrjeve të privatizuara i përkisnin sektorit industrial (486). Ata përbënin 30 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të privatizuara, dhe me 60 përqind e numrit të përgjithshëm të të punësuarve dhe me 63 përqind në vlerën e parashikuar të kompanive të privatizuara, e ndjekur nga sektori bujqësor me 418 ndërmarrje, të cilat përfaqësonin 25 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të privatizuara, me një pjesëmarrje prej 8.4 përqind në numrin e të punësuarve dhe 8.4 përqind në vlerën e parashikuar të ndërmarrjeve që do të privatizoheshin. Privatizimi i këtij sektori ka filluar në vitin 1996. Ndërsa në sektorin e tregtisë janë privatizuar 343 ndërmarrje, duke përbërë 21 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të privatizuara, 7.7 përqind të numrit të përgjithshëm të të punësuarve dhe 10.9 përqind të vlerës totale të parashikuar të ndërmarrjeve të privatizuara. Sektori i ndërtimit në Republikën e Maqedonisë megjithëse zinte një pjesë të vogël të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të privatizuara (121 ose 7.3 përqind), pjesa e tij në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ishte relativisht e lartë në 14 përqind, pasi është një sektor intensiv i punës dhe mbulon ndërmarrjet më të mëdha në Republikën e Maqedonisë.¹³⁴

Analiza e metodave të zgjedhura për kryerjen e procesit të privatizimit tregon se shumica e ndërmarrjeve (394 ose 24 përqind) u privatizuan përmes metodës së blerjes nga ana e punëtorëve. Me të punësuar rreth 17,193 (7,7 përqind) të totalit dhe me pasuritë prej 3.5 përqind të aseteve të përgjithshme të kompanive të privatizuara. Megjithëse metoda e blerjes nga ana e punëtorëve është përdorur më së shpeshti vetëm një pjesë e vogël e pasurisë u privatizua me anë të asaj metode. Kjo është si rezultat i faktit se sipas ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror kjo metodë mund të përdoret vetëm nga ndërmarrjet e vogla.¹³⁵

¹³³ Jovnovska,M., Belogaska,E., sajnski,S., Privatization and restructuring of the socially and state owned enterprises in the Republic of Macedonia and its implications on corporate governance,2002, page 1-3.

¹³⁴ Неновски, Т., Македонскиот пат во приватизацијата на општествениот капитал, Скопје, стр.84 -85.

¹³⁵ По ту, fq.85.

Sidoqoftë metoda mbizotëruese e privatizimit nga numri i të punësuarve dhe më e rëndësishmja nga vlera e kapitalit ishte " administrimi nga ekipet e menaxhimit". Agjencia e privatizimit e shihte këtë si një shenjë pozitive në drejtim të efikasitetit ekonomik duke pasur parasysh përqendrimin e pronësisë. Sipas të dhënave të Agjencisë së privatizimit më shumë se 60% e fuqisë punëtore në ndërmarrjet tashmë të transformuara kanë qenë të punësuar, ku pronarët kryesorë ishin vetë punëtorët.¹³⁶

Metoda tjetër që është përdorur më shpesh sipas numrit të ndërmarrjeve të privatizuara ishte blerja nga ana e menaxherëve (239 ndërmarrje ose 15 përqind të totalit). Me një numër të punësuarve rreth 71.667 ose rreth 32 përqind, dhe me pasuri 34 përqind.¹³⁷

Privatizimi i korporatave të mëdha që përdorin variantin e blerjes së modelit nga menaxherët, eufemistikisht të quajtur privatizimi " nga personat që marrin përsipër administrimin" duket të ketë qenë shumë i diskutueshëm, pasi që autoritetet arritën në përfundimin se privatizimi i korporatave të mëdha mund të mos të realizohet pavarësisht lëshimeve të ofruara ligjërisht me pagesë 10 deri në 20 përqind dhe kredi pesë-vjeçare pa interes, sepse menaxherët e korporatave nuk treguan interes për të ofruar para për blerjen e korporatave , kështu që ky problem u zgjodh në mënyrë "origjinale" edhe atë: Ekipeve të menaxhimit të ndërmarrjeve u lejuan të përdorin aksionet e tyre të brendshme të marra nga privatizimi i mëparshëm si pagesa, për më tepër aksionet e brendshme të fituara mund të përdoren për të siguruar të drejtën për të blerë aksionet e mbetura deri në të paktën 51% të vlerës së përcaktuar të ndërmarrjes në këste pesë vjeçare pa interes. Kjo paraqet një pikë kthese të madhe në privatizimin e Maqedonisë. Ky koncesioni i brendshëm ka bllokuar në mënyrë efektive çdo palë të jashtme të interesuar për të ofruar një plan zhvillimi alternative për një ndërmarrje që është në proces të privatizimit. Nga kjo kuptohet se pa përjashtim se marrëveshjet e privatizimit janë nënshkruar vetëm me persona të brendshëm. Menaxherët e ndërmarrjeve e kanë

¹³⁶ Славески,Т., Privatization in the Republic of Macedonia,EASTERN European Economics, vol.35, no.1, 1997, page.40.

¹³⁷ Jovnovska,M., Belogaska,E., sajnski,S., Privatization and restructuring of the socially and state owned enterprises in the Republic of Macedonia and its implications on corporate governance,2002, page 3.

përceptuar këtë si një shenjë se ata mund të bënin atë që donin pasi qeveria ka marrë një vendim politik që ka përcaktuar që ata të jenë pronarë "të ardhshëm" të korporatave.¹³⁸

Një numër i konsiderueshëm i privatizimeve u kryen duke e përdorur metodën e blerjes së ndërmarrjeve. Kjo metodë u aplikua për 172 ndërmarrje (11 përqind e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të privatizuara) që punësuan 50.134 punëtorë (23 përqind e numrit të përgjithshëm të të punësuarve).¹³⁹

Metoda më e përdorur gjatë procesit të privatizimit duke marrë parasysh numrin e ndërmarrjeve të cilat ishin të privatizuara ishte metoda e ashtuquajtur „blerja nga ana e punëtorëve,,. Por rëndësia e këtij modeli u zvogëlua në mënyrë të dukshme duke marrë parasysh numrin e vogël të punëtorëve të angazhuara në këto ndërmarrje dhe vlerat pasurore të ndërmarrjeve. Duke u nisur nga kjo bëhet e qartë se modeli i „blerjes nga ana e ekipeve menaxhuese,, ishte model mbizotërues. Por duhet theksuar se ky model u karakterizua me presionin dhe shtypjen e grupeve menaxheriale ndaj punëtorëve për të hequr dorë apo për ti shitur aksionet e tyre në mënyrë të pavullnetshme si dhe me përdorimin e metodave shumë agresive të shantazhit dhe manipulimit në mënyrë që të arrin në përfitimet personale.

Bazuar në dhënat e Agjencionit për privatizim të Republikës së Maqedonisë mund të konkludohen karakteristikat e më poshtme për procesin e transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror:

- a) *Procesi i privatizimit ishte një proces shumë më i ndërlikuar nga sa mendohej më parë dhe u desh shumë kohë për realizimin e saj, veçanërisht kur bëhet fjalë për funksionimin dhe ristrukturimin më të efektshëm të ekonomisë.*
- b) *Për procesin e privatizimit në Republikën e Maqedonisë si dhe për mënyrën e zbatimit të tij u theksua seriozisht edhe problemi i përdorimit racional të forcës së punës, rritja e papunësisë e cila rezultoi në largimin e punëtorëve të tepërt.*

¹³⁸ Slaveski, T., Privatization in Republic of Macedonia, Eastern European Economics, vol.35, no.1, 1997, page.43.

¹³⁹ Jovnovska, M., Belogaska, E., sajnski, S., Privatization and restructuring of the socially and state owned enterprises in the Republic of Macedonia and its implications on corporate governance, 2002, page 3.

Punëtorët kishin mbetur me paga minimale që i merrnin rregullisht ose nuk i merrnin fare si dhe mospagimi i kontributeve shëndetësore, pensioneve ose të sigurimeve shoqërore duke u bërë masive.

c) Papunësia u paraqit si një nga problemet më alarmante të tranzicionit në Republikën e Maqedonisë .

d) Me transformimin e planifikimit qendror në sistemet e tregut përmes reformave të ndërmarra, shumë analistë konstatojnë se rruga e tyre është relativisht e gjatë dhe e vështirë dhe se kostot ekonomike dhe sociale të zbatimit të tyre janë shumë më të mëdha se sa parashikohej.

Gjatë tranzicionit në Republikën e Maqedonisë në njërën anë tendencat për tu futur në ekonominë e tregut dhe teknologjisë moderne, por në anën tjetër është anashkaluar problemet me infrastrukturën dhe fuqinë punëtore të papunë. Punëtorët gjatë kësaj periudhe janë përballur me pasiguri sociale. Në këtë kontekst segmenti më i rëndësishëm i sigurisë së punëtore është paga mujore dhe marrja e rregulltë e pagës. Shikuar në atë kontekst shoqëror, privatizimi i ndërmarrjeve në tranzicion shpesh shoqërohej me pasigurinë për të ruajtur vendin e punës. Punëdhënësit e kanë lidhur atë me menaxhimin ekonomik dhe efektivitetin e kostos, si arsye për pushimet e shpeshta të "punëtorëve të tepërt" nëndërmarrjet e privatizuar.

Reformat që u kryen për më shumë se një dekadë në drejtim të shëndërrimit të sistemit ekonomik të Republikës së Maqedonisë në një ekonomi të orientuar tregu nuk dhanë efektet e pritura. Është veçanërisht e theksuar në nivelin mikro për sa i përket ristrukturimit të brendshëm të ndërmarrjeve, transferimit të njohurive teknologjike moderne teknike, menaxhimit dhe lidhjes bashkëpunuese si brenda dhe jashtë vendit.¹⁴⁰

Koncepti i përdorur në qasjen ndaj proceseve të tranzicionit (duke i dhënë një theks të veçantë kryesisht procesit të privatizimit, pa i inkurajuar në të njëjtën kohë proceset e institucionalizimit të duhur dhe zbatimin e mekanizmave të tregut) dha pikërisht rezultatet e vetme që mund të jepte. Në fakt përveç ndryshimit të natyrës së pronësisë, mund të thuhet se procesi i

¹⁴⁰ Стојанова,Б., Некои економски аспекти на постприватизациониот период- менаџментот, интерното реструктурирање и работната сила, Социјално – економските последици на приватизацијата во Македонија и Бугарија, ИССПИ, 2008, стр..158 – 161.

privatizimit nuk i dha efektet e pritura kryesisht efektin e tërheqjes së kapitalit të huaj, në ristrukturimin e brendshëm të ekonomisë, përmirësimin e menaxhimit dhe rigjallërimin e ekonomisë. Një situatë e tillë ka ardhur nga fakti se privatizimi i mëparshëm nuk ka kontribuar në ngritjen e efikasitetit të ekonomisë së përgjithshme.¹⁴¹

Tek punëtorët dhe menaxherët e ndërmarrjeve që përballen me privatizimin mbizotëruan dy tendenca edhe atë:

1. *Shmangja nga pagesa e shumave të konsiderueshme të mjeteve në kohën e privatizimit.*
2. *Shmangja e rezikut për mundësinë e hyrjes së subjekteve të huaj në ndërmarrje me një pjesë të konsiderueshme të aksioneve apo pjesëve. E gjithë kjo ka ndikuar që Republika e Maqedonisë ta zë vendin e fundit më famëkeq përse i përket ritmit të privatizimit dhe rezultateve të tij. Për më tepër, mungesa e një privatizimi efektiv dhe në të njëjtën kohë plaçkitja agresive e pronës shoqërore nga individët dhe grupet ishte shkak për të futur vendin në katastrofë ekonomike dhe sociale.¹⁴²*

Dhe më shumë se dhjetë vjet pas fillimit dhe implementimit të procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë ka pasur një situatë me disa ndryshime që kanë treguar disa çështje ende të pazgjidhura, të tilla si më poshtë:

1. *Shteti mbetet pronar dhe kreditor i rëndësishëm i ekonomisë.*
2. *Menaxhimi i i komplikuar nga struktura e copëtuar dhe jo-transparente e pronësisë, por edhe nga inferioriteti i strukturave ekzistuese të menaxhimit.*
3. *Kuadri ligjor dhe rregullator, për nga aftësia për të siguruar përputhjen dhe zbatimin e legjislacionit ekzistues ishin shumë më i dobët se niveli i kërkuar për funksionimin efektiv të sistemit juridik të vendit.*
4. *Një problem i veçantë ishte mungesa e informacionit të biznesit në vend dhe mospërputhja e tij me standardet ndërkombëtare.*
5. *Një mbështetje të pamjaftueshme financiare për të përmbushur nevojat e subjekteve të biznesit.*

¹⁴¹ Неновски, Т., Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Скопје, стр.91

¹⁴² Славески, Т., Македонската економија во транзиција, Институт отворено општество Македонија, 1995, стр.84

6. *Një zhvillim të pamjaftueshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.*

7. *Fuqia financiare e ndërmarrjeve e pamjaftueshme.*¹⁴³

E gjithë kjo tregon se edhe pas një dekade të privatizimit në Republikën e Maqedonisë kishte mungesë të mekanizmave të menaxhimit të tregut.

5.1 Dobësitë e procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë

Nga analiza e dhënave nga Agjencioni dhe nga praktika mund të konkludohet se procesi i privatizimit të paguar në vend që të përshpejtohet dhe të arrijë synimet, kishte mbetur shumë prapa objektivave të tij.

Edhe pse ekzistonte një detyrim ligjor dhe politikë për udhëheqësit e procesit të privatizimit për ta bërë atë një proces më transparent në praktikë, por për fat të keq në praktikë nuk ndodhi kështu çështja e fondeve të mbledhura nga privatizimi, struktura, sasia e tyre gjithmonë ngelën në fshehtësi të procesit të transformimit. Dobësitë e modelit të ashtuquajtur privatizimi i paguar ishte përjashtimi i qytetarëve në Maqedoni nga ky proces me anë të :

a) *favorizimin e investimeve të huaja*

b) *favorizimi i blerjeve menaxheriale*

c) *ulja e kostos së kapitalit*

d) *shitja e aksioneve me presion dhe shantazh*¹⁴⁴

Sipas prof. Tome Nenovski në procesin e transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror ka pasur një sërë të parregullsive dhe dobësive të cilët mund të cilët mund të veçohen si më poshtë:

¹⁴³ Стојанова,Б., Некои економски аспекти на постприватизациониот период- менаџментот, интерното реструктурирање и рботната сила, Социјално – економските последици на приватизацијата во Македонија и Булгарија, ИССПИ, 2008, ст. 162.

¹⁴⁴ Јакимовски, Ј., Противречност на приватизацијата, Социјално – економските последици на приватизацијата во Македонија и Булгарија, ИССПИ, 2008, стр. 37.

- a) *Aplikimi i metodologjisë për vlerësimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore nuk pasqyronte vlerën e vërtetë të ndërmarrjes të cilët ishin objekt të privatizimit.*
- b) *Privatizimi ka filluar pa një treg të aksioneve, me një transparence minimale, me gjendje financiare të panjohur për aksionarët e mundshëm, duke krijuar mundësi për manipulime.*
- c) *Punëtorët e ndërmarrjes nuk ishin të informuar rregullisht për funksionimin e ndërmarrjes.*
Menaxhmenti vet vendoste se kur do të fillonte privatizimi dhe shpesh zgjidhte momentin kur kompania kishte performancën më të ulët ekonomike.
- d) *Drejtorët vendosin për pushimet nga puna të punëtorëve në bazë të tepricës teknologjike dhe ekonomike.¹⁴⁵*

Privatizimi ka paraqitur reformë themelore strukturore dhe një proces shumë kompleks dhe shumëdimensional që ka përfshirë disa aspekte si juridike, politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike. Pasi një pjesë e madhe të popullatës si punëtorët, menaxherët, ish-punëtorët nuk arritën të qëndrojnë indiferent ndaj këtij procesit. Konflikti i interesave ngjalli kundërshtim serioz dhe çoi në mendimin se privatizimi ishte faktor themelor për të gjitha të këqijat e ekonomisë. Gjithashtu vlen të përmendet se pozita më e papëlqyer gjatë gjithë procesit i takonin të ashtuquajturëve "aksionarëve të vegjël" (aksionarët e pakicave që zakonisht identifikohen me punëtorët) pasi ata jo gjithmonë kanë pasur qasje në informacione të hollësishme në lidhje me privatizimin e ndërmarrjes së tyre, pasi edhe menaxhmenti shpesh nuk kishte interes të sigurojë informacionin e kërkuar.¹⁴⁶

Oferta me 30 përqind zbritje të kapitalit të përgjithshëm në çdo ndërmarrje ka rezultuar si ofertë is shumë tërheqëse për blerësit, në këto raste blerësit kanë qenë vet punëtorët e ndërmarrjeve. Në vijim aksionet e emetuara si aksione të brendshme të sipas Ligjeve të Markoviqit (nga ish-Jugosllavia) janë blerë nga të personat e punësuar në ndërmarrjet. Këto dy fakte flasin për privatizimin e "përfunduar" në shumë kompani diku shtatëdhjetë ndërmarrje me kapital shoqërorë .

¹⁴⁵ Неновски, Т., Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Скопје 1992, стр.94.

¹⁴⁶ Неновски, Т., Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Скопје, 1992, стр.95.

Ndërmarrjet që janë të privatizuar përmes metodës së blerjes nga ana e punëtorëve janë blerë nga punëtorët aktual. Rreth 65 përqind e të punësuarve në ndërmarrjet që zgjodhën atë metodë të transformimit të ndërmarrjeve përdorën të drejtën ekskluzive për ti blerë aksionet. Kjo do të thoshte rreth 8,000 aksionarë në 295 kompani ose 27 aksionarë mesatarisht në secilën kompani.

Privatizimi me anë të metodës së blerjes së borxhit në praktikë është shëndërruar në blerje nga menaxherët dhe punëtorët, pasi që në shumicën e rasteve menaxherët ekzistues dhe të gjithë ose shumica e të punësuarve ishin të klientëve të ndërmarrjes. Kjo ishte shtet shenja më e qartë e qasjes së papranueshme ku një investitor strategjik ose një grup relativisht i vogël i menaxherëve të ardhshëm të jenë pronarët kryesorë të kompanisë. Më pak se 15% të ndërmarrjeve janë blerë nga investitorët strategjikë, dhe në rastet pra ato janë fituar nga grupe të aksionarëve relativisht të mëdha dhe heterogjene. Me anë të cilës qartë kuptohet se pjesa dërmuese e ndërmarrjeve me kapital shoqëror janë privatizuar me zbatimin e një modeli të pastër të transformimit përmes blerjes, edhe atë blerjes interne nga ana e menaxherëve dhe punëtorëve.¹⁴⁷

5.2 Pasqyra e objektivave të pritura nga procesi i privatizimit

Fillimi i procesit të privatizimit është pritur me plot entuziazëm, një sërë detyrash dhe objektivash për të realizuar, pritje të shumta nga ky proces pas përfundimit të cilës pritej të ndodh një rilindje për Republikën e Maqedonisë. Procesi i privatizimit si shkopi magjik do të jepte zgjidhje për çdo problem të ballafaquar deri më atëherë, të paktën këto ishin pretendimet dhe arsyetimet e fuqive politike për të filluar procesin e privatizimit ku me çdo kusht donin ta bindin popullin për të. Po në të vërtetë procesi shumë vjeçar i privatizimit a i arriti objektivat e përcaktuara në fillim të procesit, çka fitoi Maqedonia dhe populli nga ky proces? Më poshtë bazuar në hulumtimet e kryera jemi munduar që ti ilustrojmë objektivat e arritura nga ky proces.

¹⁴⁷ Po aty, fq. 97.

5.2.1 Arritja e efikasitetit ekonomik

Objektiva kryesore e gjithë procesit të ristrukturimit të pronësisë në Republikën e Maqedonisë ashtu siç ndodhi edhe me vendet tjera të Evropës Lindore ishte rritja e efikasitetit ekonomik të njësive ekonomike individuale, rrjedhimisht ekonomisë në tërësi. Pas një periudhe shumëvjeçare të përpjekjeve reformuese që synon krijimin e tregut konkurrues dhe mjedisin stimulues të punës, vendet socialiste pranuan se prona me kapital shoqëror nuk mund të përballojë e as më shumë të garojë me ekonominë e tregut të tipit perëndimor. Është vështirë të vlerësohet ndryshimi në efikasitetin ekonomik të ndërmarrjeve të privatizuara duke izoluar të gjithë përcaktuesit e tjerë, veçanërisht në rastin e Maqedonisë, ku siç u shpjegua edhe më parë vitet 90-ta ishin të bollshme me tronditje ekonomike, duke krijuar kështu një ambient jashtëzakonisht të pafavorshëm për ndërmarrjen e reformave ekonomike. Niveli i PBB-së si një masë e efikasitetit ekonomik ka qenë në luhatje gjatë gjithë kësaj periudhe, duke përfunduar dekadën në një nivel më të ulët se ai në fillim. Të dhëna të tjera makroekonomike tregojnë gjithashtu tendenca dekurajuese. Për shembull, niveli i investimeve kapitale nuk e ka arritur nivelin e dëshiruar dhe është shumë larg mesatares për ekonominë në tranzicion. Të dhënat në lidhje me papunësinë janë edhe më të frikshme.

Për një studim më të saktë duhet të bazohet në dhënat nga deklaratat vjetore të ndërmarrjeve. Një hulumtim i tillë u prezantua në kuadër të studimit të për zhvillimet e fundit në Maqedoni (Cebotari et al., 2000, Shtojca III)¹⁴⁸. Të dhënat tregojnë se nuk kishte prova të mjaftueshme që tregojnë se privatizimi në Maqedoni kishte çuar në një performancë më të mirë të ndërmarrjeve, veçanërisht në afat të shkurtër. Autori R. Glennerster thekson se mungesa e një rritje të konsiderueshme të përfitimit ishte rezultat i "privatizimit mbizotërues të brendshëm dhe kushteve të dobëta rregulluese". Gjithashtu, fakti që ndërmarrjet në pronësi të huajve i tejkalojnë ato në pronësi të brendshme u vërtetua në një hulumtim tjetër (Hadzi Vasileva - Markovska et al., 2001). Autorët, duke përdorur një model të bazuar në funksionin e prodhimit "Cobb-Douglas" tregojnë se kompanitë e fituara nga të huajt "përmirësojnë

¹⁴⁸ Cebotari, Aliona, Drummond, Paulo, Glennerster, Rachel, Marciniak, Phillipe, Sekine, Toshitaka, Young, Hue, 2000. Former Yugoslav Republic of Macedonia. Recent Economic Developments. IMF, Washington, D.C.

performancën e tyre, në masë të madhe. Nga ana tjetër, privatizimet nga ana e subjekteve të brendshëm kanë treguar rezultate të paqarta ... ".¹⁴⁹

Gjatë shqyrtimit të dhënave nga raportet vjetore të ndërmarrjeve, duhet të kemi parasysh një fakt shumë të rëndësishëm. Përkatësisht, shumica e ndërmarrjeve janë kryesisht në pronësi të brendshme, ka pak nxitje që menaxherët të raportojnë fitime të larta dhe ta ndajnë atë përmes dividendëve me aksionarët e tjerë.

Ata shumë shpejt u bënë të vetëdijshëm se angazhimi në praktika mashtruese si "tunizimi" dhe "plaçkitja" mund të ishte shumë më i dobishëm nga pikëpamja personale. Sigurisht, kjo mund të bëhej vetëm në kurriz të kapitalit të kompanisë dhe me shpenzimet e aksionarëve të tjerë, por frika nga largimi u abuzua nga menaxherët me qëllim që të sigurimit të kontrollit mbi aksionarët-punonjësit e mbetur (në disa raste, që përfaqësojnë shumicën e aksionarëve).¹⁵⁰

*Të dhënat makroekonomike nga dekada e kaluar

VITI	PBB/ \$	KAPITALI FIKS BRUTO SI % E PBB	SHKALLA E PAPUNËSISË
1990	2.235	19,1	-
1991	2.083	17,2	-
1992	1.937	15,6	-
1993	1.785	17,9	-
1994	1.742	15,5	-
1995	1.705	20,8	-
1996	1.709	20,1	37.4
1997	1.732	21,0	34.4
1998	1.782	22,3	35.9
1999	1.848	19,7	35.9
2000	1.924	21,4	35.8
2001	1.83	18,3	38.6
2002	1.839	19,7	35.8

Burimi: Zyra e Statistikave në Maqedoni - Raportet vjetore; Byroja Kombëtare e Punësimit

¹⁴⁹ Hadzi-Vasileva Markovska, Verica, Slaveski, Trajko, Pahor, Marko, 2001. Does the privatisation method matter? Privatisation and corporate governance in Macedonia. Economic and Business Review 3 (3-4), page.325-344.

¹⁵⁰ Арсов, Ш., Post privatization- retrospective of Macedonia, Could we have done it better? Економски Факултет, Скопје, стр.13

* Në vitet 1990-1995, llogaritja e shkallës së papunësisë u krye duke përdorur një metodë tjetër. Shkalla e papunësisë shkonte midis 20 dhe 27%, por për shkak të papajtueshmërisë së të dhënave nuk janë të paraqitura në tabelë.

4.2.2.Efektet financiare

Objekti i akumulimit financiar u vendos në themelet e konceptit të paguar privatizimit. Të ardhurat nga privatizimi do të përdoren për lehtësim të barrës sociale nga tranzicioni, shlyerjes së borxheve të brendshme dhe të jashtme të shtetit dhe eventualisht financimi i disa projekteve.

*Të ardhurat financiare nga procesi i privatizimit në (EURO):

	Deri me 2000	2001	2002	2003	Totali
Të ardhurat totale	270.577.031	33.375.546	24.479.386	26.101.037	354.533.000
Pagesa në para	36.674.266	22.508.758	10.150.291	16.129.643	85.462.958
Pagesa pa para	233.902.766	10.866.788	14.329.095	9.971.394	269.070.043

Burimi: Agjencia e privatizimit të Republikës së Maqedonisë

Sot, derisa i krahasojmë të ardhurat financiare nga privatizimi me istën e paraparë për përdorimeve të tyre, bëhet shumë e qartë se sa i gabuar ka qenë perceptimi i politikbërësve në atë kohë. Të ardhurat totale përfaqësojnë më pak se 12% të vlerës totale të përcaktuar të të gjitha ndërmarrjeve të privatizuara (afërsisht 2,3 miliardë EUR). Ky koncept i gabuar mund të sqarohet me disa fakte. Së pari, është e paqartë nëse krijuesit e konceptit ishin të vetëdijshëm për nivelin e privatizimit të arritur nga ndërmarrjet maqedonase para vitit 1993. Përkatësisht, shumica e ndërmarrjeve më të mëdha dhe më të suksesshme kishin arritur nivele të konsiderueshme të privatizimit, në shumicën e rasteve ato ishin të privatizuar me kriteret e përcaktuara në ligjin e vitit 1993. Së dyti kanë pasur ndikim edhe zbritjet e paraparë lidhje me shitjen e aksioneve. Së treti, 15% e aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e mbetur shoqëror duhej të transferohej në fondin e pensioneve pa pagesë. Së katërti, me qëllim për lirim nga

borxhi publik i shkaktuar nga depozitat e këmbimit valutor të ngrira në sistemin bankar, u lejua pagesa me anë të aksioneve duke i përdorur të ashtuquajturat Certifikata të depozitave të ngrira të valutave. E gjithë këto kanë shkaktuar mosarritjen e efikasitetit financiar të paraparë në fillim të procesit të privatizimit pasi të gjitha faktet e lartëpërmendura kanë pasur një ndikim të tërthortë financiar, në veçanti fakti i katërt i elaboruar pasi që në asnjë mënyrë të ardhurat nga aksionet nuk mund të përdoren për zhvillim ose për pagesën e shpenzimeve buxhetore.¹⁵¹

5.2.2 Tërheqja e investorëve të huaj

Të dhënat nga tabela e poshtë paraqitur padyshim tregojnë se procesi i privatizimit në Republikën e Maqedonisë nuk e ka tërhoqur vëmendjen e investorëve të huaj. Numri i ndërmarrjeve të blera nga të huajt ishte jashtëzakonisht i vogël, dhe hyrjet financiare në këtë drejtim pasuan të njëjtin fat.

Viti	Numri i ndërmarrjeve të shitura te investorët e huaj	Shuma e kapitalit të huaj (në EURO)	Metodat e Privatizimit					
				Investim shtesë	Blerje	Shitje përmes burses	Skëmbim borxhi	Shitje tek investitori strategjik
1995	5	4.269.056	1	3	1			
1996	5	13.524.807	1	3	1			
1997	3	4.458.886	1	2				
1998	4	21.196.274		2		1	1	
1999	5	32.675.297				4		1
2000	12	18.164.500				10		1
2001	4	4.062.626				4		
2002	1	153.453						1
Totali	39	98.504.899	3	10	2	19	1	3

Burimi: Agjencia e privatizimit të Republikës së Maqedonisë, raporti i muajit shkurt, 2002.

¹⁵¹ Po aty, fq.14.

Arsyet se pse gjatë procesit të privatizimit interesi i investitorëve të huaj ka qenë shumë më i ulët në krahasim me pritshmëritë në fillim të këtij procesi janë të shumta edhe atë si në fillim mund të themi se niveli i lartë i privatizimit të mëparshëm në ndërmarrjet më tërheqëse ka qenë një pengesë për hyrjen e investitorëve të huajve. Nga 234 ndërmarrje 83 ndërmarrje ishin të privatizuara me anë të metodës së blerjes nga ana e menaxherëve, hyrja e të huajve ishte e pamundur pa përfshirë një pjesë të aksionarëve të afërt, për shkak të situatës në këto ndërmarrje ku pjesa e kapitalit në dispozicion për shitje pas njohjes së privatizimit të mëparshëm dhe transferimit të detyrueshëm në fondin e pensioneve përfaqësonte më pak se 51% të kapitalit të përgjithshëm¹⁵², investimi në ndërmarrjet me kapital shoqëror të Republikës së Maqedonisë nuk ishte tërheqës për investitorët e huaj. Një faktor tjetër mjaft i rëndësishëm i cili ka shërbyer si shkak për mos investimin e investitorëve të huaj në Republikën e Maqedonisë ka të bëjë me atë se 38 % e ndërmarrjeve më profitabile të RM- së ishin të privatizuara me ligjin e vjetër para vitin 1993, dhe ishte shumë normale që ndërmarrjet e ngelura të cilët nuk ishin profitabile dhe me ngecje të konsiderueshme në punën e tyre nuk hynin në sferën e interesit të investitorëve.¹⁵³ Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte ngurrimi i punëtorëve për të lejuar të huajt që të marrin kontrollin në kompanitë e tyre për shkak të frikës nga humbja e mundshme e vendeve të punës. Pasi që privatizimi ishte lënë në duart e tyre ata zakonisht zgjidhnin një metodë që do të mbyllte portën për të huajt. Megjithatë Qeveria shpalli një politikë të mundësive të barabarta për investitorët e huaj dhe vendas, praktika dëshmoi se nuk ishte e përgatitur mirë për të pranuar blerësit e huaj për sa i përket aftësive administrative, por edhe në lidhje me dëshirën për të mbajtur marrëdhënie të mira me elitën e biznesit vendas. Një ndryshim në këtë qëndrim mund të vërehet në periudhën pas vitit 1998 (Qeveria e re), implementimi i teknikave të reja të privatizimit qeverisë i dhanë më shumë fuqi në këtë proces ku u arrit një rritje e konsiderueshme e investimeve të huaja përmes shitjeve direkte.

5.2.4 Efektet sociale nga procesi i privatizimit

¹⁵² The apparent shortcomings of insider privatisation are accurately listed in the comprehensive survey of the literature on privatisation by Havrylyshyn, Oleg and Donal McGetigan, 1999. Privatisation in transition countries: A sampling of the literature. IMF Working Paper 99/6, page 21-22.

¹⁵³ Арсов, Ш., Post privatization- retrospective of Macedonia, Could we have done it better? Економски Факултет, Скопје page16.

Një ndër pasojat e procesit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë ishte rritja e numrit të të papunësuarëve si pasojë e largimit nga puna si tepricë teknologjike, për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve ose përfundimit të aktiviteteve të caktuara të ndërmarrjes. E gjithë këto kanë kontribuar në rritjen e numrit të përgjithshëm të personave të papunë. Kjo ka sjellë gjithashtu një rritje të numrit të personave të papunë që marrin përkrahje financiare , gjë që ka kërkuar sigurimin e një sasi më të madhe të fondeve nga buxheti i shtetit dhe nga kontributi. Duhet të merret në konsideratë edhe fakti që këta persona hyjnë në kategorinë e përfituesve afatgjatë të përfitimeve në para, kryesisht janë persona mbi 25 vjeç ose mbi 55 vjeç të cilët kanë të drejtë në përkrahje financiare deri në ri-punësimin ose pensionimin e tyre. Prej nga rrjedh se për të ardhmen një sasi më e madhe e fondeve do të jenë të nevojshme për të siguruar të sigurimin shëndetësor, të drejtën e pensionit dhe sigurimin invalidor të këtyre personave, gjë që do të paraqet një ngarkesë afatgjatë për buxhetin shtetëror.

*Numri dhe shkalla e paunësisë në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 1996-2000

Numri i të papunësuarëve			Shkalla e papunësisë	
Viti	Anketa për fuqinë punëtore	Enti për punësim	Anketa për fuqinë punëtore	Zgjedhjet administrative
1996	251.489	235.135	31.9	38.8
1997	288.213	250.508	36	40.6
1998	284.064	275.232	34.5	46.6
1999	261.452	332.812	32.4	51.5
2000	257.485	361.323	32.1	53.4

Burimi: Zyra e Statistikave Shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Punësimi dhe Papunësia në Republikën e Maqedonisë, Shkup, viti 2000.

Tabela tregon se gjatë gjithë kësaj periudhe nga 1996 në 2000 në Republikën e Maqedonisë ka patur një rritje të dukshme në numrin dhe shkallën e papunësisë, madje në Evropë shikuar

nga shkalla e papunësisë Republika e Maqedonisë është ranguar në rradhët e para. Papunësia në Republikën e Maqedonisë ka paraqitur një problematik të thellë dhe ka qenë e vështirë është që ajo të zgjidhet në një periudhë të shkurtër kohore, pasi që kërkon një veprimtari më dinamike investuese e cila në ato rrethana ka qenë e pamundur. E gjithë kjo ka kontribuar në rritjen e problemeve dhe përkeqësimin e situatës në sektorin social.

Në tabelën në vijim mund të shihen të dhënat lidhur me numrin e të papunësuarëve të cilët kanë qenë shfrytëzues të përkrahjeve financiare në muajin shkurt gjatë viteve 1998 – 2001. Duke u bazuar në dhënat nga Zyra e Statistikave mund të konkludohet se një shumë e lartë nga buxheti shtetëror është ndarë për përkrahjet financiare, edhe pse në vitin 2000 ka pasur një zvogëlim të numrit të shfrytëzuesve të përkrahjeve financiare ky numër në vitin 2001 ka shënuar një rritje të dukshme duke u barazuar me të dhënat e vitit 1998.

Të papunësuarit- Shfrytëzuesit të përkrahjeve financiara si pasojë e:	II - 1998	II - 1999	II - 2000	II - 2001
Falimentimit	24.080.	14.313	8.694	8.195
Punësimit sezonal	1.967	1.347	1.289	1.393
Tepicës teknologjike nga ndërmarrjet humbëse(25)	6.384	5.959	5.357	4.847
Tepicës teknologjike nga ndërmarrjet humbëse(12)	-	-	-	2.277
Totali:	48.346	37.256	33.382	37.025

Burimi: Zyra e Statistikave Shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Punësimi dhe Papunësia në Republikën e Maqedonisë, Shkup, viti 2000.

Përfundim

Gjatë këtij punimi theks të veçantë i është kushtuar analizës, konkretizimit dhe sqarimit të dispozitave të Ligjit për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror i cili ka shërbyer për zhvillimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve me Kapital shoqërorë. Paraprakisht janë analizuar shkaqet dhe arsyet për fillim të privatizimit, struktura ekonomiko – juridike e Republikës së Maqedonisë si dhe synimet dhe pritjet nga ky proces. Në mënyrë të detajuar janë analizuar subjektët me të drejtë pjesëmarrjeje në procesin e privatizimit si dhe roli dhe rëndësia e Agjencionit për Transformim të Ndërmarrjeve me Kapital Shoqëror apo Agjencia për Privatizim si organ kuazi - qeveritar.

Gjatë punimit është theksuar edhe ndarja që ekziston në mes të ndërmarrjeve me kapital shoqëror dhe metodat përkatëse që zbatohen për privatizimin. Në mënyrë të detajuar janë të përshkruara kushtet për zbatimin e metodave dhe karakteristikat e këtyre metodave me qëllim të gjetje të metodës më adekuade për privatizim të ndërmarrjes në fjalë.

Mbi të gjitha pikë interesi i punimit ka qenë pa dyshim prapavija e procesit të privatizimit, realizimi i saj në praktik si dhe rezultatet dhe pasojat nga ky proces. Gjatë studimit të rrethanave të fillimit të privatizimit në Republikën e Maqedonisë është konstatuar qartë se fillimi i privatizimit është paraqitur në rrethana jo të shëndosha shoqërore dhe juridike, realizimi i privatizimit me Ligjet e ish-RSFJ-së ka qenë gjithnjë në dëm të shoqërisë së Republikës së Maqedonisë pasi është realizuar privatizimi masiv i një numri tejet i madh i ndërmarrjeve me shuma qesharake. Por fatkeqësia më e madhe qëndron në faktin se Qeveria e Maqedonisë pas shpalljes së pavarësisë në sjelljen e ligjit nacional për privatizim është vonuar afro dy vite dhe brenda kësaj kohe ka vazhduar me zbatimin e ligjeve të ish-RSFJ-së, natyrisht lind pyetja se kjo vonesë a ishte e planifikuar dhe e qëllimshme? Në qoftë se e analizojmë numrin e ndërmarrjeve të mëdha dhe të sukseshme që janë të privatizuara mes këtyre dy viteve si dhe afërsinë e personave që janë bërë pronarë të këtyre ndërmarrjeve me pushtetin shtetërorë përgjigjja do të jetë shumë e qartë se rrethi i

ngushtë i pushtetit politik duke u mshehur pas ligjeve të Markoviqit kanë pasuruar arkat e tyre private derisa arkat shtetërore kanë filluar të zbrazen.

Procesi i privatizimit edhe pse ligjrisht ka qenë i detyruar të jetë i hapur dhe transparent për publikun ajo gjithnjë e më shumë në praktikë është zhvilluar pas dyerëve të mbyllyra. Fati i ndërmarrjeve dhe korporatave me kapital shoqërorë ishte i lënë në duartë e ekipeve të menaxhimit të cilët gjithnjë i iknin investimeve për rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së ndërmarrjes me qëllim të uljes së vlerës së ndërmarrjeve me ç'rast fitimi i pronësisë do të arriheshte me një shumë minimale. Për fat të keq në këtë mënyrë shumë ndërmarrje shkuan deri në falimentim dhe u shitën me çmime qesharake, Republika e Maqedonisë nuk humbi vetëm në aspektin e të hollave por edhe të ndërmarrjeve që prodhonin produkte vendase dhe ishin burim i kafshatës së gojës së qindra punëtorëve.

Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqërorë edhe pse lejonte mundësinë e blerjes së ndërmarrjeve nga ana e punëtorëve , në realitet kjo u është kufizuar në mënyrë maksimale nga ana e ekipeve menaxheriale, me anë të mashtrimit dhe shtypjes punëtorët janë detyruar të heqin dorë nga aksionet e tyre përndryshe kanë qenë të kërcënuar se do të largohen nga puna. Sjellja e tillë e ekipeve menaxheriale nuk mund të justifikohet në asnjë mënyrë, pasi që paraqet kufizim të drejtëpërdrejtë të drejtave dhe lirive të punëtorëve. Me sjellje të ngjajshme të ekipeve menaxheriale janë përballur edhe investorët potencial të jashtëm, e cila është edhe një ndër arsyet se pse numri i ndërmarrjeve të privatizuara nga investorët e jashtëm është i paktë. Tash lind pyetja kush është fajtorë Agjencia për privatizim e cila nuk e ndjek punën e ekipeve menaxheriale apo Qeveria e cila nuk e kontrollon veprimtarinë e Agjencionit? Apo të dy të cilët i mbyllën sytë dhe i ndihmuan privatizimit antijurik?!

Një tjetër lëshim gjatë realizimit të privatizimit është konstatuar në mos ofromin e mbrojtjes juridike të ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre ligjor. Edhe pse dispozitat ligjore obligojnë dhënien e përparësisë ndaj ish-pronarëve në praktikë e njëjta nuk është e realizuar në praktikë pasi që privatizimet janë kryer në mënyrë të fshehur duke mos e

informuar publikun në kohë, përkundër padive të ish- pronarëve të drejtuar për kthimin e pronave të tyre një numër të konsideruar të padive u hodhën poshtë.

Një tjetër karakteristikë e procesit të privatizimit është Privatizimi masiv i zhvilluar në rajonin e Pollogut i cili dikur ka qenë qendër industriale sidomos qyteti i Tetovës i cili për një kohë të shkurtë me një privatizim të hovshëm si dhe jo transparentë u kthye në një qytet të vdekur. Në ndërmarrjet, fabrikat dhe kombinatet e komunës së Tetovës, gjatë periudhës para pavarësimit të Maqedonisë kanë qenë të punësuar mbi 25 mijë punëtorë, shumica e të cilëve pas privatizimit të tyre mbetën të papunë dhe në mëshirën e fatit. Ardhurat vjetore të këtyre kapaciteteve ekonomike të komunës së Tetovës përbënin gatise gjysmën e buxhetit të Republikës së Maqedonisë. Brendi i njohur i tekstilit Teteks me 7 mijë punëtorë e kishte pushtuar tegun e ish- RSFJS-së, Evropën perëndimore, Lindjen e afërt dhe të mesme, por edhe ky brend i njohur e morri hisen nga privatizimi si dhe të njëjtin fat e përjetuan edhe ndërmarrjet tjera Kombinati metalurgjik „Jugohrom“, Fabrika e plastikës mjekësore „Tetova“, Kombinati i industrisë së drurit „Jellak“, Kombinati i duhanit „Tetovo Tabak“ etj.

Pas një krahasimi mes objektivave të procesit të privatizimit dhe rezultateve të arritura nga privatizimi shihet qartë se sa Maqedonia ka ngelur largë objektivave të saj, nuk e kemi një gjallëri ekonomike pasi shumicës së ndërmarrjeve pas privatizimit i është vënë çelësi, Maqedonia nuk arriti të bëhet qendër i investimeve të huaja, shkalla e papunësisë jo që nuk u zvogëlua por edhe më shumë u rritë, si pasoj e humbjes së vendeve të punës filloi emigrimi i qytetarëve nëpër Evropë, u ul numri i prodhimeve vendase pasi u mbyllën shumë ndërmarrje. Gjatë kohës së pandemisë Covid -19 u kuptua edhe njëherë rëndësia e ekzistencës së korporateve, ndërmarrjeve vendase për të prodhuar produkte për qytetarët e vendit mbi të gjitha rëndësia e ekzistimit të politikanëve që do të mbrojnë interesat e shoqërisë, të cilët tre dekada më parë nuk u mbrojtën, interesa të cilët po të ishin mbrojtur sot do të ekzistonte Fabrika e Teteksit e cila do të prodhonte veshje mbrojtëse për personelin mjekësorë, Fabrika e Plastikës Mjekësore „Tetova“ e cila do të prodhonte maska dhe doreza për mbrojtjen e qytetarëve dhe personelit mjekësorë, Zastava Ohrid do të prodhonte maqina për dezinfektimin e rrugëve dhe hapësirave jetësore etj.

Së fundit dua të theksoj se jo vetëm gjatë procesit të privatizimit por edhe gjatë realizimit të proceseve të tjera gjithnjë duhet të mbrohet interesi shoqërorë pasi shoqëria e përbën shtetin, dispozitat ligjore të cilët sillen në seanca parlamentare aq sa janë të obligueshme për qytetarët po aq janë të obligueshëm edhe për fuqinë që i ka sjellur të njëjtat. Çdo mosrespektim dhe mos sjellje konform dispozitave ligjore sjell pasoja të rënda ekonomike, juridike dhe sociale.

Rekomandime

- Republika e Maqedonisë si shtet bashkëkohor dhe pretendent për anëtarësim në familjen e Unionit Evropian, duhet të tregojë një kujdes të veçantë në mbrojtjen e të drejtave pronësore, si dhe disponimin me anë të drejtave pronësore konform dispozitave ligjore për të mbrojtur interesin e përgjithshëm.
- Gjatë ndryshimit të titullarit të të drejtave sendore, në këtë rast procesi i privatizimit kalimi i pronësisë së ndërmarrjeve shoqërore në atë private duhet realizuar gjithmonë konform dispozitave ligjore duke kushtuar rëndësi interesit shoqëror dhe realizimit të objektivave të vet procesit.
- Gjatë realizimit të procesit të privatizimit duhet të ketë trajtim të barabartë ndaj investorëve të jashtëm dhe të brendshëm dhe marrëveshja për privatizim të realizohet me palën që i plotëson kushtet dhe ofron perspektiv për një privatizim të suksesshëm dhe të shëndosh, pasi që praktika tregon një trajtim jo të barabartë dhe favorizim të palës së brendshme respektivisht menaxherëve.
- Në ndërmarrjet me kapital shoqëror, sjellja e punëtorëve dhe ekipeve menaxhuese dhe procesi i udhëheqjes së ndërmarrjes duhet të jetë në kontrollin e organeve kompetente pasi praktika tregon një përvojë të keqe në këtë drejtim. Sjellja shtypëse dhe joligjore e menaxherëve ndaj punëtorëve ka shkaktuar fitimin e akcioneve në mënyrë të dhunshme si dhe qëndrimet e menaxhëve ndaj investorëve të jashtëm potencial kanë shkaktuar largimin e investorëve të jashtëm nga tregu i Maqedonisë.
- Organi kompetent për udhëheqjen e procesit të privatizimit duhet të jetë organ i pavarur gjatë sjelljes së vendimeve, poashtu organ me kuadër profesionale të përbërë nga jurist dhe ekonomist kompetent pa prapavij politike.
- Gjatë zhvillimit të procesit të privatizimit rëndësi të veçantë duhet të kushtohet një kategori të veçantë subjektëve potencial edhe atë pronarëve të mëparshëm të ndërmarrjeve apo pasardhësve të tyre ligjor pasi që subjekte me përparësi gjatë procesit të privatizimit.

- Së fundi mund të jepet një rekomadim në lidhje me zhvjeshjen e kostumit politik të institutit të privatizimit pasi gjatë gjithë procesit mund të vërehet një ndikim të mirëfilltë të politikës e cila manifestohet me ngrënie të kapitalit shoqëror dhe favorizim të krahut politik. Me ç’rast lirisht mund të thuhet se privatizimi në Republikën e Maqedonisë mbi të gjitha ka qenë një proces politik.

Literatura e shfrytëzuar

Tekste, monografi, artikuj

1. Boris Crnković, Željko Požega, Jelena Briševac, Privatizacija, državno vlasništvo i poslovni rezultat poduzećac, Ekonomski vjesnik : Review of Contemporary Entrepreneurship, Business, and Economic Issues, Vol. XXIII No. 2, 2010.
2. Cebotari, Aliona, Drummond, Paulo, Glennester, Rachel, Marciniak, Phillipe, Sekine, Toshitaka, Young, Hue, 2000. Former Yugoslav Republic of Macedonia. Recent Economic Developments. IMF, Washington, D.C.
3. Dragan Lajovic, Modeli privatizacije DP, Podgoricë, 1998.
4. Hadzi-Vasileva Markovska, Verica, Slaveski, Trajko, Pahor, Marko, 2001. Does the privatisation method matter? Privatisation and corporate governance in Macedonia. Economic and Business Review 3 (3-4).
5. <http://www.socioloskaluca.ac.me/PDF6/Mitrovic,%20M.,%20Svojina%20kao%20drustvena%20mo>
6. Juraj Cenkić, Zakon o rastavi crkve I drzavi u Francusko I kanonsko pravo, p. 275
7. Mihaela Grubišić , Mustafa Nušinović ,Gorana Roje Prema učinkovitom upravljanju državnom imovinom, Financijska teorija i praksa 33 , Zagreb 2009.
8. Milovan Mitrovic, Svoina kao drustvena moc, Filozofski fakultet, Novi Sad,
9. Miroljub Sukarov, Repport of Privatization in Macedonia, United Nations on and Swedish International services Conference on Privatization of Public Sector Activities , Stockholm, 5 – 7 sept. 1994.
10. Moisiu, U., The Procces of Privatisation in Albania, Tirana, 2012
11. Mujkic Ervin, Državna imovina u Bosni i Hercegovini – geneza problema, Fondacija Centar za javno pravo,
12. Oleg Havrylyshyn , Donal McGetigan The apparent shortcomings of insider privatisation are accurately listed in the comprehensive survey of the literature , 1999. Privatisation in transition countries: A sampling of the literature. IMF Working Paper 99/6,

13. P.SIMONETTI, Ownership and its transformation, warranty and protection...Coll.Rights.factor.Rij.(1991) v. 31, no.1
14. Sasho Arsov , Stock Market Rationale under Conditions of Defective Corporate Governance- The case of Macedonia, Mediterranean Journal of Social Sciences, vol.4. no.2,2013.
15. Sasho Arsov, Post privatization- retrospective of Macedonia, Could we have done it better? , Економски Факултет,Скопје
16. Selman Selmanaj, Globalizimi dhe Tranzicioni (dilemat dhe sfidat) ,Prishtinë, 2006.
17. Simon, D. J. Ekonomske reforme u Jugoslaviji. Izvorni naucili rad , 2003.
18. Vladimir Cvijanovic, Denis Redzepagic, From political capitalism to clientelist capitalism - The case of Croatia ,2011.
19. Агенција на Република Македонија за трансформација на општествен капитал, Скопје, 1996.
20. Арсен Јаневски , Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Парнично право, Правен факултет Јустинијан Први, Скопје, 2009 година.
21. Асен Групче ,Имотно (граѓанско) право –втор дел Стварно право, Култура 1983,Скопје.
22. Асен Групче, За републиката и општината како два сегмента на државната власт и за нивната сопственост, Скопје, 2001 година
23. Бобек Шуклев, Privatization in the Republic of Macedonia, Eastern Europe Economics, vol.34, no.6, 1994,
24. Бошко Стефановски, Приватизација на општествените претпријатија, Центар за економско правен консалтинг Б&Ф , Скопје, 1994 година
25. бр.6/1980 година
26. Војо Беловски, Заштита на правотот на сопственост , монографија, Скопје 2014
27. Даница Попов, Граѓанско право (Општ дел), , Нови Сад, 2007 година.
28. Иво Пухан Иво, Мирјана Поленак Акимовска , Римско право, Скопје, 2001 година,

29. Marija Jovnovska, Emilja Belogaska, Slobodan Sajnski, Privatization and restructuring of the socially and state owned enterprises in the Republic of Macedonia and its implications on corporate governance, 2002.
30. Милан Недков, Приватизација на општествениот капитал во Република Македонија, Истражувачки проект, Правен Факултет, Скопје, 1991.
31. Милан Недков, и др., Коментар на законот за трансформација на претпријатија со општествен капитал со модели на акти за негова примена, Скопје, год.1993.
32. Миролјуб Шукароб, С. Ристовска, Хаџи Василева – Марковска, Платформа за преговори со ММФ, сепарат: Сопственичка трансформација на претпријатијата со општествен капитал, Влада на Р. Македонија, Скопје, 1993 година
33. Наум Гризо, Борче Давитковски, Приватизација во светот,, Куманово, 1994 година.
34. Родна Живковска, Стварно право, Скопје, 2005 год
35. Станкович, В Водинелич, Увод у граѓанско право, Београд, 1992 .
36. Стојанова, Б., Некои економски аспекти на постприватизациониот период-менаџментот, интерното реструктурирање и работната сила, Социјално – економските последици на приватизацијата во Македонија и Бугарија, ИССПИ, 2008.
37. Стојановски Јован, Политичка економија, Просветно дело, Скопје, 1976 год
38. Тале Славески, Privatization in the Republic of Macedonia, Eastern EUROPEAN Economics, vol.35, no.1, 1997. Тале Славески, Македонската економија во транзиција, Институт отворено општество Македонија, Скопје, 1995 година
39. Тале Славески, Македонската економија во транзиција, Институт отворено општество Македонија, 1995.
40. Тале Славески, Приватизација пазар држава, Скопје, 1997 година
41. Томе Неновски, Македонскиот пат во приватизација на општествениот капитал, Стручна мон., 2015.

Akte normative

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.52/91)
2. Kushtetuta e RSFJS-së (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së ,nr. 15/1963)
3. Ligji për marrëdhënie themelore juridike pronësore(Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 6/1980)
4. Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore (Gazeta Zyrtare e RM-së 18/01)
5. Ligji për transformim të ndërmarrjeve me kapital shoqëror (Gazetën Zyrtare e RM-së, nr.48/1993)
6. Ligji për qarkullim dhe disponim me kapitalin shoqërorë(Gazeta Zyrtare e RSFJS-së, nr.84/89)
7. Ligji për letrat me vlerë(Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 5/93)
8. Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, 1950
9. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 18/01)

Burime nga interneti

<http://www.pravda.gov.mk/>

http://www.jewishcommunitybitola.mk/documents/doc_view/107-privatization-in-the-republic-of-macedonia.html

<http://www.ub.edu/graap/nazi.pdf>

<https://en.wikipedia.org/wiki/Privatization>

<https://siteresources.worldbank.org/INTDECABC2006/Resources/gurievmeeggison.PDF>

<https://www.oecd.org/daf/ca/corporategovernanceofstate-ownedenterprises/1929649.pdf>

https://www.researchgate.net/publication/28312632_The_First_Privatization_Policy_In_A_Democracy_Selling_State-Owned_Enterprises_In_1948-1950_Puerto_Rico

https://www.researchgate.net/publication/28312632_The_First_Privatization_Policy_In_A_Democracy_Selling_State-Owned_Enterprises_In_1948-1950_Puerto_Rico

https://www.researchgate.net/publication/28312632_The_First_Privatization_Policy_In_A_Democracy_Selling_State-Owned_Enterprises_In_1948-1950_Puerto_Rico

